Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 9 (89). SHTATOR 2013. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.



Market KEN
Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394

PROPOZIM

Dibra meriton një kompleks të madh historik

Nga **ABDURAHIM ASHIKU** - FAQE 9

VEPRIMTARI

Fakte të reja mbi gjenocidin serb në Shqipëri

Nga **REXHEP TORTE** - FAQE 10

PORTRET

Dr. Ali Isa Sula, krijuesi i laboratorit bakteriologjik

Nga **AHMET KAMBERI** - FAQE 16

BOTIME

Prezantohen katër libra të rinj nga Naim Berisha

FAQE 21

SENSIBILIZIM

Gazetarët në hapësirat shqiptare, mbështetje të fuqishme peticionit për Rrugën e Arbrit

Gazetarët, dibranë dhe miq të Dibrës, në Shqipëri, Maqedoni dhe Disaporë janë shprehur pa rezerva në përkrahje të peticionit online, nëpërmjet të cilit i kërkohet Qeverisë së re të Shqipërisë përfundimin sa më shpejt dhe me standarde i Rrugës së Arbrit.

'*Gazeta Ditore*' ka mësuar se iniciatorët e peticionit tashmë kanë kontaktuar Zyrën e Kryeministrit të Shqipërisë, Z. Edi Rama, për të kërkuar një takim në muajt që vijnë për dorëzimin formal të peticionit. Ne do ta përcjellim takimin e përfaqësuesve të intelektualëve dibranë me Z. Rama pasi ky është një ndër rastet e pakta në historinë e shtetit shqiptar, kur një peticion jo politik i paraqitet zyrtarisht një qeverie shqiptare. Veprimi qytetar i intelektualeve dibranë është një ogur i mirë për shoqërinë civile, jo vetëm në Shqipëri, po edhe në Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi.

Si intelektualët dibranë që iniciuan peticionin online para zgjedhjeve, një numër gazetarësh të lindur në Dibër, me origjinë dibrane ose që kanë punuar në krahinën e Dibrës, janë angazhuar prej vitesh në sensibilizimin e opinionit publik për rëndësinë e ndërtimit të rrugës së Arbrit në kontekstin rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

Përpjekjet e gazetarëve për të përcjellë informacione në media për Rrugën e Arbrit u intensifikuan veçanërisht nga Marsi i këtij viti, kur filluan të promovojnë peticionin online për Rrugën. Disa drejtues të mediave në Shqipëri dhe Kosovë e firmosën të parët peticionin dhe u bënë thirrje publikisht lexuesve e shikuesve të tyre ta firmosnin atë. Ndër nënshkruesit e parë të peticionit nga bota e medias mund të përmenden Ilva Tare, Valmir Gashi, Bujar Karoshi, Abdurahim Ashiku, Armir Shkurti, Hysen Uka, Alfred Beka, Hasan Aliaj, Dedë Kola, Atli Dema, Dhimitër Shtëmbari, Urim Bajrami, Defrim Methasani, Radije Hoxha, Hysen Likdisha, Neki Feta, Islam Shehu, Arben Ismaili, Adnan Elezi e shumë të tjerë.

(Lexoni në faqen 4)

INTERVISTË ME INXHINIERIN NGA MAQEDONIA, SHEFKI ALITI

Rruga e Arbrit po ndërtohet larg standardeve europiane



Pamje nga një segment i rrugës së Arbrit në Bulqizë, 2013. Foto © Gazmend Kerkuti

Unë kam dorëzuar në Ministrinë e Transportit të Shqipërisë një projekt gjeneral për Rrugën e Arbrit. Projektin ia dorëzuam ministrit Olldashi për përpunim në projekte zbatues dhe për fillimin e punimeve. Ai caktoi dy këshilltarë të tij të mbanin kontakte me mua. Por pasi dorëzuam projektin dhe pasi na u premtua zbatimi i tij, nuk u njoftuam më për vazhdimin.

Projekti im i Rrugës së Arbërit është projektuar me katër korsi me nga 3.5 m secila, dy korsi ndihmëse me 2.5 m, bankinat dhe brez gjelbërimi në anësore me nga 1.5 m. Pra, projekti përcaktonte një profil-gjerësi prej 25,5 m dhe gjatësia e trasesë nga Tirana, Dajti, Bulqiza deri në kufirin shqiptar-maqedonas me një gjatësi prej 64 km. Projekti përcaktonte shpejtësinë prej 100-120 km /orë dhe i jepte rrugës një karakter autostrade europiane. Projekti cakton edhe veprat e artit dhe tunelet. Projekti parasheh ndërtimin e 9600 m tunele si dhe 2460 m vepra arti. Projekti ishte i punuar me profile tërthorë dhe gjatësorë.

Kostoja e ndërtimit sipas projektit tonë me gjerësi të trupit të rrugës prej 25,5 m kushton afro 320 milionë euro për 64 km. Pra, afro 5 milionë euro për 1 km.

LEXONI NE FAQE 2-3



Ndihmoni Ambrën!

- Dy vëllezër luftojnë në ring me vdekjen e një vajze
- Solidaritet dhe fisnikëri nga shqiptarët anembanë

LEXONI NE FAQE 12-13

cyan magenta yellow black 1

Kostoja e ndërtimit sipas projektit tonë me gjerësi të trupit të rrugës prej 25,5 m kushton afro 320 milionë euro për 64 km. Pra, afro 5 milionë euro për 1 km.


Posta e

Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 9 (89). 1 - 30 Shtator 2013

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.
Njoftojmë zotërinjtë, Haki Pernezha, Mustafa Tola, Destan Rama, Mevlud Buci, Fatbardh Cena, Dali Tërshalla, se shkrimet e tyre jane në redaksi dhe do të shqyrtohen për botim në numrat e ardhshëm.
Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.
Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**
JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".
Gazeta publikohet falas në internet me datë 7 të muajit pasardhës.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!



KËSHILLI BOTUES:

Musa Riçku
Mentor Hoxha
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Kontribuan për këtë numër:
Abdurahim ASHIKU
Rexhep TORTE
Srecko SEKELJIC
Defrim METHASANI
Ahmet KAMBERI
Naim PLAKU
Fejzulla GJABRI
Hysen LIKDISHA
Krenare OLLOGU
Mevlud BUCI
Namik SELMANI
Atli DEMA
Destan RAMA

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Intervistë me inxhinier Shefki Aliti

Nga **Bujar KAROSHI**



Shefki Aliti është një inxhinier, i cili merret me projektim dhe ndërtim rrugës në Maqedoni. Ai ka një eksperiencë 30 vjeçare të ndërtimin e rrugëve në Maqedoni, Zvicër etj. Shefki Aliti është një ndër të parët që ka përgatitur një projekt ide për Rrugën e Arbrit që nga viti 2007. Propozimet e tij për rrugën në Kuvendin Shkencor për Rrugën e Arbrit mbajtur në maj 2007 në Tiranë, ishin shumë më kërkuese se ato që parashikonte qeveria shqiptare.

Prej më shumë se një viti, Zoti Aliti pati sjellë një shkrim për botim në redaksinë e gazetës, ku ngrinte disa problematika që kishin të bënin me punimet në Rrugën e Arbrit. Redaksia e mendoi që të mos e botonte opinionin e tij, duke menduar, ndoshta edhe padrejtësisht, se ai po e zmadhonte në të vërtetë situatën. Gjithashtu, zoti Aliti, në shkrimin e tij, përmendte edhe disa emra ministrash, këshilltarësh të tij, projektues dhe ndërtues rrugës, dhe redaksia, me synimin për të qenë e paanshme në këtë debat, e kishte të pamundur të tërhiqte mendimet e gjithsecilit në një kohë të shkurtër, dhe kështu mendoi dhe vendosi mosbotimin e shkrimit.

Në kuadrin e zhvillimeve të reja politike në vend, si dhe duke pasur parasysh propozimet e reja që kanë dalë për përmirësimin e standardeve të ndërtimit dhe përshpejtimin e përfundimit të Rrugës së Arbrit, zoti Aliti shfaqi interesim për t'iu botuar shkrimi. Por, në vend të botimit të opinionit të tij, ne menduam të zhvillojmë një intervistë me të, si hap të parë të ngritjes së çështjeve që ai propozon.

Me këtë rast, redaksia mbetet e hapur për botimin e gjithë opinioneve dhe mendimin e specialistëve të interesuar për Rrugën, duke menduar se një debat sa më i gjerë, do ti shërbente ndërtimit të saj në një kohë më të shpejtë dhe me standarde të larta.

Bujar Karoshi: Përshëndetje zoti Aliti. Përpara se të botojmë shkrimin tuaj, ne mendojmë të zhvillojmë një intervistë. Them të trajtojmë një njohjen tënde të problemit dhe propozimet e tua mbi projektin. Në qoftë se ju jeni dakord, vazhdojmë me email pyetje pas pyetje. Si mendoni?

Shefki Aliti: Përshëndetje. Faleminderit për interesimin. Megjithëse mendoj se kjo intervistë është me shumë vonesë, asnjëherë nuk është vonë për të thënë të vërtetën dhe për të dhënë kontributin tim për rrugën e Arbrit.

B.Karoshi: Faleminderit! Unë mendoj se nuk është me vonesë, megjithatë, kjo është çështje tjetër. Vazhdojmë me pyetjen e parë: Kur jeni njohur për herë të parë me idenë e rrugës së Arbrit?

Sh.Aliti: Për herë të parë kam e kam vizituar Shqipërinë më 4 korrik 1990. Pashë se rrugët e Shqipërisë ishin katastrofa ma e madhe në Europë. Fillova ta studioj këtë mangësi rrugore dhe fill pasi u poqën kushtet ndërmjetësova që ndërmarrja "Granit" të fillojë asfaltimet në Shqipëri. Në fituam tenderin Korçë-Kakavijë dhe Rrogozhinë-Lushnje.

Gjatë kësaj kohe kam dëgjuar për Rrugën e Arbrit, por ka qenë maji i vitit 2007, kur u mbajt në Tiranë një konferencë shkencore në Hotel Tirana, kur fillova të merresha intensivisht me të. Unë mora pjesë në këtë konferencë, së bashku me dy inxhinierë të tjerë nga Maqedonia. Shoqatat dibrane që organizonin konferencën, kishin botuar nji broshurë për Rrugën e Arbrit, por që aty nuk kishte informacion teknik për rrugën.

Pasi lexova broshurën, u interesuam të gjejmë hartat me izoipset e rajonit nga kalonte Rruga e Arbrit dhe gjetëm në Maqedoni harta ruse. Me mundime të mëdhaja u kapëm për projektin e fazës ideore dhe arritëm në fazën e projektit gjeneral. Projektin ia dorëzuam ministrit Olldashi për përpunim në projekte zbatues dhe për fillimin e punimeve.

Projekti im i Rrugës së Arbërit është projektuar me katër korsi me nga 3.5 m secila, dy korsi ndihmëse me 2.5 m, bankinat dhe brez gjelbërimi në anësore me nga 1.5 m. Pra, projekti përcaktonte një profil-gjerësi prej 25,5 m dhe gjatësia e trasesë nga Tirana, Dajti, Bulqiza deri në kufirin shqiptar-maqedonas me një gjatësi prej 64 km. Projekti përcaktonte shpejtësinë prej 100-120 km /orë dhe i jepte rrugës një karakter autostrade europiane. Projekti cakton edhe veprat e artit dhe tunelet. Projekti parasheh ndërtimin e 9600 m tunele si dhe 2460 m vepra arti. Projekti ishte i punuar me profile tërthorë dhe gjatësorë.

B. Karoshi: Ju po thoni se keni hartuar një projekt dhe ia keni dorëzuar ish-ministrit Olldashi. Çfarë përmban projekti? Na e përshkruani pak atë dhe kur ia keni dorëzuar Olldashit?

Sh. Aliti: Projekti përmban gjithë nivelet e një projekti gjeneral, duke llogaritur përshkrimin teknik dhe një historik të shkurtër të Rrugës Arbrit. Rruga është projektuar me katër korsi me nga 3.5 m secila, dy korsi ndihmëse me 2.5 m, bankinat dhe brez gjelbërimi në anësore me nga 1.5 m. Pra, projekti përcaktonte një profil-gjerësi prej 25,5 m dhe gjatësia e trasesë nga Tirana, Dajti, Bulqiza deri në kufirin shqiptar-maqedonas me një gjatësi prej 64 km. Projekti përcaktonte shpejtësinë prej 100-120 km /orë dhe i jepte rrugës një karakter autostrade europiane. Projekti cakton edhe veprat e artit dhe tunelet. Projekti parasheh ndërtimin e 9600 m tunele si dhe 2460 m vepra arti. Projekti ishte i punuar me profile tërthorë dhe gjatësorë. Gjithashtu, projekti caktonte koston e ndërtimit, pra ka një parallogaritje për vlerën në euro.

Me ish-ministrin Olldashi jemi takuar në maj 2007, kur u mbajt Konferenca për Rrugën e Arbrit. Në takimin me të kam qënë unë, së bashku me 7 funksionarë të pushtetit lokal nga dy Dibrat.

B. Karoshi: Me 26 maj 2007 është mbajtur kuvendi tekniko-shkencor për Rrugën e Arbrit në Hotel Tirana. Ju po thoni së në këtë konferencë jeni njohur për herë të parë me rrugën dhe ndërkohë keni paraqitur edhe një projekt teknik?

Sh. Aliti: Jo. Unë po them se për herë të parë jam takuar me Olldashin në Maj 2007. Por, pas atij takimi unë jam takuar edhe disa herë të tjera me të, deri në mesin e vitit 2008. Ai caktoi dy këshilltarët e tij për të mbajtur kontake me mua.

B. Karoshi: A mbajtët kontakte me këshilltarët?

Sh. Aliti: Po. Rregullisht. Mbaj mend se njëri prej tyre ishte nga Vlora. Kontaktet me të i mbaja unë së bashku me Prof. Dr. Sazan Gurin.

B. Karoshi: Çfarë bisedonit me këshilltarët e ish-ministrit? A të premtuan gjë ata?

Sh. Aliti: Bisedonim për realizimin e projektit... Për projektim të projektit zbatues dhe për punim te studimit për mbrojtjen e ambientit gjatë ndërtimin të rrugës. Pra, punuam komplet studimin mjedisor dhe ua dorëzuam unë dhe Prof. Sazan Guri këshilltarëve të ish-ministrit, z Sokol Olldashi.

B. Karoshi: A ishit në dijeni ju se në këtë periudhë, po zbatohej një projekt i rrugës nga Bulqiza te Ura e Cerenecit?

Sh. Aliti: Në atë kohë nuk projektohej asnjë projekt dhe nuk zbatohej asnjë projekt. Ende nuk ekzistonte projekt....

B. Karoshi: Në korrik 2005, ish kryeministri Fatos Nano inauguroi fillimin e punimeve në Fushë-Bulqizë. Ju po thoni se ky ishte një fillim pa projekt?

Sh. Aliti: Ai moment ishte për fushatë elektorale, për me e gënjye at popullatë të varfëruar skajmisht. Nuk kemi hasë në asnjë projekt. Absolutisht, punimet atje kishin filluar pa projekt. U hodh një lopatë beton për t'u hedhur hi syve njerëzve, për fushatë.

B. Karoshi: Si përfunduan bisedimet me përfaqësuesit e ministrit?

Sh. Aliti: Ata na premtuan se do të shpallej tender për projektin zbatues të autostradës Rruga e Arbrit dhe na kërkuan neve të përpilojmë edhe studimin mjedisor. Së bashku me z. Sazan Guri formuam një grup pune të shkencëtarëve shqiptar dhe e mbaruam studimin voluminoz dhe e dorëzuam te këshilltarët e ministrit. Ata premtuan se, neve, grupit te inxhinierëve nga Maqedonia do të na caktojnë punimin e projektit zbatues.

aktualitet



Bulqiza - Foto © Gazmend Kerkuti

Shefki Aliti:

Rruga e Arbrit po ndërtohet larg standardeve europiane

Pjesa që është ndërtuar në Shqipëri është paraparë me lëvizje maksimale të shpejtësisë me 80 km/orë, ndërsa federata europiane e autostradave me seli në Buksel nuk e pranon standarde të ndërtimit të autostradave me shpejtësi nën 120 km/orë

Problemi i vazhdimit të Rrugës së Arbrit në Maqedoni varet nga ndërtimi i saj në Shqipëri. Autoritetet maqedonase thonë se "ne nuk e dimë nëse projekti do vazhdojë të kalojë Drinin në afërsi të fshatit Kojnarë apo do përdoret rruga aktuale drejt doganës së Bllatës. Kur Shqipëria do të përcaktojë vazhdimin e projektit deri në kufi, ne do të vazhdojmë autostradën deri në Ura e Boshkut, trase e cila do të jetë e gjatë 14,4 km në anën e Republikës së Maqedonisë".

B. Karoshi: Çfarë ndodhi që ju nuk u përfshitë në projekt zbatimin?

Sh. Aliti: Thjesht e morën projektin tonë të nivelit gjeneral dhe e ndanë në katër pjesë, dhe pa fije turpi ua dhanë firmave të afërta me ministrin dhe stafin e ministrisë. Ata, firmat, sëbashku me inxhinierët e ministrisë e deformuan komplet projektin tonë, duke projektuar një trase të re afërsisht e ngjashme me projektin tonë, por me gabime fondamentale, me trase me një kahje dhe me shpejtësi maksimale 80 km/orë, jashtë standardeve evropiane, me shumë kthesa jashtë standardeve. Shpejt e shpejt i filluan punimet për një autostradë qe nuk ka lidhje me standardet e ndërtimit të rrugëve. Pra filloi ndërtimi i një rruge lokale dhe jo një autostrade që duhet të lidhë dy shtetet dhe më tej.

B. Karoshi: A ishit ju në dijeni të tenderit për zbatimin e projektit?

Sh. Aliti: Jo. Mendoj se nuk u bë tender. Ose në qoftë se kanë bërë ndonjë tender fshehurazi, sa për të rregulluar letrat. Ata e ndan në katër firma për projektim.

B. Karoshi: Juve nuk ju njoftuan për tenderat? Po me dokumentacionin që dorëzuat çfarë u bë?

Sh. Aliti: Neve nuk na njoftuan aspak. Ata dy këshilltaret e ish-ministrit Olldashi, dokumentacionin që dorëzuam ne, projektin teknik dhe mjedisor e mbajtën për vete dhe më vonë ua ndanë katër firmave për me projektuar përsëri rrugën e dështuar.

B. Karoshi: A jeni i sigurtë për këtë? Ju po thoni se për projektin janë përdorur materialet e tua?

Sh. Aliti: Sigurisht, po dhe si model e kanë marre projektin tonë me parametra komplet të dështuara dhe me dështime e filluan ndërtimin e rrugës.

B. Karoshi: A keni mbajtur lidhje me Sazan Gurin? Çfarë mendon ai lidhur me këtë proces?

Sh. Aliti: Vazhdimisht kemi mbajtur lidhje dhe gjithnjë së bashku kemi kontaktuar këshilltarët e ministrisë dhe së bashku edhe me ekspertë të tjerë e punuam studimin për mosndotjen e ambientit. Studimin e financova unë dhe e dorëzuam në ministri. Prof Sazani protestonte ashpër për këtë dështim me qëllim....

B. Karoshi: Ju vazhdimisht u referoheni personave të kontaktit si këshilltarët e ministrit. Nuk ua mbani mend emrat apo nuk doni tu bëhen publike?

Sh. Aliti: Nuk dua të përmend emra. Ata që duan ti gjejnë emrat, mund t'u drejtohen institucioneve që ti bëjnë publike. Po të përmendi emra, do duket se unë kam inat me to. Por unë nuk kam asgjë personale me to. Në këto momente mua më intereson më shumë e vërteta mbi rrugën e Arbrit.

B. Karoshi: Në rregull. Kthehemi te projekti juaj. Ju po thoni që keni dorëzuar një projekt që shkon në gjerësinë e rrugës deri afro 25 metra. Për lehtësi kuptimi nga lexuesit, a mund të na përmendni një rrugë të ngjashme në Ballkan?

Sh. Aliti: Po. Rruga Tetovë-Shkup me gjatësi 40 km ka qenë një rrugë normale deri në vitin 1972. Në këtë vit filloi ndërtimi i saj me parametra europianë, por me një kahje. Në vitin 2000 u ndërtua edhe krahu tjetër dhe kështu u kompletua autostrada Tetovë-Shkup. Unë dhe kolegët e mi, kur u morëm me projektimin e Rrugës së Arbrit, patëm parasysh këtë model.

Pra, faza e parë me parametra adekuate të ndërtohet me një kah dhe ma vonë kur të ketë kushte financiare të ndërtohet edhe kahja e dytë.

B. Karoshi: Pse mendoni se dështuan? A nuk mund të përmirësohet më vonë segmenti i rrugës së Arbrit që është ndërtuar, në varësi të interesit ekonomik?

Sh. Aliti: Jo, për arsye se ajo që është ndërtuar është në parametra të gabuar të shpejtësisë së lëvizjes. Pjesa që është ndërtuar në Shqipëri është paraparë me lëvizje maksimale të shpejtësisë me 80 km/orë, ndërsa federata europiane e autostradave me seli në Buksel nuk e pranon standarde të ndërtimit të autostradave me shpejtësi nën 120 km/orë. Pra, ka standarde europiane për ndërtimin e autostradave.

B. Karoshi: Ju keni dorëzuar në ministri një projekt fizibiliteti për rrugën, një projekt teknik apo një projekt mjedisor?

Sh. Aliti: Një projekt teknik, me parametra teknikë, sipas standardeve evropiane.

B. Karoshi: Sipas projektit tuaj, sa është kosto e ndërtimit të Rrugës së Arbrit nga Tirana në Dibër të Madhe?

Sh. Aliti: Kostoja e ndërtimit sipas projektit tonë me gjerësi të trupit të rrugës prej 25,5 m kushton afro 320 milionë euro për 64 km. Pra, afro 5 milionë euro për 1 km.

B. Karoshi: A përfshihen në këtë kosto veprat e artit, ura, tunele, etj?

Sh. Aliti: Duke analizuar autostradat e ndërtuara në Maqedoni, e veçanërisht në Kroaci, ku gjithnjë kostoja e ndërtimit nuk e kalon 4 milionë euro për 1 kilometër, dhe duke pasur parasysh se kemi bitumin kombëtar dhe gurin natyror gëlqeror rreth autostradës, parapamë që kostoja e ndërtimit për 1 km të jetë 5 milionë euro, duke llogaritur edhe veprat e artit. Por, pa keqpërdorime të fondeve financiare.

B. Karoshi: Rruga e Arbrit është paraparë që të ketë një dalje në Luginën e Pollogut dhe kështu lidhet me autostradën në Gostivar. A keni bërë ndonjë përpjekje për fillimin e ndërtimit të saj në Republikën e Maqedonisë?

Sh. Aliti: Po. Janë bërë shumë përpjekje, shumë punë, shumë angazhime. Kam dorëzuar një projekt në Odën Ekonomike të Maqedonisë, në qeverinë e Maqedonisë, madje deri në Bruksel. Gjithashtu, kam zhvilluar edhe disa takime me përfaqësues të pushtetit lokal në Dibër. Këto ditë kam takuar edhe kryetarin e komunës së Dibrës, zotin Rruzhdi Lata, lidhur me këtë problem. Ne kemi probleme me pjesën tonë që presin zgjidhje.

B. Karoshi: Ju thatë se keni qenë në Dibër dhe keni biseduar me kryetarin e Komunës atje dhe se keni probleme me "pjesën tuaj". Çfarë doni të thoni me këtë? Si paraqitet situata e vazhdimit të rrugës së Arbrit në Maqedoni?

Sh. Aliti: Problemi është se nga ana shqiptare nuk është aprovuar vazhdimi i drejt Dibrës së Madhe. Ne nuk e dimë nëse projekti do vazhdojë të kalojë Drinin në afërsi të fshatit Kojnarë apo do përdoret rruga aktuale drejt doganës së Bllatës. Autoritet maqedone thonë se kur Shqipëria do të përcaktojë vazhdimin e projektit deri në kufi, ne do të vazhdojmë autostradën deri në Ura e Boshkut, trase e cila do të jetë e gjatë 14,4 km në anën e Republikës së Maqedonisë. Këto probleme dhe të tjera i diskutuam edhe me kryetarin e komunës së Dibrës, Z. Rruzhdi Lata.

B. Karoshi: Kur thoni "autoritetet maqedonase" keni parasysh Kryetarin e Komunës së Dibrës apo ndonjë institucion tjetër, si p.sh., ministrinë e transportit të Maqedonisë?

Sh. Aliti: Kam parasysh autoritet e qeverisë së Republikës së Maqedonisë, sidomos Ministrinë e Transportit të Maqedonisë. Z. Rruzhdi Lata ka ngritur grupin e punës për këtë projekt dhe do të lobojnë edhe te autoritet e shtetit shqiptar paralelisht edhe me qeverinë e Republikës së Maqedonisë me u realizue projekti i ndërtimit të rrugës nëpër pjesën e Maqedonisë.

B. Karoshi: Nga përgjigja juaj duket se autoritetet maqedonase janë akoma në fazën e lobimit, ndërsa Shqipëria ka ecur më përpara në këtë drejtim dhe po pret financime për mbarimin e segmentit të saj?

Sh. Aliti: Po, por Shqipëria ka ecur me përpara, por me projekt të cunguar. Mos harroni se Republika e Maqedonisë ka rrugë të asfaltuar Gostivar-Mavrovë-Dibër-Bllatë prej vitit 1955. Kurse komunistët e Enverit e mbyllën rrugën e Arbrit që ka ekzistuar prej kohës së romakëve...

B. Karoshi: Sipas përgjigjeve tuaja, del se ju keni bërë shumë punë drejt projekteve teknike në Maqedoni dhe Shqipëri. A jeni paguar për punën e bërë?

Sh. Aliti: Jo. Gjithçka e kam financuar prej parave të mia. Askush nuk më ka paguar mua.

B. Karoshi: Në qoftë se qeveria e re do kërkonte një këshillë nga ju për Rrugën, çfarë do të propozonit?

Sh. Aliti: Do t'i propozoj qe te punohet projekt i ri me parametra evropiane. Do t'i propozoja qeverisë që të hartojë një dinamikë: sa lekë ka nga buxheti, aq ndërto autostradën Rruga e Arbrit. Në qoftë së, p.sh., për vitin e ardhshëm ke 75 milionë euro, ndërto vetëm 15 km. Ka edhe variante ekonomike, që do të thotë "ndërto vetëm njerë kahje, pastaj kahun tjetër".

Gjithashtu, do i propozoja të zbatohet një kontrolli rreptë për kualitetin e ndërtimit dhe përdorimin e financave. Çdo shpërdorim financiar është në dëm të cilësisë së rrugës.

B. Karoshi: Në fakt, problemi i financimit është një çështje e rëndësishme. Shumë njerëz thonë se qeveria nuk i kishte dhe nuk i ka fondet e mjaftueshme për rrugën. Ju si mendoni, a mund ti gjejë qeveria fondet?

Sh. Aliti: Mjafton të ekzistojë dëshira e mirë për përfundimin e rrugës me parametra europiane, dhe jam i mendimit se në këtë mënyrë qeveria do t'i gjejë financimet.

Njëra nga mënyra është kërkimi i fondeve nga BE, nëpërmjet projektit "Cross Border". Rruga e Arbrit do lidhë Shkupin me Tiranën, kështu që BE do ishte e interesuar ta financonte këtë korridor në kuadrin e projekteve të përbashkëta të integrimit. Por, për këtë duhet të përgatitet një dokumentacion i plotë teknik dhe financiar nga të dy shtetet. Gjithashtu, edhe gjetja e financimeve nga donacionet e shteteve arabe apo Turqia janë të mundshme. Por, edhe buxheti i shtetit mund të krijojë fonde për këtë projekt me leverdi ekonomike për vendin.

B. Karoshi: Aq e lehtë është gjetja e financimeve?

Sh. Aliti: Është shumë e lehtë çështja e financimit, në qoftë se shfrytëzohen burimet që kanë Shqipëria dhe Maqedonia. Eksperienca e Kroacisë në këtë drejtim, është një gjë që duhet marrë si eksperiencë.

Rruga e Arbërit nr. 89

Rruga e Arbrit është kthyer në një çështje mbarëkombëtare. Media në gjithë hapësirën shqiptare i ka kushtuar faqe të tëra sensibilizimit të opinionit publik, dhe "Gazeta Ditore" në Kosovë më 28 shtator botoi komentin e mëposhtëm, të cilin po e përcjellim për lexuesit tanë.

sensibilizim

Gazetarët në hapësirat shqiptare, mbështetje të fuqishme peticionit për Rrugën e Arbrit

Gazetarët, dibranë dhe miq të Dibrës, në Shqipëri, Maqedoni dhe Disaporë janë shprehur pa rezerva në përkrahje të peticionit online, nëpërmjet të cilit i kërkohet Qeverisë së re të Shqipërisë përfundimin sa më shpejt dhe me standarde i Rrugës së Arbrit.

'*Gazeta Ditore*' ka mësuar se iniciatorët e peticionit tashmë kanë kontaktuar Zyrën e Kryeministrit të Shqipërisë, Z. Edi Rama, për të kërkuar një takim në muajt që vijnë për dorëzimin formal të peticionit. Ne do ta përcjellim takimin e përfaqësuesve të intelektualëve dibranë me Z. Rama pasi ky është një ndër rastet e pakta në historinë e shtetit shqiptar, kur një peticion jo politik i paraqitet zyrtarisht një qeverie shqiptare. Veprimi qytetar i intelektualeve dibranë është një ogur i mirë për shoqërinë civile, jo vetëm në Shqipëri, po edhe në Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi.

Si intelektualët dibranë që iniciuan peticionin online para zgjedhjeve, një numër gazetarësh të lindur në Dibër, me origjinë dibrane ose që kanë punuar në krahinën e Dibrës, janë angazhuar prej vitesh në sensibilizimin e opinionit publik për rëndësinë e ndërtimit të rrugës së Arbrit në kontekstin rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

Përpjekjet e gazetarëve për të përcjellë informacione në media për Rrugën e Arbrit u intensifikuan veçanërisht nga Marsi i këtij viti, kur filluan të promovojnë peticionin online për Rrugën. Disa drejtues të mediave në Shqipëri dhe Kosovë e firmosën të parët peticionin dhe u bënë thirrje publikisht lexuesve e shikuesve të tyre ta firmosnin atë. Ndër nënshkruesit e parë të peticionit nga bota e medias mund të përmenden Ilva Tare, Valmir Gashi, Bujar Karoshi, Abdurahim Ashiku, Armir Shkurti, Hysen Uka, Alfred Beka, Hasan Aliaj, Dedë Kola, Atli Dema, Dhimitër Shtëmbari, Urim Bajrami, Defrim Methasani, Radije Hoxha, Hysen Likdisha, Neki Feta, Islam Shehu, Arben Ismaili, Adnan Elezi e shumë të tjerë.

Peticioni mori mbështetje edhe nga politikanë, shkrimtarë, artistë dhe intelektualë që punojnë ose bashkëpunojnë ngushtë me median, si Elez Biberaj, Laura Kondo dhe Ilirjan Agolli të *Zërit të Amerikës*, Ruben Avxhiu, Gary Kokalari, Akil Koçi, Thoma Simaku, Besnik Mustafaj, Agron Tufa, Afrim Krasniqi, Flutura Açka, Kolec Traboini, Hysni Milloshi, Olti Buzi, Alma Mile, Mirela Bogdani, Albert Rakipi, Mujo Buçpapaj, Ben Manaj, Ramiz Gjini, Thoma Jançe, Admirina Peci, Doriana Metollari, Kastriot Frasheri, Mirela Sula, Petrit Kuçana, etj. Në gazetën '*Rruga e Arbërit*' që botohet në Tiranë që nga viti 1996, si dhe në gazetën lokale '*Dibra*', kanë shkruar vazhdimisht specialistë të fushave të ndryshme për domosdoshmërinë e ndërtimit të rrugës dhe përfitimet që i sjell vendit nga ndërtimi i saj. Që nga 8 tetori 1995 kur Radio Tirana transmetoi një kronikë për rrugën nga gazetari i saj Hysen Uka, media është kthyer në një mbështetëse e fuqishme, duke e bërë problemin e rrugës një çështje mbarëkombëtare.

Shumë gazetarë, miq të Dibrës, po japin një kontribut të madh duke i dhënë zë problemeve që kanë dalë apo mund të dalin gjatë fazës së projektimit dhe ndërtimit të rrugës, duke siguruar që kjo vepër e rëndësishme infrastrukturore të përmbushë standardet europiane.

Peticioni deri tani është përcjellë gjerësisht nga mediat në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni si dhe në diasporë: Angli, Amerikë, Australi, Kanada, Itali, Zvicër, Greqi, Bullgari dhe Rumani.

Intelektualët dhe gazetarët po e përdorin peticionin si një metodë demokratike për të ushtruar presion mbi qeverinë dhe klasën politike që të përparësojë zhvillimin e krahinave si Dibra të cilat, si rezultat i investimeve të kursyera, vuajnë sot rënien e ekonomisë, rrjedhjen e popullsisë dhe për pasojë renditen ndër rajonet më të varfëra në vend. Rruga e Arbrit, siç është pranuar gjerësisht nga qeveritarë, politikanë, specialistë të ekonomisë etj., nuk është vetëm një nyje e rëndësishme infrastrukturore në vend. Ajo sjell edhe përfitime ekonomike e jetike në gjithë gjatësinë e saj, nga Tirana deri në Luginën e Pollogut në Maqedoni. Ndërsa Bulqiza, Klosi, Dibra e Madhe, Tirana, Peshkopia dhe Burreli, do jenë të parët që do ta ndjejnë pozitivisht efektin ekonomik të saj.

Duke parë rëndësinë që entet dhe koalicionet politike i kushtuan Rrugës së Arbrit gjatë zgjedhjeve, gjë që u reflektua edhe në vizitat e shpeshta të krerëve të shtetit dhe partive në Qarkun e Dibrës, është më se e qartë se peticioni i intelektualëve dibranë është një tregues premtues i rolit pozitiv që shoqëria civile, edhe pse akoma në formë embrionale, mund të luajë në konsolidimin e zhvillimeve demokratike në Shqipëri, si dhe një mjet efikas për t'i kujtuar klasës politike se votuesit kërkojnë, me të drejtë, që premtimet elektorale të mbahen.

Fakti që intelektualët dibranë e kanë bërë të qartë që në fillim se ky peticion do të përfundojë vetëm kur të përurohet Rruga e Arbrit në gjithë gjatësinë e saj, ka bërë që partitë të vazhdojnë të tregojnë interesim për peticionin edhe pas zgjedhjeve. Ky është një tregues inkurajues dhe një bazë e mirë për të filluar një dialog konstruktiv me Qeverinë, në mënyrë që projekti në fjalë të përfundojë sa më shpjet dhe me standarde ndërkombëtare.

Iniciatorët e peticionit, ndër të cilët ka edhe gazetarë, shprehen se janë të inkurajuar nga fakti që, si gjatë fushatës elektorale, edhe pas zgjedhjeve, përfundimi i Rrugës së Arbrit është një ndër premtimet kryesore konkrete në programin qeveritar, premtim që Z. Edi Rama e përmendi edhe në ditën e parë në detyrë si Kryeministër.

Peticioni është zëri i shqiptarëve anekënd botës që e duan vendin e tyre, është zëri i Dibrës. Por që ky zë nuk mund të mbahej i gjallë dhe nuk do të kishte efektin e duhur pa angazhimin direkt të intelektualëve dibranë dhe të gazetarëve dibranë. Gazetarja me origjine dibrane Ornela Manjani është shprehur se e konsideron privilegj çfarëdo kontributi që ajo mund të jap në përkrahje të peticionit. Gazetari Hysen Likdisha shprehet se do të vazhdoj të jap kontributin e tij në dobi të ndërtimit të Rrugës së Arbrit 'nga borxhi që i kemi Dibrës si dibranë që jemi', por edhe nga përfitimet ekonomike që kjo rrugë sjell për kombin. Ndërsa gazetari Abdurahim Ashiku nuk ka rreshtur në Athinë, ku banon aktualisht, duke inkurajuar bashkëatdhetarët në Greqi të nënshkruajnë peticionin në formularët e përgadituar enkas.

Vullneti dhe vendosmëria e gazetarëve, për të kontribuar pa reshtur, për të përcjellë sa më gjerësisht peticionin në insitucionet mediatike ku kanë afirmuar vlerat e tyre profesionale, është një shembull që duhet të ndiqet edhe nga ne, kolegët e tyre në Shqipëri, Kosovë, në mbarë hapësirën shqiptare si dhe në Diasporë për tu prononcuar me kurajo në përkrahje të nismave të tilla me vlerë nga shoqëria civile.

Angazhimi ynë si gazetarë në këtë drejtim bëhet më imperativ po qe se kemi parasysh numrin e madh të drejtuesve dhe ekspertëve të mediave të huaja që kanë përkrahur peticionin për ndërtimin e Rrugës se Arbrit. Mes tyre mund të përmedim Dr Franco Tagliarini, Drejtori i AlbaniaNews në Itali, Rashmee Roshan Lall, ish-korrespondente e gazetës '*The Times of India*' në Londër dhe gazetare e BBC World Service, dhe editorët e e gazetës '*Pravda*' të Slovakisë, Andrej Matisak dhe Ladislav Burkovic.

Gazeta Ditore u bën thirrje përsëri lexuesve të saj që ta nënshkruajnë peticionin duke shkruar Emrin, Mbiemrin, Adresën e Emailit, Qytetin tuaj dhe pastaj klikoni 'Sign':

http://www.change.org/en-GB/petitions/complete-the-construction-of-the-arb%C3%ABri-road-nd%C3%ABrtoni-sa-m%C3%AB-shpejt-dhe-me-standarde-rrug%C3%ABn-e-arb%C3%ABrit?utm_campaign=petition_created&utm_medium=email&utm_source=guides

Marrë nga Gazeta Ditore, Kosovë
28 Shtator 2013



Pamje nga rruga e Arberit pranë Urës së Brarir në Tiranë. Foto: B.Karoshi

> Iniciatorët e peticionit, ndër të cilët ka edhe gazetarë, shprehen se janë të inkurajuar nga fakti që, si gjatë fushatës elektorale, edhe pas zgjedhjeve, përfundimi i Rrugës së Arbërit është një ndër premtimet kryesore konkrete në programin qeveritar, premtim që Z. Edi Rama e përmendi edhe në ditën e parë në detyrë si Kryeministër.

> Që nga 8 tetori 1995 kur Radio Tirana transmetoi një kronikë për rrugën nga gazetari i saj Hysen Uka, media është kthyer në një mbështetëse e fuqishme, duke e bërë problemin e rrugës një çështje mbarëkombëtare.

> Vullneti dhe vendosmëria e gazetarëve, për të kontribuar pa reshtur, për të përcjellë sa më gjerësisht peticionin në insitucionet mediatike ku kanë afirmuar vlerat e tyre profesionale, është një shembull që duhet të ndiqet edhe nga ne, kolegët e tyre në Shqipëri, Kosovë, në mbarë hapësirën shqiptare si dhe në Diasporë për tu prononcuar me kurajo në përkrahje të nismave të tilla me vlerë nga shoqëria civile.

Mbi modalitetet e nënshkrimit të peticionit online për Rrugën e Arbërit

Dëshirojmë të njoftojmë gjithë lexuesit se peticioni onlinë për Rrugën e Arbrit do të vazhdojë të firmoset dhe ai do të mbyllet vetëm kur të përurohet rruga Tiranë-Dibër.

Shumë qytetarë në Shqipëri dhe në vende të tjera kanë komunikuar me redaksinë e gazetës "Rruga e Arbërit" dhe hartuesin e peticionit për të konfirmuar se e kanë nënshkruar atë si dhe për tu interesuar nëse nënshkrimet e tyre janë regjistruar.

Pavarësisht ftesave të ripërsëritura për ta firmosur peticionin, njoftojmë se vetëm nënshkrimet që përmbushin kriteret e rrepta të transparencës të përcaktuara që kur filloi peticioni, do të përfshihen në dokumentin zyrtar që do t'i dorëzohet qeverisë së re.

Ju rikujtojmë se kush e ka nënshkruar peticionin online, nuk duhet ta firmosë për së dyti, si dhe nuk ka të drejtë ta nënshkruajë atë në letër.

Lista e plotë e nënshkrimeve dhe komentet e bëra online do të jenë dokumente publike.

Gjithashtu, njoftojmë gjithë ata që kanë firmosur peticionin në letër, t'i sjellin ato sa më shpejt në redaksi, pasi procesi i përgatitjes së peticionit për t'iu dorëzuar qeverisë shqiptare ka filluar.

Faleminderit për mirëkuptimin dhe mbështetjen tuaj!



NDIQ HAPAT E MËPOSHTME PËR TË FIRMOSUR SAKTË:

1 - KLIKO NË FAQEN E WEB SI MË POSHTË:
www.change.org/en-GB/petitions/complete-the-construction-of-thearb%C3%ABri-road-nd%C3%ABrtoni-sa-m%C3%AB-shpejt-dhe-me-standarderrug% C3%ABn-e-arb%C3%ABrit?utm_campaign=petition_created&utm_medium=email&utm_source=guides

2- LART, DJATHTAS SHFAQEN KUADRATET BOSH
Shkruaj Emrin, Mbiemrin, Adresën e emailit dhe Qytetin tuaj. Pastaj klikon **"Sign".**
Pas kësaj, ju do të merrni një mesazh falënderimi dhe konfirmimi që emri juaj u regjistrua.
Për të gjithë miqtë tuaj që nuk kanë mundësi hyrje në web,
sharko formularin dhe plotësoje me dorë.
Për hollësi mund të vizitoni faqen e gazetës
në Web: <**www.rrugaearberit.com**>
ose në Facebook <**facebook.com/gezim.alpion**>
ose <**facebook.com/rruga.arberit**>

edukim


Nxënës të shkollës jopublike "Sarina 2002"

Aty ku nis udhën dija

Nga **Shaqir SKARRA**

Ka vetëm pak ditë që sapo ka nisur viti i ri shkollor 2013-2014, dhe të gjitha shkollat kanë hapur dyert për të pritur nxënësit.

Edhe shkollat jo publike kanë hapur dyert këtë vit të ri shkollor, por ndryshe nga shkollat shtetërore, ku vihen re shumë mungesa, te to gjithçka ecën normalisht.

Në metropolin shqiptar janë tre shkolla jo publike ku administratorët e tyre janë me origjinë nga Dibra, nga zona mjaft arsimdashëse: "Sarina" me administrator Liman Hoxha nga fshati Blliçe,"Eurovizion" me administrator Mufit Xharri nga Brezhdani dhe "Migjeni"me administrator Gëzim Hyseni nga Reçi. Ashtu si mjaft koleg të tyre, këta tre dibranë të mirë pranuam riskun, ndoshta të dobët, duke hapur një biznes elitar, biznes human, siç është shkolla. Hapja e shkollave u ka kushtuar shumë investime, por sot pas kaq vitesh, kanë të drejtë të krenohen me atë që kanë investuar. Në këtë shtator, ashtu si mbarë shkollat në vendin tonë, edhe këto shkolla jo publike hapën dyert për të pritur nxënësit. Jo vetëm kaq, por nga Dibra është edhe Lulzim Ndreu, një djalë i nga Sllova, nip i Elez Isufit. Lulzimi ka hapur një universitet, Universitetin Amerikan të Tiranës, në një godinë madhështore në Lundër, në afërsi të TEG-ut. Universiteti dallohet për bibliotekën, ndoshta më të madhen në Ballkan, por për të do të shkruajmë në muajt që vijnë. Sot po shkruajme për "Sarinën", "Eurovizionin" dhe "Migjenin"...

"SARINA" – PROGRES DIJESH...


Është një ndër shkollat jo publike më masive dhe më cilësore në të gjithë Qarkun e Tiranës. Shkolla "Sarina" e ka krijuar profilin e vet dhe kjo duket qartazi nga arritjet ndër vite. E nisi udhën e saj në vitin 2002 me 53 nxënës. Sot në vitin shkollor 2013-2014 janë regjistruar mbi 650 nxënës duke filluar nga kopshti, në nëntë vjeçare e deri në të mesmen. Në këtë vit shkollor ka gjithsej të regjistruar në kopsht 50 nxënës, fillore 100, në nëntë-vjeçare 150 dhe në të mesmen 350. Gjithsej ka nxjerrë pesë matura, ku po të llogaritet sipas përqindjes 100% kanë fituar të drejtën e studimit për në shkollat e larta, përjashto ato nxënës që për arsye personale nuk kanë dashur të vazhdojnë studimet e larta. Në këtë shkollë ka mjedise të bollshme, kabinete të pajisura, bibliotekë e kabinet të plotë informatike. Risi sivjet për herë të parë do të mësohet dhe gjuha gjermane krahas gjuhës angleze dhe asaj italiane. Shkolla "Sarina" është një progres dijesh. Synimet kryesore të shkollës jo publike "Sarina" janë: Emancipimi shpirtëror dhe zhvillim të personalitetit; zhvillimin e mendimit dhe veprimit të pavarur, kritik, krijues, konstruktiv e tolerant; edukimin e vlerave atdhetare, njerëzore, morale e demokratike; mundësimin e krijimit të shanseve të barabarta për të gjithë nxënësit; aftësimin e tyre për përballimin e jetës; realizimin e potencialit të individit dhe zhvillimin e mëtejshëm të këtij potenciali; përparimin e shoqërisë nëpërmjet aftësimit të qytetarëve për përfshirjen aktive në ushtrimin dhe zhvillimin e demokracisë; mbarëvajtjen e ekonomisë së tregut të lirë nëpërmjet aftësimit të forcave të punës për të përballuar ritmet e larta të rritjes ekonomike dhe të zhvillimit teknologjik.

Shkolla jo publike "Sarina" siguron për nxënësit e saj: pprograme bashkëkohore të miratuar nga MASH, staf të përzgjedhur mësuesish, kushte tepër të mira mësimdhënie, numër të kufizuar nxënësish në klasa, përdorim të metodave bashkëkohore të mësimit dhe edukimit, siguri dhe kontroll shëndetësor periodik, ushqim cilësor, mjedise çlodhëse, sportive, fusha, minifutbolli, volejbolli,basketbolli, palestër etj, komunikim në çdo moment me prindërit, monitorim të vazhdueshëm procesit mësimor dhe edukativ etj.

Janë të shumtë ato nxënës që kanë dalë pikërisht nga shkolla jo publike "Sarina" e sot punojnë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Dhe ndjehen krenarë që kanë hedhur hapat e parë të dijes pikërisht në këtë shkollë ku sot është bërë një promotor dijesh dhe idesh. Drejtor i shkollës këtë vit është zoti Bexhet Aga, një kuadër me një përvojë të gjatë në fushën e mësimdhënies, e pikërisht këtë përvojë të tij pozitive, po e sjell dhe në shkollën jo publike "Sarina"

"EUROVIZION": NE DIMË TË JAPIM MË TË MIRËN...

Në rrugën e Kavajës, vetëm pak metra pa vajtur tek shkolla teknologjike, në krahun e djathtë të rrugës ngrihet godina e shkollës jo publike "Eurovizion", një godinë mjaft e bukur, me mjedise të bollshme për një shkollë në qendër të Tiranës. Shkolla jo publike "Eurovizion" është hapur për herë të parë në vitin 2007 si shkollë e mesme dhe fillimisht kishte vetëm 20 nxënës. Në vitin 2010 është hapur po në këtë godinë edhe shkolla 9-vjeçare. Matura e



parë në vitin 2009 doli në masën 70%. Këtë vit shkollor janë regjistruar mbi 130 nxënës. Çdo klasë nuk ka më shumë se 16 nxënës. Drejtori i shkollës, i cili ka ardhur në këtë vit të ri shkollor pas një përvoje të gjatë në arsimin publik në shkolla të mesme në Tiranë, është gjirokastriti Dilaver Koçiu.Vetë emri i kësaj shkolle përmban se çfarë do të përfaqësojë kjo shkollë në të ardhmen. Shkolla "Eurovizion" do të ketë një të ardhme vërtet europiane.

"Ne nuk mund të shkojmë në Europë si komb pa rritur dhe edukuar një brez me vizionin drejt Europës, - shprehet drejtori i shkollës. Si drejtor i ri që jam bashkë me administratorët kemi përcaktuar filozofinë e re që do të ketë shkolla dhe u ra dakord si bord që shkolla do funksionojë si një shkollë cilësore dhe elitare. Që të arrihet kjo duhet të kalojmë në disa faza: Konsolidimi dhe respektimi rigoroz i rregullores së shkollës në mënyrë që shkolla të funksionojë si institucion ku mbi të nuk do qëndrojë individi, por rregullorja e shkollës; të gjithë ato mësues e nxënës që nuk do ta mbështesin këtë rregullore nuk do jenë pjesë e shkollës, sepse cenojnë vizionin e shkollës; punë me nivel të lartë pedagogjik dhe shkencor nga stafi dhe si rrjedhojë vlerësime reale ndaj nxënësve ku i vetmi vlerësim me mësuesit do jetë krahasimi i rezultateve të studentëve në universitetet me ato që i kemi vlerësuar ne në shkollën tonë; informacioni shkencor do interpretohet në monitor dhe do përdorim mjetet moderne. Nëse vërtet do të vazhdojë kështu siç e ka nisur, kjo shkollë do të bëhet model në të gjitha shkollat e vendit tonë. Për këtë është optimist jo vetëm drejtori i shkollës por dhe vetë administrator i saj, zoti Mufit Xharri.

"MIGJENI": RRUGA PËR MË SHUMË DIJE...

Në Kamëz, pikërisht në Laknas, ngrihet godina e shkollës jo publike "Migjeni". Shkolla ka mjedise për kopsht, ciklin e ulët, 9-vjeçarë dhe të mesëm. Shkolla për herë të parë është hapur në vitin 2008 dhe administrator i saj është z. Gëzim Hyseni nga Reçi. Ai vjen nga një familje arsimdashëse, kështu që edhe synimet për shkollën i ka të larta. Në vitin e parë shkolla kishte gjithsej 65 nxënës. Në vitin shkollor 2010-2011 u hap dhe shkolla e mesme me 22 nxënës. Sot në vitin shkollor 2013-2014, kjo shkollë në të gjitha ciklet ka 170 nxënës. Pra, në një kohë relativisht të shkurtër, shkolla ka ardhur në rritje. Te shkolla "Migjeni" është rruga për një dije më shumë. Në këtë shkollë është drejtoreshë Enisa Hyseni. Shkolla është e kompletuar me të gjitha kabinetet përkatëse si fizikë, kimi, informatikë, sallë arti. E veçanta e kësaj shkolle është se këtu në këto kthehet në një qendër kulturore e artistike. Si shkollë është përfaqësuar në rang kombëtar dhe pikërisht vallja e kësaj shkolle fitoi çmimin e parë. Valbona Saliu është jo vetëm mësuese arti, por dhe përgatit nxënësit në aktivitete kulturore e artistike. Biblioteka e shkollës mjaft e pasur ku janë të pakët ato nxënës që nuk e frekuentojnë bibliotekën duke lexuar kështu mjaft libra artistik. Shkolla jo publike "Migjeni" e ka justifikuar plotësisht emrin e madh që mbart, e ka



vlerësuar me dije, kulturë e disiplinë rigoroze. E veçanta është se çdo ditë të hënë këtu bëhet ngritja e flamurit dhe këndohet himni kombëtar nga kolektivi mësues e nxënës. Ndër aktivitetet e shumta që organizuan në vitin jubile të 100 vjetorit të pavarësisë, i gjithë kolektivi i kësaj shkolle veshi uniformën e re përgatitur vetëm për këtë jubile. Në të gjitha katet e shkollës, në korridore, ka mjaft stenda të përgatitura me kujdes nga mësueset përkatëse si për historinë, gjeografinë, letërsinë, firmëtarët e pavarësisë, Kosovën etj.

:Kur e emërtuam shkollën tonë me emrin e Migjenit të madh, - thotë administratori Gëzim Hyseni, ishim në dilemë se a do ta justifikonim këtë emër. Sot jemi të bindur se e meritojmë plotësisht emrin e Migjenit.

* * *

Vitet e fundit janë hapur mjaft shkolla private në vendin tonë, që nga kopshtet deri te universitetet. Shumë prej tyre edhe me synime të drejtëpërdrejta fitimi, por ajo që ndodh me shkollat që kanë hapur tre dibranët, është për të marrë shembull. Liman Hoxha me shkollën "Sarina", Mufit Xharri me shkollën "Eurovizion" dhe Gëzim Hyseni me shkollën "Migjeni", janë një shembull për t'u ndjekur nga shumë shkolla private në vend, madje edhe shtetërore. Të ndjekësh shembullin e tyre, ke ndjekur një rrugë të suksesshme, jo vetëm për biznes, por edhe në shërbim të arsimit dhe edukimit të brezave të rinj.

Foto Ese

Fotot: Ole Elfenkämper,
© Të gjitha të drejtat e rezervuara



Miniera e Bulqizës

Revista Balkanist është një botim dygjuhësh në anglisht dhe serbisht, që boton analiza dhe komente mbi politikën, kulturën, kritikën, për një audiencë më të zgjedhur ndërkombëtare.

Qëllimi i saj është të sigurojë mbulim të guximshme, pa kompromis të rajonit të Ballkanit dhe çdo gjë në lindje të saj. Ajo ka shfaqur synimet për të qenë të pavarur, nuk ka lidhje me ndonjë organizate, kompani apo institucion.

Në numrin e fundit ajo botoi një ese me foto nga greva e Minatorëve të Bulqizës, të cilën ne po e përcjellim për lexuesit tanë.

Nga **SREĆKO ŠEKELJIĆ**

Banorët e Ballkanit tradicionalisht kanë pasur një ndjesi adhurimi për minatorët, e ngjashme ndoshta me atë që ndjejnë amerikanët për zjarrfikësit. Këta dy grupe njerëzish bashkohen jo vetëm nga imagjinata e përbashkët që krijohet nga helmetat, çizmet, dhe kushtet e vështira e të rrezikshme për jetën të punës.

Zjarrfikësit në Perëndimin janë ngritur në lavdi për shkak se shpëtojnë pronat dhe jetët e të tjerëve, duke rrezikuar të tyret. Në vendet komuniste, minatorët u panë me admirim sepse rrezikuan jetën e tyre ndërsa po siguronin kushte më të mirë ekonomike për vendin dhe bashkëqytetarët e tyre.

Duke gërmuar minerale të çmuara dhe qymyr, elementët kyç të industrisë së rëndë dhe energjisë, ata ishin në pararojë të zhvillimit ekonomik të vendit. Shtetasit e vendeve komuniste kishin një ndjenjë të fortë krenarie për prodhimet e tyre industrial dhe për klasën punëtore proletare, muskujt dhe çekiçët e të cilës ngrinin pluhur e tym mbi minierat e fabrikat, edhe pse ky tym ishte në një masë të madhe prodhim i propagandës së regjimit. Minatorët kishin një rol të dallueshëm mes "udarnikëve", një term i përdorur për të përshkruar punëtorët "supërprodhues" në gjithë bllokun komunist sovjetik.

Jugosllavia madje nxori në treg edhe një kartëmonedhë me figurën e njërit prej minatorëve më produktivë të të gjitha kohërave, Alija Sirotanovic, i nderuar me Medaljen e Heroit të Punës Socialiste, e katërta mes dekoratave të larta shtetërore. Ai dhe grupi i tij i punës nxorën nga toka 152 ton qymyr në një turn, duke vendosur një rekord të ri botëror për industrinë minerare, një rekord që më parë mbahej nga Aleksey Stakhanov nga Bashkimi Sovjetik. Kur Marshalli Tito e pyeti se çfarë donte si shpërblim, Sirotanovic thuhet që ju përgjigj që donte një lopatë më të madhe.

Kur u qartësua që ekonomia e kontrolluar po dështonte dhe filluan krizat e para politike, minatorët ishin ndër të parët që protestuan në kërkim të një qeverie më të përgjegjshme dhe një shoqërie më të drejtë. Në përiudhën post-komuniste, shumë prej tyre janë përfshirë në greva për të reaguar ndaj kushteve të pasigurta të punës dhe pagave të ulta.



Për pesë ditë me radhë, minatorët marshuan në parkun afër zyrës së qeverisë së Sali Berishës, për fat te keq, pa pasur sukses.



Një minator lexon gazetën e ditës ndërsa të tjerët bisedojnë. Ditët e grevës zakonisht karakterizohen nga mërzia.



Një minator përpara minierës së kromit në Bulqizë.




Bahi Bajraktari gjatë një interviste televizive në ditën e dytë të grevës së urisë.



Gratë e minatorëve që ishin në grevë urie 1400 m poshtë tokës.



Minatorët gjatë një interviste për një kanal televiziv shqiptar.



Shenja në fillim të galerisë së zënë: Greva e urisë së minatorëve të Bulqizës."




Një minator merr pak pushim në fillim të galerisë përpara ndërrimit të turneve. 10 minatorë akoma punojnë për të nxjerrë ujin me pompë nga niveli i 16-të (1600 m nën tokë) i minierës. Nëse ata ndalojnë së punuari për tetë orë, miniera do të mbushej me ujë.



Paga mesatare e një minatori është 40 deri në 45.000 lek (320 Euro) në muaj, që nuk del për një familje. Punëtorët harxhojnë rreth 10.000 lek në muaj për shëndetin. Në shumë raste, kompania nuk mbështet punëtorët me sigurime.



Pas 1 viti punë nën tokë trupi ndikohet nga gazrat, më pak hidrogjen, dhe punë e rëndë. Shumë prej punëtorëve kanë sëmundje të rrugëve të frymëmarrjes, tension të lartë dhe probleme serioze me zemrën. "Ne punojnë si skllevër," thonë minatorët.



Artur Dardha, një nga 15 minatorët që u bashkua me grevën e urisë



Kol Nikolli, presidenti i Konfederatës së Sindikatave të Pavarura ju flet mbështetësve të minatorëve të grevës së urisë pasi i ka vizituar ata 1400 m nën tokë.

Bulqiza, një minierë kromi në lindje të Shqipërisë, ishte burim i krenarisë kombëtare në vitet 80, ndërsa Shqipëria zinte vend në tre vendet e para prodhuese të kromit në botë dhe miniera zinte 80% të prodhimit kombëtar. Pas rënies së komunizmit, industria minerare shqiptare u shkërmoq.

Viteve të fundit, minatorët e Bulqizës kanë hyrë në grevë disa herë për të protestuar kushtet e padurueshme të punës dhe vdekjen tragjike të disa bashkëpunëtorëve të tyre.

Ky kontekst na sjell në Bulqizë, një minierë kromi në lindje të Shqipërisë. Bulqiza ishte burim i krenarisë kombëtare në vitet 80, ndërsa Shqipëria zinte vend në tre vendet e para prodhuese të kromit në botë dhe miniera zinte 80% të prodhimit kombëtar. Pas rënies së komunizmit, industria minerare shqiptare u shkërmoq.

Kushte e punës u keqësuan, dhe përkujdesja e sigurisë u la mënjanë fare. Ndodhën shumë dëmtime e madje edhe vdekje. Edhe "Raporti për të drejtat e njeriut" i Departamentit Amerikan të Shtetit theksoi për minierën e Bulqizës se: "Shumica e aksidenteve përfshinin përplasje në minierë për shkak të mungesës së masave dhe procedurave të përshtatshme të sigurisë... Ligji nuk ju siguron punëtorëve të drejtën që ta largojnë veten nga situata të rrezikshme pa vënë në rrezik edhe vetë punësimin e tyre".

Viteve të fundit, minatorët e Bulqizës kanë hyrë në grevë disa herë për të protestuar kushtet e padurueshme të punës dhe vdekjen tragjike të disa bashkëpunëtorëve të tyre. Në vitin 2005, Kryeministri Sali Berisha premtoi të rishikonte masat e sigurisë në Bulqizë pasi një aksident vrau pesë minatorë. Por dy vite më vonë, dy minatorë të tjerë vdiqën ndërsa punonin në turnin e tyre, ngjarje që nxiti kolegët e tyre të fillonin grevën. Për fat të keq, protestat u zbehën për shkak të zgjedhjeve dhe nuk kishte përmirësim të dukshëm të situatës.

Në vitin 2011 protestat në Bulqizë zgjatën për tre muaj, duke u kthyer në protestën me kohëzgjatjen më të madhe që nga protestat anti-komuniste të 1991-shit. Pas pesë ditë demonstrimesh në Tiranë, minatorët përsëri filluan një grevë urie.Pas bisedimesh të gjata mes punëtorëve dhe pronarëve të minierës, u duk që minatorët fituan. Në tetor të 2011-tës, studiuesja Ermira Danaj tha: "Këtë radhë, minatorët kanë fituar, por është nga të paktat fitore për punëtorët që kërkojnë të drejtat e tyre. Pronarët e minierës premtuan që të vazhdojnë investimet në minierë, në një mënyrë transparente. Ata ranë dakord gjithashtu që të përmirësojnë kushtet e punës, të paguajnë pagën e 13-të, të paguajnë punëtorët për gjysmën e kohës që ishin në grevë, dhe të rrisin pagën me 20%."

Megjithatë, vetëm 12 ditë pas kësaj fitoreje të deklaruar, një shpërthim i madh vrau një punëtor dhe plagosi tetë të tjerë. Sipas Raportit të të Drejtave të Njeriut, në një kohë të shkurtër më pas, një tjetër minator vdiq kur një masiv dheu e varrosi brenda minierës. Këtë radhë, miniera e Bulqizës u mbyll përkohësisht. Minatorët nuk i morën asnjëherë pagat e premtuara për muajt që kaluan në grevë. Sot, kushtet e punës për minatorët nuk po përmirësohen – një problem që i përshkron të gjithë vendet ish-komuniste të Ballkanit. Këto janë disa foto nga protestat e minatorëve të Bulqizës, të fotografuara nga Ole Elfenkamper.

Përktheu dhe përgatiti për botim:
Afrim Karoshi

Migjenit duhet t'i ngrihet një përmendore e madhe në mes të lulishtes, pikërisht aty ku Lulët mblidhen natën vonë, bëjnë llogarinë e ditës dhe presin urbanin e fundit që t'i çoj pranë familjeve.

Luli dhe misrat e pjekur!

Nga **Shaqir SKARRA**

As vetë nuk e di se si krejt rastësisht një natë para se të udhëtoja për në Peshkopi po lexoja edhe një herë Migjenin. Kanë kaluar më shumë se shtatëdhjetë vjet që atëherë e më dukej se i madhi Migjen shkruante për një kohë të afërt, shkruante për këtë kohë që po jetonim ne sot. Poema e mjerimit ishte ulur në vatrat tona, Lulët e vegjël ishin shtuar nëpër shkolla, nëpër rrugë. Mundohen sado pak të ndihmojnë prindërit e tyre për të zbutur varfërinë, këtë plagë të madhe të shoqërisë njerëzore, këtë armik të përbashkët të popullit tonë... Mëngjesi i ditës së nesërme më gjeti në një furgon udhëtarësh në linjën Tiranë-Peshkopi. Shumica e pasagjerëve ishin emigrantë që punonin në vise të ndryshme të Greqisë e pas një periudhe të gjatë po ktheheshin tashmë pranë familjeve . Kishte emigrantë që ishin bashkë me familjet tyre ku fëmijët nuk dinin asnjë fjalë shqip. Sa keq!, vërtet sa keq. Edhe kjo një tjetër plagë e rëndë e shoqërisë tonë. Mes humorit, bisedave të ndryshme por edhe politikës nuk e dëgjuam fare rrugën e gjatë e të lodhshme por dhe në shumë vende të dëmtuar ku furgoni më së shumti kërcente nëpër gropat e shumta se sa ecte normal. Pak metra pa vajtur në Klos shoferi frenoi në mënyrë të shpejtë e të gjithë pasagjerët që ishim në furgon u përplasëm keq me njëri tjetrin. Nuk dinim se çfarë kishte ndodhur por shoferi me shpejtësi hapi derën e doli jashtë, pas tij filluam të dalim dhe ne të tjerët. Për çudi të të gjithëve në mes të asfaltit një djalë i vogël jo më shumë se 10-12 vjeç ishte përplasur nga furgoni dhe ndodhej para nesh i shtrirë për tokë. Nuk ishte vrarë por vetëm se ishte trembur shumë. I hodhi pak ujë një grua nga një pagure plastike që e kishte marrë me vete dhe sakaq djali u ngrit në këmbë. Mjekra i dridhej e nga zgavrat e syve i dilnin lot vazhdimisht. Para këmbëve të tij të zbathura , vetëm me një palë shapka (dhe këto të grisura) ishin derdhur në asfaltin e zi mbi pesë gjashtë misra të pjekur. Djaloshi ende i trembur nga ajo që i ndodhi në mes të rrugës e fare pranë shtëpisë së tij shikonte udhëtarët me habi e dridhej sikur të kishte bërë një faj të madh e për çfarë kishte ndodhur vetëm pak minuta më parë e quante veten fajtor. Fajtor se kërkonte të punonte, fajtor se kërkonte të shiste misrat e sapo pjekur që të fitonte diçka, fajtor se kërkonte edhe në këtë moshë të vogël të ndihmonte familjen e tij e t'ju vinte në ndihmë sado pak prindërve.

- Si quhesh?, e pyeti djaloshin një pasagjer.

- Luli!. Jo nuk ishte Luli i vockërr i Migjenit. As vetë nuk di pse në këtë çast po thuaj tragjik ku jeta e këtij djaloshi të vogël kishte qenë në fije të perit m'u kujtua Luli i vogël i Migjenit që e kisha lexuar një natë më parë. Nuk kishte ndonjë ndryshim të madh me Lulin e vogël. Jo askund nuk ndryshonte. I dobët, thatanik, i zverdhur në fytyrë. Jo! Vetëm nuk kishte tollumba të hapura si Luli, kishte një palë shapka të vjetra .Kishte dhe një kanotiere veshur e një palë pantallona të shkurtra. Ndoshta telepati, ndoshta... nuk di s'i më ndodhi as vetë një natë më parë që para se të shtrihesha për të fjetur po lexoja Migjenin e madh. Një kohë e largët që atëherë, shumë vite kanë kaluar por ja që ende Migjeni qenka gjallë. Jo, jo! Migjeni nuk vdes kurrë me atë që na ka lënë ne por ende epoka migjeniane, ende ai realitet i hidhur i atyre viteve kur jetoi e shkroi Migjeni tek ne ekziston. Ky që kishim përballë ishte Luli ynë, Luli i të gjithëve, Luli i shoqërisë shqiptare, Luli i këtij realiteti që po jetojmë sot por që kishte shumë të ngjarë me periudhën migjeniane. Luli nuk e kishte babën. I i shte vrarë në minierën e kromit. Jetonte vetëm me nënën e sëmurë dhe një motër më të vogël. Luli dilte çdo ditë pikërisht në këtë vend, piqte misra dhe dilte me shpejtësi para shokëve të tij t'jua shiste pasagjerëve të furgonave që udhëtonin në këtë rrugë. I duhej që të siguronte lekët për të blerë librat e shkollës. Nëna i kishte thënë se do ta ndalonte nga shkolla. Nuk kishte mundësi me i blerë libra,çantë apo dhe rroba. Jetonin tre veta me një gjysmë pensioni nga minatori i vdekur në minierë. Luli bashkë me shokët e tij pothuaj e kishte këputur arën me misër pranë rrugës nacionale duke i pjekur vetë e duke ua shitur çdo ditë pasagjerëve që udhëtonin në këtë rrugë nacionale. Pasi i blemë misrat e pjekur, paguam Lulin, e lamë atë në punën e tij të përditshme dhe nisëm udhëtimin tonë drejt Peshkopisë. Djaloshi me shpejtësi i gëzuar u fut në arë e filloi ndoshta përsëri në zhveshjen e misrave për t'i pjekur e për t'i shitur më vonë ndoshta udhëtarëve të tjerë që do të kalonin kësaj rruge. Rruga deri në Klos është e shkurtër por para nesh na dolën shumë Lula të tjerë. Të gjithë me misra të pjekur. Po jo vetëm kaq, jo!. Kjo ishte një distancë e shkurtër rruge por me shumë Lula të vogël. Të gjithë jemi dëshmitar që po shikojmë çdo ditë nëpër lokale e rrugica, fëmijë të vegjël; dikush duke shitur cigare e dikush kinkaleri të ndryshme. Ka dhe të tjerë që dikush kullot bagëtitë e dikush ka marrë i vogël udhët e kurbetit, dikush mbledh gur kromi në ngricë e acar e dikush i është future dhe profesionit të lypësit. Ky është në fakt realiteti ynë i hidhur. Shesin fëmijët e vegjël, shesin dhe në mbrëmje vonë kthehen pranë shtëpive të tyre e bëjnë llogari se sa kanë fituar. Ka kohë që e kanë braktisur shkollën. Me aq sa mundin u vijnë në ndihmë familjeve. Sa shumë, vërtet sa shumë Lula ka sot tek ne. Edhe Luli i vocërr i Migjenit erdhi në metropolin Shqiptar. Tashmë i lodhur, i dërrmuar deri në sfilitje shpirtërore. Erdhi për një jetesë ndryshe dhe në fakt pa me sytë e tij dhimbjen e madhe që ishte ulur dhe në kryeqytetin e shqiptarëve, ndaj e braktisi shkollën, i fshehu librat diku në ndonjë sënduk të vjetër dhe filloi tregtinë e cigareve.

E pikërisht tashmë rilindja duhet të nis nga kjo shtresë e shoqërisë tonë, nga kjo dhimbje e madhe njerëzore. Kur të luftohet armiku i vetëm i shqiptarëve siç është varfëria e papunësia, atëherë them se nuk do ketë më Lula nëpër rrugët tona. E kaluam qytezën e Klosit por ende na buçonte zëri i njëjtë: Hajde misra të pjekur! Jo, jo! Jemi të bindur se sot Migjenit duhet t'i ngrihet një përmendore e madhe në mes të lulishtes, pikërisht aty ku Lulët mblidhen natën vonë, bëjnë llogarinë e ditës dhe presin urbanin e fundit që t'i çoj pranë familjeve.



64 vjeçari që gdhin e ngryset në dëllinja



Një histori vërtet e dhimbshme dhe e trishtë e një 64 vjeçari që i përket komunitetit egjiptian, i cili aktualisht i gdhin dhe i ngrys ditët në dëllinja edhe pse një jetë ka qenë në shërbim të komunitetit. Ruç Rushiti, 64 vjeç, nga fshati Dragu i Bulqizës, para viteve '90-të, u ka shërbyer banorëve të këtij fshati si kovaç.

Pas viteve '90-të, për gati 10 vite shërbeu si çoban i këtij fshati. Në gusht të vitit 2001, nis dhe kalvari i vuajtjeve për të, që nuk i ndahet edhe në ditët e sotme. I divorcuar nga bashkëshortja dhe 5 fëmijët, me një gjendje ekonomike krejt të rrënuar, në kushtet e një tronditje të fortë psikike, me shpresën për gjetjen e një jete më të mirë ekonomike për të, ai si shumë të tjerë i drejtohet emigracionit. Por, në pamundësi për të kaluar kufirin drejt shtetit fqinj të Greqisë, stacionohet në qytetin jugor të Sarandës, ku dhe nis punën si çoban.

Pasi punon aty për 12 vite radhazi dhe nuk gjen prokopi për tu rimëkëmbur financiarisht, pasi pronari është mjaftuar duke e ushqyer vetëm me bukë, krejt i sfilitur dhe zhgënjyer rikthehet në vendlindje në fshatin Dragu të Bulqizës, për të kaluar ditët e fundit të jetës, siç shprehet vetë ai.

Por edhe rikthimi në vendlindje ka rezultuar zhgënjyes për të pasi shtëpinë e ka gjetur të shembur tërësisht, ku dallohen vetëm gjurmët e themeleve të mbuluara edhe ata nga ferrat. Për ish familjen, thotë ai, as që bëhet fjalë, pasi ish bashkëshortja u aksidentua para tre viteve dhe humbi jetën duke mbledhur krom në stoqe për të rritur fëmijët.

Aktualisht Ruç Rushiti, 64 vjeç, "jeton" prej 40 ditësh, pas kthimit nga Saranda, në trojet e tij të braktisura të mbuluara nga ferrat dhe dëllinjat krejtësisht në qiell të hapur.

Befasohesh dhe ndjen trishtim tek e sheh të ketë për shtroje vetëm dy batanie dhe një copë plasmani, të cilat i shpalos në dëllinja për tu tharë nga lagështira e natës, që ka filluar të ftohet.

Në të tilla kushte duket qartazi se ai është kapluar nga një paralizë parciale, pasi ecjen e ka tejet të vështirë dhe po kaq të vështirë e ka edhe për të artikuluar fjalët, aq sa edhe emrin e tij nuk është në gjendje ta tregojë saktësisht.

Pa punë, pa pension, pa ndihmë ekonomike, pa asnjë lloj përkrahje, ai e mban frymën gjallë vetëm me një copë bukë kur ja japin fqinjët.

Sipas fqinjëve, merret vesh se 64 vjeçari nuk kërkon asgjë tjetër nga pushteti lokal vetëm një barakë për të futur kokën dhe mos të sulmohet nga kafshët e egra, si dhe për tu mbrojtur nga agjentët atmosferikë dhe të ftohtit e jashtëzakonshëm të Bulqizës, gjatë stinës së dimrit që po vjen.

Përkundër kësaj pamje mjaft mjerane dhe të dhimbshme, mbetet e pa shpjegueshme përcjellja indiferente prej 40 ditësh e organeve të pushtetit vendor, që mund dhe duhet të lëvizin në këtë drejtim, pasi nesër kur të gjendet i pa jetë mbuluar nga dëbora dhe i pangrënë, do jetë tepër vonë.

Edhe banorët e këtij fshati që shprehin dhimbje dhe mëshirë për 64 vjeçarin e komunitetit egjiptian, Ruç Rushiti, nund dhe duhet të kontribuojnë që në bashkëpunim me pushtetin lokal, të gjendet apo mundësohet një strehë për të sa ai të mundë që të fusë kokën brenda, për t'i kaluar ditët e fundit të jetës në mjerimin e vetminë e thellë të tij.

H.Likdisha

propozimi

Shqiptarë nga të pesë kontinentet kërkojnë të ngrihet atje një kompleks i madh historik në vlerë të Heroit të Madh Kombëtar, betejave të tij fitimtare, qëndresës historike të dibranëve kundër pushtuesve.

Dibra meriton një **kompleks** të madh të **lavdisë historike**

Nga **Abdurahim ASHIKU**



Më 22 shtator 2013, kalendari historik shqiptar shënoi 100 Vjetorin e Kryengritjes së Madhe Populllore të Dibrës dhe dibranëve kundër pushtuesit serb, një ngjarje kjo brilante që i bën nder jo vetëm Dibrës por mbarë shqiptarëve, kësaj dhe asaj ane të kufirit të paprecedent shqiptaro-shqiptar.

Ishte rasti që Dibrës dhe dibranëve që luftuan dhe ranë në ato beteja legjendare tu ngrihej një monument, një obelisk madhështorë në Dibër të Madhe dhe në Malet e Dibrës, atje ku krisma e pushkës së parë u kthye në gjëmim dhe në një sulm të paparë në historinë shqiptare.

Kjo ngjarje u kalua në heshtje nga autoritetet shtetërore, si të mos kishte ndodhur asgjë. Megjithatë, mendoj se duhet parë përpara, duhet që Dibrës t'i japim atë që nuk i është dhënë kurrë, ti japim namin e vet historik.

Para disa ditësh hodha në internet një fotografi me pamjen e Luginës së Drinit të Zi me sfond Sinën, vendlindjen e Skënderbeut, Çidhnën me historinë e krimit më të madh të hordhive pushtuese osmane, Arrasin e "Qeverisë së Arrasit"...

Në fotografi, në pikën e bukur të Thekanushit (Sukës së Arrasit) vura një yll si shenjë dalluese e vendit. Mbi fotografi shkrova: ***"Sikur në pikën ku kam vënë yllin (Suka e Arrasit) të vendosej Skënderbeu i hipur mbi kalë Ai do të dukej me satelit në të gjithë botën. Sipër është SINA vendlindja e tij".***

Për habinë time mbi fotografi klikimet vazhdojnë të rriten ditë për ditë. Shqiptarë nga të pesë kontinentet kërkojnë të ngrihet atje një kompleks i madh historik në vlerë të Heroit të Madh Kombëtar, betejave të tij fitimtare, qëndresës historike të dibranëve kundër pushtuesve. Shumë nga ata kanë kërkuar të kontribuojnë me kursimet e tyre modeste për ngritjen e monumentit.

Disa që nuk njihnin as Sinën dhe as historitë që lidheshin pikërisht me këtë pikë historike të trevës së Dibrës, më kërkuan hollësi për vendin dhe ngjarjet. U përcolla disa shkrime të mijat si "Kthimi i Gjergj Gjon Kastriotit në vendlindje", "A do të shkojë Gjergji i Gjon Dibranit në Sinë hipur mbi kalë?", "A do të vijë Gjergji i Gjon Kastriotit-Skënderbeu me një shesh në Athinë? ...me idetë e mija modeste për ngritjen pikërisht në atë vend të një kompleksi të madh historik e turistik me një monument të madh të Skënderbeut në bronz që do të dukej nëpërmjet satelitit në të gjithë botën.

Mendoj që i takon Dibrës dhe dibranëve një nder e privilegj historik i përmasave mbarëkombëtare. Mendoj që çdo 6 maj, festës populllore të Shëngjergjit, çdo vit të organizohen atje dhe në të gjithë trevën e Çidhnës festime të mëdha populllore.

E quaj këtë si një obligim Tuajin t'i jepni Dibrës atë që i takon asaj dhe lidhur me të shqiptarëve mbarë kudo që jetojnë, kësaj e asaj ane të kufirit shqiptaro-shqiptar. Skënderbeu duhet të kthehet në vendlindje. Ai u takon shqiptarëve në Qendrën Gjeografike të tyre. Dibrës duhet ti jepet i gdhendur në një monument madhështor nami i saj i madh në histori.

Ju ftoj që këtë kërkesë ta mbështesni të gjithë, të mëdhenj e të vegjël, në pushtet e në opozitë, dibranë, matjanë, shkodranë, mirditorë, kuksiane, tiranas, elbasanas, vlonjate, myzeqarë, korçarë, kosovarë, tetovarë... shqiptarë kudo që jetoni nëpër botë.

Dhe jo vetëm ta mbështesni moralisht, por edhe ta mbështetni artistikisht dhe financiarisht. I bëni vetes nder!


Mërgimtar në Greqi,
24 shtator 2013



Gazetari Abdurahim Ashiku që prej kohësh banon në Greqi, u ka bërë një thirrje publike Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit të Shqipërisë, drejtuesve të partie politike parlamentare, deputetëve të Dibrës dhe organeve vendore të qarkut të Dibrës, që të marrin parasysh ndërtimin e një kompleksi historik, i cili të përfaqësojë historinë e Dibrës, por që kanë një ndikim shumë të madh edhe në zhvillimet historike mbarëkombëtare.

Ky kompleks do të simbolizonte luftërat që nga epoka e Skënderbeut deri në kryengritjen dibrane të vitit 1913, atëherë kur u vendos ndarja e territoreve shqiptare, por që Dibra e vuajti më shumë, duke u ndarë në dysh. Ndarja e Dibrës ka qenë një nga aktet më makabre të Konferencës së Londras, dhe parë me legjislacionin e sotëm ndërkombëtar, mund të thuhet se është edhe një akt gjenocidi. Për këtë arsye, redaksia mendoi se propozimin e redaktorit tonë në Athinë ta bëjë publike.

Ndërtimi i një kompleksi historik, jo vetëm që do të njihte brezat e rinj me atë çka ndodhur ndër shekuj me Dibrën, por do t'i mësonte ata që të mos bëjnë në të ardhmen gabimet e së kaluarës. Ndërsa Dibra do të zinte vendin e merituar në kujtesën historike të popullit dhe historiografinë shqiptare.



Konferencë Shkencore në Dibër të Madhe
për 100 vjetorin e kryengritjes së Dibrës 1913

Rruga e Arbërit nr. 89
veprimtari

Fakte të reja mbi gjenocidin serb dhe copëtimin e Shqipërisë

Nga **Rexhep TORTE**

Në organizim të Komunës të Dibrës së Madhe, të shtunën më 28 shtator 2013, u organizua Konferencë Shkencore për 100 vjetorin e Kryengritjes së Dibrës në vitin 1913. Kjo konferencë u mbajt në restorantin "Uraniku" të banjave të Dibrës-Capa, ku merrnin pjesë qindra të pranishëm nga Dibra, Tirana dhe Peshkopia.

Mr.Ruzhdi Lata, kryetar i komunës së Dibrës së Madhe, duke i përshëndetur të pranishmit, deklaroi se, "Përshëndes popullatën dibrane dhe me kënaqësi të veçantë më shumë se 100 vëllezërit dhe motrat tona që kanë ardhur nga Tirana. Ky është një rast i veçantë në historinë tonë më të re. Siç thotë Naimi "Kush nuk mëson nga e kaluara e vet historike, zot ruajna është i detyruar ta përsërisë historinë. Ne mendojmë që historinë tonë të mos e përsërisim sepse kemi mësuar shumë nga historia 100 vjeçare sepse Dibra ka qenë në shënjestër nga të gjitha llojet e sistemeve politike që kanë kaluar në këto troje, por Dibra jetoi në zullumin që iu bë, në vështirësitë që i përjetoi, në migrimet në faza të ndryshme, duke filluar para 100 vitesh kur dibranët u nisën për në Tiranë, kur bëheshin lëvizjet diplomatike për çështjen Shqiptare, kur Tirana shtroi sofrën e mikpritjes, kur Dibra u zbraz, kur trimat rrokën pushkën e dolën në mal. Profesorët e nderuar me trajtesat do ta prezantojnë të kaluarën tonë që ne i kemi dëgjuar nga gjyshërit dhe prindërit tanë tregime dhe ngjarje historike për vëllezërit tanë trima. Në vitin 1913 popullata dibrane është masakruar nga forcat serbe. Ne jemi të një gjaku të një trualli dhe kemi patur të njëjtin fat. Të shpresojmë se me ngritjen e vetëdijes sonë, arsimimi, puna, përkushtimi dhe solidariteti do të mundësojnë që ne të ecim para për ardhmërinë tonë dhe të fëmijëve dhe të trashëgimtarëve tonë. Kjo konferencë nderon Dibrën dhe Tiranën".

Sajmir Shatku, sekretar i Shoqatës "Bashkësia Dibrane" shtoi se "si brezi i pasardhësve tanë jemi shumë të kënaqur që ndodhemi në qytetin e të parëve tanë, në qytetin me vlera, me tradita, me fisnikëri, që kanë lënë mbresa tek të parët tonë por edhe në krijimtarinë artistike dhe në veprimtarinë historike te trashëgimia kulturore. Ne kemi ardhur si grup i komunitetit dibran, i cili jeton në Tiranë, për të shënuar 100 vjetorin të shpërnguljes së dibranëve në Tiranë dhe për të marrë pjesë në konferencën shkencore për 100 vjetorin e kryengritjeve dibrane. Ne kemi ardhur në kuadër të një komuniteti dibran. Me këtë rast do ti dorëzojmë një certifikatë Mirënjohje për Mr.Ruzhdi Lata kryetarin e Komunës së Dibrës së Madhe nga komuniteti dibran në Tiranë me rastin e 100 vjetorit të egsodit dibran dhe 20 shtatorit të vitit 1913 dhe të 100 vjetorit të kryengritjes dibrane të shtatorit të vitit 1913, për ruajtjen dhe kultivimin e lidhjeve ndërmjet dibranëve në Tiranë dhe dibranëve në Dibër të Madhe. Mr.Ruzhdi Lata jeton e vepron në Dibër të Madhe por zemrën e ka në Tiranë. Do të ftoja edhe zotin Nijazi Kosovrasti, kryetarin e Këshillit Bashkiak të Tiranës, i cili jeton në Tiranë, por zemrën e ka në Dibër të Madhe.

Njazi Kosovrasti duke e dorëzuar mirënjohjen tha se "përshëndes qytetarët e Dibrës, bashkëqytetarët e mij pas 40 viteve të takohemi dhe ti forcojmë këto lidhje tona. Para disa ditësh në Tiranë unë në emër të Këshillit Bashkiak i dorëzova këngëtarit Haxhi Maqellara titullin "Mirënjohje e qytetit të Tiranës". Mr.Ruzhdi Lata, është autoritet shumë spikatur që me kaq zgjuarsi e mençuri ka arritur për një kohë kaq të shkurtër këtë lidhje shumë të fuqishme në mes dibranëve këtu, dibranëve në Tiranë dhe dibranëve kudo që janë". Mr.Ruzhdi Lata falenderoi për këtë gjest shumë të kulturuar dhe respekt ndaj tij. Dibra, shtoi Lata duhet konsideruar nga Mavrova deri në Kalanë e Dodës duke mos i harruar asnjëherë dibranët në Tiranë".

Ilir Krosi, kryetar i bashkisë së Peshkopisë, tha se se "është emocion i veçantë kur në Dibër të Madhe mblidhemi për evenimente të tilla kaq të rëndësishme, që evokojnë vlerat e mëdha që ka Dibra, por na frymëzojnë ne për angazhimet dhe detyrat e mëdha për të çuar gjithnjë më përpara amanetin e dibranëve që kanë sakrifikuar dhe dhënë jetën për këtë emër të madh që mban Dibra sot. Ne, udhëheqësit e dy Dibrave, do të punojmë vazhdimisht për forcimin e marrëdhënieve tona.



Mr.Ruzhdi Lata:
...Sepse kemi mësuar shumë nga historia 100 vjeçare, sepse Dibra ka qenë në shënjestër nga të gjitha llojet e sistemeve politike që kanë kaluar në këto troje, por Dibra jetoi në zullumin që iu bë, në vështirësitë që i përjetoi, në migrimet në faza të ndryshme, duke filluar para 100 vitesh kur dibranët u nisën për në Tiranë...

ZBARDHJE E NGJARJEVE NËPËRMJET DOKUMENTEVE HISTORIKE

Prof.dr Mahmud Hysa: "Këto tema për qytetin tonë janë të dhimbshme. Çdo ngjarje historike, çdo kryengritje, çdo revoltë, çdo konflikt na intereson të gjejmë shkakun, sepse shkaku e kthen ngjarjen në pasojë. Gjithë ajo kryengritje e furishme, e stuhishme që për një periudhë prej 20 ditësh e gjunjëzoi një ushtri serbe aq të tmerrshme.

Pse dibranët u revoltuan, pse dibranët u çuan në kryengritje, çka i shtyri, pse mbetën të pakënaqur. Shkaku kryesor i kësaj kryengritje ishte Konferenca e Ambasadorëve në Londër. Dibra, Gjakova dhe Shkodra ishin tri qytetet për të cilat u fol në konferencën e Londrës. Dibra herë iu bashkua trungut të vet dhe herë u nda, ashtu siç ka mbetur sot. Konferenca në Londër erdhi si rezultat i luftërave Ballkanike, i aleancës Ballkanike, i katër shteteve Ballkanike, të cilat si hijena iu vërsulën Shqipërisë, që ta copëtojnë,grabisin dhe ti pushtojnë sa më shumë tokat dhe territore shqiptare shtetet grabitqare ishin Serbia, Bullgaria, Greqia dhe Mali i Zi. Prishja e ekuilibrit Ballkanik nuk u përshtatej gjashtë fuqive të mëdha, Anglisë, Francës, Gjermanisë, Austro-Hungarisë, Italisë dhe Rusisë. Më 17 dhjetor 1912 ato u takuan në Londër për të caktuar tezat se si duhet të bëhet ngjarja dhe përkufizimi i shteteve të reja që u themeluan pas kapitullimit të Turqisë. Tezat e ndarjes ishin të shumta, si ai që e fiton luftën ti jepej e drejta që të okupojë territore, Serbisë t'i jepej një korridor që të del në Adriatik nëpërmjet Shëngjinit, tezat e pazareve, të kompromisit, e drejta fetare etj. U themelua edhe komisioni për caktimin e kufijve etnogjeografik, gjë që nuk u respektua asnjëherë. Kështu që shtetit Shqiptar i mbeti koka në një anë e trupi në anën tjetër, u nda fshati nga qyteti që ishte diskriminuese për shqiptarët dhe motivi kryesor i Kryengritjes Dibrane. Serbia e sulmoi Dibrën me 40 mijë ushtarë me vrasje psikopatologjike tmerruese, me pasion për të vrarë, me sadizëm, me vrasje barbare të grave, fëmijëve dhe pleqve. Të gjitha këto shqiptarët i përballuan me dinjitet, stojicizëm me martivizim dhe sakrifica në mbrojtje të lirisë dhe trojeve shqiptare".

Prof.dr Uran Butka: "Ndodhemi në një nga kryeqendrat më të shquara të kombit tonë. Kryengritja e Dibrës e vitit 1913 ishte një kryengritje popullore shqiptare kundër okupimit serb dhe Vendimeve të Konferencës së Londrës për copëtimin e Shqipërisë. Zëvendës konsulli Anglez në Manastir, i cili më 26 shtator 1913 raporton në ministrinë e tij se shkaku kryesor i fillimit të kryengritjes qëndron në vendimin e pa drejtë të Konferencës së Londrës kundër shqiptarëve. Kjo kryengritje u përhap edhe në krahina tjera shqiptare në Lumës, Mat, Tetovë, Kërçovë, Gostivar, Ohër, Strugë dhe Pogradec, Prizren, në Malësisë së Gjakovës dhe në Dukagjin dhe deri në Mat. Kjo kryengritje shumë e rëndësishme në historinë e kombit tonë dëshmonte për luftën çlirimtare dhe qëndresën kombëtare nuk është pasqyruar si dhe sa duhet në Historinë e Shqipërisë dhe të kombit tonë. Historianët e shtetit shqiptar dje dhe sot e kanë anashkaluar dhe në botimin voluminoz "Historia e Shqipërisë", kryengritja e Dibrës është përmendur pak dhe pa cituar asnjë dokument arkivor shqiptar apo të huaj. Historianët e Maqedonisë e të Kosovës kanë bërë përpjekje të dallueshme për ta trajtuar objektivisht, por ajo ende nuk ka zënë vend në tekstet e historisë apo në ato shkollore.

Data e saktë e fillimit të Kryengritjes të Dibrës 1913 kërkon argument dhe ballafaqim me dokumentet që kanë dalë në dritë kohët e fundit. Ka të dhëna që kjo kryengritje nuk ka filluar më 19 shtator, por në fillim të shtatorit por edhe më parë kur u përhap lajmi i kobshëm se Dibra do të mbetej jashtë trungut të shtetit Shqiptar, pas vendimit të 29 korrikut 1913 të fuqive të mëdha për copëtimin e Shqipërisë. Kjo vuri në lëvizje komandantin Elez Isufi me shokë që të fillojë kryengritjen, në të cilën u vranë 1000 ushtarë serb dhe u zunë 350 robër. U themelua Qeveria e përkohshme e Dibrës, spitali për mjekimin e të plagosurve dhe u tregua një sjellje humane ndaj robërve serbë pas kësaj serbët me forca të mëdha e shtypën kryengritjen duke përdorur masakrat që e habitën botën. Kjo shkaktoi shpërnguljen masive të popullatës".

Prof.dr Agron Tufa: "Kjo ngjarje është një nga treguesit e dinjitetit të dibranëve dhe e tërë shqiptarëve. Sa ruajmë ne në kujtesë këto ngjarje tragjike dhe si pasqyrohen në aspektin historik në linjën shtetërore, sepse kryengritja e Dibrës hasi në dyer të mbyllura të historiografisë shqiptare. Ismail Strazimiri në kujtimet e tij " Lufta kundër pavarësimit të Shqipërisë", thotë se në histori ka tri ditë, dje, sot dhe nesër, ai me këtë rast shprehën edhe cinizmin mbrendashqiptar. Agron Tufa përmendi edhe një epizod të tij me profesorin Jorgo Panajoti, i cili minimizonte trimërinë dhe heroizmat dibrane dhe që jepte më shumë rëndësi luftës së Vlorës kundër Italianëve se sa kryengritjes dibrane. Shkenca komuniste nuk lejonte të shkruhet për luftërat dhe heroizmat e dibranëve. Shkenca komuniste jeton edhe sot duke mohuar gjakun e derdhur dhe sakrificat e dibranëve për liri dhe pavarësi. Ismail Strazimiri pasqyron dhe demaskon pa drejtësitë e kronikave për Dibrën, duke thënë se trimërinë e dibranëve e njohin armiqtë serbë, bullgarë, grekë dhe malazezë.

Sipas tij luftën e Vlorës e ndihmuan nga vendi dhe jashtë me para dhe armatime, ndërsa kryengritjen e Dibrës nuk e ndihmuan", tha në fund Tufa.

Prof.dr Qerim Lita, dha dëshmi interesante për kryengritjen e Dibrës 1913 nga burime policore, diplomatike historike serbe dhe bullgare. Sipas tij bullgarët pretendojnë që këtë kryengritje ta përgjysmojnë dhe përvetësojnë. Konferenca e Ambasadorëve në Londër i dhuroi Serbisë gjysmën e trojeve shqiptare, por Serbia kërkonte më shumë duke i okupuar ushtarakisht. Ajo u tërhoq nga një pjesë e trojeve shqiptare pas ultimatumit që i dha Austro-Hungaria, por me gjithë atë i ndaloi disa tregje shqiptare në Kosovë. Suksesi okupues i ushtrisë serbe bazohej në faktin se ishte e armatosur shumë më mirë se sa kryengritësit shqiptar.

Lita foli edhe për nismën e kahmotshme të prefekturës së Dibrës për Pllakën Përkujtimore në Gostivar për viktimat e kryengritjes 1913. Kjo e dha idenë që prof.dr Mahmud Hysa të kërkojë nga kryetarët e Dibrës së Madhe dhe të Peshkopisë që sa më parë të nisin ndërtimin e Pllakës Përkujtimore për të rënët në kryengritjen e 1913.

Prof.dr Gafur Zoto, foli për Këshillin Administrativ të Dibrës gjatë periudhës së Kryengritjes, duke dhënë fakte dhe duke zbardhur personalitetin e patriotit dibran Sefedin Pustina, patriot i harruar edhe pse ishte eksponenti kryesor dhe më i rëndësishëm i kësaj ngjarje për Dibrën. Sefedini ishte kryetari i parë i Qeverisë së atëhershme të Dibrës. Ai përmendi veprimtarinë e familjes Pustina nëpëmjet Sulçe, Nurçe, Alush, Ali, Ibrahim dhe Shaqir Pustina që me patriotët e tjerë, nëpërmjet Besëlidhjes Dibrane kërkonin përdorimin e gjuhës shqipe, gjë që i shqetësoi së tepërmi turqit. Ata nëpërmjet Klubit "Bashkimi" sensibilizonin arsimin shqip dhe përgatitnin Kongresin e Dibrës 1909 dhe reagonin ndaj reformave turke".

Prof.dr Sajmir Shatku foli për Gjenocidin në Dibër të madhe sipas të drejtës ndërkombëtare juridike. Kryengritjet shqiptare kishin për qëllim mbrojtjen e interesave kombëtare por edhe përshpejtimin e mëtejshëm të premtimeve me karakter politik dhe ushtarak për zgjidhjen e çështjes shqiptare. Gjenocidi paraqet një vepër kriminale me një rrezikshmëri të madhe shoqërore. Gjenocidi ka qenë i pranishëm gati 100 vite ndaj popullit dhe trojeve shqiptare.

Në arkivin e shtetit Shqiptar gjenden të pluhurosura dhe të anatemuara nga rrethanat e kohës mijëra faqe historike që argumentojnë me fakte dhe prova se ndaj popullsisë shqiptare është kryer gjenocid dhe janë kryer krime anti-njerëzore të cilat kanë qenë sistematike nga militantët dhe paramilitantët serbë dhe bullgarë. Për këtë shkruan edhe Haki Stërmilli në librin "Dibra në prag të historisë".

Është detyrë e historianëve dhe e juristëve që të zbulojnë dhe krijojnë efekte juridike, për të bërë një analizë të hollësishme dhe për të ngritur padi në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë për Gjenocidin serb në trevat shqiptare dhe veçanërisht në Dibër të Madhe. Është detyrë e shtetit Shqiptar që të angazhohet për këtë çështje qoftë për dëmshpërblimin monetar por edhe moral, që duhet ta japin Serbia, Mali i Zi, Greqia dhe Bullgaria që janë anëtare të OKB-së dhe të KE, që kanë ratifikuar dhe njohur kartat e drejtave të njeriut, që tu kërkojnë falje publike shqiptarëve për gjenocidin dhe masakrat e kryera", tha në fund Sajmir Shatku.

Dëshmorë të Kryengritjes Populllore dibrane
të 22 shtatorit 1913

Kryengritja e dibranëve - Shtator 1913, në shtypin e kohës

Nga **Abdurahim ASHIKU**

Dibra, kryengritja populllore kundër pushtuesve serbë dhe politika e egër e gjenocidit ndaj shqiptarëve që ushtronin shovinistët serbë, zë, në prag të Luftës së Parë Botërore, faqet e para të shumë gazetave të kohës që botoheshin brenda dhe jashtë vendit.

Jehonë të gjerë bëri veçanërisht kryengritja populllore e shtatorit e vitit 1913.

Gazeta "Shqypnia e re" e cila dilte dy herë në javë, mundohet ta pasqyrojë kryengritjen populllore në Dibër gjerësisht. Në lajmin me burim nga Vlora të datës 25.IX, gazeta jep sihariqin: "Dibra asht marrun me nji luftë të rreptë të shqiptarëve, të cilët e kanë ndjekun anmikun deri në fushë të Ohrit" Në lajmin e po asaj date, por tashmë në mbrëmje dhe nga një burim tjetër, Elbasani, theksohet se "Dy sahat ma parë erdh nji njeri prej sheshit të luftës, i cili lajmon se anmiku kje shty deri në Pyll të Zezë dhe i muernë 11 topa, 2 mitraloza dhe shumë xhephane", se "Lëvizje e madhe ka edhe ka ana e Lumës dhe e Prizrenit".

Në të dy lajmet e tjera, që botohen në faqen e katërt e që janë marrë në kohë të ndryshme të natës, tregohet se "Lufta u nis në malësi. Malësorët kryengritës bashkë me qytetasit e Dibrës të dishpruem nga barbarizmat serbe i ranë anmikut dhe e shtynë në tri anë, në Gostivar, në Kurçovë e Strugë. Zaptuen 13 topa, xuen 300 serb rob e prishën fare pesë batallona"

Në një lajm të datës 27 shtator tregohet se jo vetëm Struga, Gostivari e Ohri janë marrë , por është marrë edhe Gjakova, ndërsa Prizreni është rrethuar. Dy lajme të tjera të marrë njeri më 27 shtator në mbrëmje e tjetri natën, vetëm pak orë para botimit të gazetës, tregojnë se "Në Ohër asht ngrehun qeveria shqiptare".

Kjo dendësi lajmesh, ky interesim për ngjarjet, duke i ndjekur ato ditën dhe natën, tregojnë se ato ditë jetohej me ngjarjet e Dibrës, me luftën e popullit shqiptar për mbrojtjen e tërësisë tokësore.

Një tablo të plotë, jo vetëm të teatrit të luftimeve, por edhe të heroizmit popullor, na jep gazeta "Përlindja e Shqypnisë", Organ i Qeverisë së Vlorës. Madje ajo na jep edhe emrat e atyre që "ranë dëshmorë për lirimin e atdheut të vet, të cilëve historia meriton t'i shkruaj emnat e tyne për kujtim të përjetshëm".

Në këtë numër gazeta, duke folur për "malet plotë famë e nder", luftën dhe unitetin luftarak të tyre thotë: " Sot, pra, ka një marrëveshje të plotë midis dy Dibrave... Me gëzim të madh luftëtarët tanë ngritën flamurin e Shqipënies...Qytetet qeverisen prej një komisie populllore" duke nxjerrë në pah unitetin, qëndrueshmërinë, aftësinë për tu vetëqeverisur-probleme këto që janë


VIT I, N. 25. Një numër 20 para. E Shtunë 9/22 Vjeshtë e III. 1913.

PËRLINDJA E SHQIPËNIËS

ORGAN PER ME MBROJTUR TË DREJTAT KOMBËTARE.

DEL NË VLONË ÇDEN E MËRKURË E TË SHTUNË.

diskutuar gjerë në këtë kohë në kanalet diplomatike e që i mohoheshin populllit shqiptar.

Burim lajmesh për gazetën "Liri e Shqipërisë", që botohej në Sofje, fillimisht janë agjencitë e huaja, të cilat theksojnë se "...shqiptarët e muntnë ushtrinë serbe pranë Dibrës dhe muarnë këtë qytet e po përparojnë drejt Ohrisë dhe Kiçovës"

Lajmet e agjencive dhe gazetave të huaja ajo i ballafaqon me lajmet që vijnë nga Beogradi duke theksuar se "Këto lajme duket se janë të vërteta se, në Belgrad janë shumë të trembun dhe po bëhen përgatitje të mëdha për të shuarë lëvizjen shqiptare, e cila po përhapet në tërë Kosovën". Gazeta fillon ta ndjekë luftën e dibranëve kundër pushtuesve serbë nëpërmjet korrespondentëve të saj në Durrës, Elbasan, Manastir etj., duke na pasqyruar hapat e kryengritjes, rritjen e saj, pjesëmarrjen e masave populllore, qëndresën e dëshpëruar të pushtuesve.

"Dishnica", një firmë që pasqyron ngjarjet në gazetë, ngre në një piedestal të lartë heroizmin populllor kur thotë: "Këto lajme mbushin me gëzim zemrat e shqiptarëve dhe i japin Evropës një mësim të plotë që kurrë shqiptari s'do durojë të jetë nën zgjedhë dhe se vendimet e Londrës s'mund të kenë forcë..."

Në gazetat e kohës shquajnë tituj të tillë si: "Dibranët dhe malësorët përreth po luftojnë kundër serbëve", "Dibranët dalin fitues në shumë beteja me serbët", "Dibranët janë 6 000". "Luftime të rrepta në Dibër". "Serbët hëngrën shuplakë nga shqiptarët e Dibrës", "Dibra shqiptare" etj.

Me gjithë politikën e heshtjes, që ndoqën fuqitë e mëdha ndaj ngjarjeve në Shqipëri, në këtë periudhë e veçanërisht ndaj kryengritjes populllore në Dibër dhe politikës së paparë të gjenocidit që ushtruan shovinistët serbë ndaj shqiptarëve, agjenci të ndryshme lajmesh, gazeta të ndryshme nuk munguan që të ngrenë zërin e tyre në anë të kryengritjes populllore të Dibrës. "Giornale d'Italia", "Wiener Alge meine Zeitung", "Neue Freie Press", "The dal mail", "Reichpost" etj., e pasqyrojnë kryengritjen e Dibrës që në ditët e para duke u munduar ta datojnë sa më saktësisht (10 të muajit, ora 10 në mëngjes), duke u munduar të japin edhe numrin e luftëtarëve ("Shqipëtarët 6 000 vetë"). Gazeta Wiener Alge meine Zeitung", duke folur për fqinjët e kryengritjes së Dibrës, na jep gjerësinë e luftës së shqiptarëve për të mbrojtur truallin e tyre shekullor. Ajo thekson: "Gazeta lajmërohet prej Shkodre se çeta shqiptare nën kryesinë e Isa Boletinit dhe të Bajram Currit, u përpoqën dhe i shtynë ushtritë serbe në Dibër dhe afër Prizrenit. Ushtarët malësorë i zunë gjithë malet e kufijtë.

"Giornale d'Italia" tërheq vëmendjen edhe për shqetësimet në Beograd: "Lajmi i të hymit të shqiptarëve në Dibër i turbulloi fare mendjet në Beograd. Me pesë ditë, thonë gazetat e Serbisë, do të gjenden në Shqipëri 40 000 ushtarë serbë"

Shtypi në këtë periudhë tërheq vëmendjen kryesisht në dy çaste kryesore; në qëndresën masive e heroizmin populllor kundër pushtuesve dhe terrorin e egër dhe reprezaljet e serbëve ndaj shqiptarëve. Barbarizmat, që u zhvilluan ndaj shqiptarëve, Fuqitë e Mëdha u munduan t'i mbulojnë me heshtje. Megjithatë gazetarë të disa gazetave më në zë të kohës, diplomatë e të dërguar të ndryshëm duke udhëtuar nëpër Dibër e në viset e tjera shqiptare, nuk mungojnë të ngrenë zërin e t'i japin shtypit dokumente të pakontestueshme për barbarizmat dhe mizoritë serbe.

Gazeta "Corriere de la Puglie" qe ndër të parat që përshkroi "Barbaritë serbe në Dibër". Bazuar në "shënimet që kishte marrur, duke shëtitur të gjitha vendet i dërguari i një fuqie të Evropës dhe pas të cilave i bëri guvernës së vet raportin".

Në këto përshkruhen reprezaljet e bëra në 103 fshatra, duke treguar me adresë të plotë varjet, vrasjet dhe djegiet në zjarr të mbi 1700 burrave, grave e fëmijëve. Djegien e mbi 1 600 shtëpive. Grabitjen e mbi 2 700 bagëtive të trasha, 21 000 të imta dhe 800 njëthundrakëve, grabitjen e një sasie të madhe lirash që e kalonin milionin. Në këtë numër nuk janë futur barbari të tilla masive që raporti i përmbledh me fjalët: "plaçkitën tërë fshatin dhe pasi morën gjithë ç'gjetën i vunë zjarrin dhe e dogjën fund e krye", "Gjindjen; gra, burra e çilimi i shkuan të gjithë në bajoneta", "s'është punë që mund të rradhiten emrat e gjithë të vrarëve"Barbaritë arritën në kulme të tilla: " të zotin (e shtëpisë A.A.) e therën në sy të s'ëmës plakë, të së shoqes dhe të fëmijës", "vranë me bajonetë një çupëz 6 vjetë", "hodhën të gjallë në zjarr një djalë 5 vjetësh, Shyqyrinë dhe një 4 vjetësh, Hasanin", "Zenelit i dogjën në zjarr gruan me një djalë në djep" etj., etj.

Një tablo ngjethëse të mizorive serbe jepet edhe në një përshkrim të titulluar "Udhëtim në Gollobordë" botuar në faqet 4 e 5 të dy numrave radhazi të "Përlindja e Shqipërisë" të janarit 1914.

Në gazetat e kohës, jehonë të madhe bëri letra e një ushtari serb, botuar në gazetën socialiste serbe "Randiçka Novine" më 22 tetor 1913, letër e cila u botua më pas në shumë gazeta të kohës.

"Shoku im i dashur, shkruante ai, gjëra të tmerrshme po ngjajnë. Unë po tmerrohen para tyre...Në këto anë nuk shikohet gjë tjetër veç kufomave dhe hirit"...

"Shqypnia e re", në numrin e saj të 20 nëntorit 1913, duke folur për barbarizmat serbe, nxjerr në pah edhe devizën e pushtuesit: "Asnjë t'falun, asnjë pshtim", ç'ka flet për egërsinë e pashembullt të këtij rrebeshi mesjetar ndaj shqiptarëve në trojet e tyre shekullore.

Kryengritja e shtatorit 1913 në Dibër ishte një kryengritje populllore, një kryengritje e masave, që ngriti në këmbë, siç theksojnë gazetat, mbi 6 000 luftëtarë. Dibra në këtë luftë foli me grykën e pushkës. "Do të vijë ora, thoshte Luigj Gurakuqi në një intervistë botuar në gazetën "Atdheu" ato ditë, kur populli ynë do të organizohet në udhën që do t'i tregojë organizimi i tij politik, gjer atëherë nuk mbetet veçse udha e armëve... Buçitja e armëve dëgjohet shpejt në veshët e Evropës. Do ta përdorim sa herë që veshi i Evropës është i shurdhër, që të na dëgjojë zërin, i cili nuk do të pushojë së kërkuari drejtësi"

Për vetë kushtet e asaj kohe me mjete të pakta komunikimi e ndërlidhjeje, mungesë kronistësh në fushën e betejës etj., dhe mbi të gjitha të politikës së heshtjes që ndiqnin Fuqitë e Mëdha të Evropës dhe shtetet ballkanike, lidhë kjo edhe me prapaskenat e turpshme që thurnin në kulisat e diplomacisë së fshehtë, gazetat arritën vetëm sa ta preknin problemin e Dibrës dhe barbarizmat që u ushtruan ndaj saj, politikën e një gjenocidi të tmerrshëm që u veprua në këtë kohë ndaj shqiptarëve me banim në trojet e tyre shekullore.

Dokumentet arkivale e në veçanti populllit me gojën e tij, janë një pasqyrë më e plotë e madhësisë dhe e forcës së kryengritjes populllore të Dibrës, e heroizmit populllor në luftë.

Botohet sipas gazetës "Ushtima e maleve", 24 shtator 1983 dhe "PO DIBRËS! JO SKAVICËS!" f. 263-267
Shënim: Citimet janë në shqipen e kohës

Sheh Hysen Kuqi i Dibrës së Madhe

Si sot 100 vjet më parë...

"Më parë se të vijnë luftëtarët në Dibër, - shkruan gazeta "Përlindja e Shqipërisë" Nr.13 Vjeshtë e Parë -1913 ushtria serbe burgoi tetëdhet veta nga parësia e vendit, me qëllim që t'i vrasin dhe të nesërmen. Kur u rradhuan për me i pumbos, i arritën Malësorët, andaj s'munden me i vra të gjithë, por veç pesë shpirt.

Këta janë ata që ranë dëshmorë për lirimin e atdheut të vet, të cilëve historia meriton t'i shkruaj emënat e tyne për një kujtim të përjetshëm: Sheh Hyseni, Sadullah Strazimiri, Ramiz beu, Karafil beu, NumanEefediu - U ndrittë shpirti".

Gazeta-"Përlindja e Shqipërisë" Nr.13 Vjeshtë e Parë -1913 Efendiu.

Në vitin 1878, në krah të Abdyl Frashërit, të Iljaz Pashë Dibrës dhe të shokëve të tyre që shkonin drejt Prizrenit ecte edhe një djalosh i ri. Bisedat me Abdylin në shtëpinë e tij, ngrohtësia e fjalëve që i jepnin jetë idesë së bukur për një Shqipëri të lirë nga pushtuesit osmanlinj, e ngritën peshë zemrën e Hysenit 23 vjeçar. I ati, Myslimi, i kishte folur shpesh për kryengritjet kundër turkut, për heroizmin e dibranëve në luftë me Hajredin Pashën më 1844, kundër të cilit kishte marrë pjesë edhe ai vetë, për luftërat e mëvonshme, që mbinin herë në njërën krahinë e herë në tjetrën në të gjithë Shqipërinë, duke i mbajtur zaptuesit vazhdimisht në grykë të pushkës.

Jeta në qytetin e Dibrës, që në atëkohë, ishte një ndër pikat kyçe të rrugëkalimeve për në Kosovë, Durrës, Elbasan, Gjirokastër etj., ambienti i teqesë të sektit bektashi, ku lindi dhe u rrit, sekt i cili ***"për hir të propagandës armiqësore që zhvillonte kundër Portës së Lartë, të tolerancës ndaj feve tjera dhe dallimit, që bënte midis islamizmit dhe kombësisë"*** (Histori e Shqipërisë V-I) do të formonin rrëkenë, që më vonë do të hapte rrugën e veprimtarisë patriotike të Hysenit. Nga ana tjetër, pritja dhe përcjellja në shtëpinë e tij të shumë udhëtarëve, të cilët në bisedat e tyre rrihnin mendimet përparimtare të kohës, mendimet plot bukë të Rilindjes Kombëtare, takimi disa herë me Abdyl Frashërin, vajtja në Prizren me të, marrja pjesë në mbledhjen patriotike, në Kuvendin e Dibrës dhe në mbledhjen e qershorit 1878 në Prizren, ku figuron edhe firma e tij midis shumë firmave të tjera; të gjitha këto do të shënonin hapa të tjerë të sigurt në veprimtarinë patriotike të Hysen Shehut, ose të Sheh Hysen Kuqit, siç njihet në qytetin e Dibrës dhe në tërë krahinën

Në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, sipas kujtimeve të bashkëkohësve, Hysenin e gjen në aktivitete të vazhdueshme në Prizren dhe në Dibër.

"Mbas shkatërrimit të Lidhjes së Prizrenit-shkruan Ismail Strazimiri,- nuk u fik shkëndija kombëtare në Dibër, por filloi me u këndellë si prushi nën shpuzë, derisa kur erdhi koha shkëlqeu"

Në këtë kohë Hyseni ndiqet nga autoritetet turke, arrestohet dhe internohet. Më vonë kthehet përsëri në Dibër. Në dokumentet e kohës ai paraqitet si njeri i qetë, "në hall të vet", që merret me teqenë e fenë e bile një fetar që ka përkrahur sektin, që i shkonte më për shtat Portës së Lartë, sektin Elveti. Por Hyseni nuk i zbatonte ritet e këtij sekti. Nuk mbante ramazan dhe kur ishte puna për të zgjedhur midis fesë dhe ndërgjegjes së tij ai ngrinte zërin: ***"Më mirë të bëjmë rrugën se sa të agjërojmë ramazanin"*** (Ishte fjala për ndërtimin e një rruge e që kundërshtarët kërkonin që të mos bëhej në atë kohë sepse ishte ramazan).

Hyseni, tashmë i formuar si Patriot, me ndjenjën e dashurisë për mëmëdheun do të kërkonte rrugë të reja për të çarë përpara. Lëvizja e gjerë për gjuhën shqipe, që siç



shkruante dëshmitari bashkëkohës Ismail Strazimiri, kur flet për shkollën e Seit Najdenit dhe shkollat e tjera: ***"Kjo shkollë ishte krejt e mçeft, klasat e saj ishin izbat e errëta të dyqaneve dhe odat e mçefta të shtëpive..." "Çdo fushë, livadh morën trajtën e një shkolle, ku mblidheshin grupe-grupe djemnia e re dhe mësofshin gjuhën e bekueme".*** Kjo lëvizje do të përfshinte edhe Hysenin bashkë me të vëllanë, Zylfiun. Shtëpia e tyre u bë dalëngadalë një qendër për mësimin e gjuhës shqipe. U hodhën edhe themelet për ndërtimin e një shkolle. Por autoritetet turke kuptuan qëllimin e bërjes së ndërtesës dhe dërguan zaptijet dhe e shembën. Autoritetet turke e kërcënuan Hysenin se do ta arrestonin dhe internonin.

Shkollimit të njerëzve me gjuhën amtare shqipe Hyseni do ti jepte pjesë nga jeta e tij edhe në vitet e mëvonshme e në veçanti pas vitit 1910, kur klubi i Dibrës mori iniciativën për të hapur 250 shkolla të reja shqipe.

Shpallja e Pavarësisë në Vlorë më 28 Nëntor 1912, bëri që të realizohej ëndrra shekullore e populllit, që luftoi me heroizëm për liri e pavarësi kombëtare. Dibra jetonte çastet e gëzimit të pakufi për lirinë e shumë pritur. Por shpejt gëzimi u prish. Një hordhi tjetër sulmoi Dibrën. Serbia synonte të dilte në Drin, Prat e Qafë të Buallit për të krijuar një urë lidhjeje për synimet e saj të mëtejshme drejt Durrësit. Dibra e cila ndjeu në palcë barbarinë dhe tehun e shpatës së re, nisi të përgatitej për luftë.

Në gazetat e kohës, me gjithë vështirësitë e komunikacionit dhe të ndërlidhjes, gjen një pasqyrim të mirë të luftës së dibranëve kundër pushtuesve serbë. Gazeta "G'iornale d'Italia" shkruan: ***"Një notë zyrtare thotë se më 10 të muajit, ora 10 në mëngjes, u përpoqën shqiptarët me ushtrinë serbe afër Dibrës. Lufta u ba e rreptë dhe mbajti gjer në mesditë... Shqiptarët, nja 6000, hynë në Dibër".***

Hyseni në prag të kryengritjes ndodhet në Zerqan. Meqenëse njihte mirë qytetin dhe kishte influencë në banorët e tij, dërgohet nga kryengritësit për të organizuar populllin në kryengritjen që përgatitej. Kështu ai hyn ilegalisht në Dibër dhe nis aktivitetin.

I biri, Hakiu, shkruan: ***" Baba rrinte në dhomën nalt. Vinin njerëz dhe e takonin... por spiunazhi i diktoi dhe e arrestuan"***

Për qëndrimin burrëror karshi shovinistëve serbë të Hysenit dhe të shokëve të tij është shkruar në këtë kohë nga disa gazeta brenda dhe jashtë vendit si "Përlindja e Shqipërisë", "Korriere delle Puglie", "Kalendari kombiar 1914" etj.

"Më parë se të vijnë luftëtarët në Dibër, - shkruan gazeta "Përlindja e Shqipërisë" Nr.13 Vjeshtë e Parë -1913 ushtria serbe burgoi tetëdhet veta nga parësia e vendit, me qëllim që t'i vrasin dhe të nesërmen. Kur u rradhuan për me i pumbos, i arritën Malësorët, andaj s'munden me i vra të gjithë, por veç pesë shpirt.

Këta janë ata që ranë dëshmorë për lirimin e atdheut të vet, të cilëve historia meriton t'i shkruaj emënat e tyne për një kujtim të përjetshëm: Sheh Hyseni, Sadullah Strazimiri, Ramiz beu, Karafil beu, Numan Efendiu. U ndrittë shpirti".

Kryengritësit dibranë Sheh Hysenin dhe shokët e tij, që u pushkatuan nga serbët i gjetën para portave të këshllasë (kazermave). Në varrimin e tyre morën pjesë mijëra kryengritës dibranë dhe banorë të qytetit të Dibrës.

Ndonëse në lëvizjet demokratike të viteve njëzetë u bënë disa orvatje për ta përjetësuar emrin e Hysen Shehut, duke i dhënë nënprefekturës së Zerqanit emrin e tij, nderimet e merituara do ti jepeshin këtij aktivisti të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe të Luftës për Liri e Pavarësi Kombëtare vetëm në vitet e pushtetit popullor. Në muzeun e vëllezërve Frashëri fotografia dhe të dhënat gojore për Sheh Hysenin qëndrojnë krahas dokumenteve të tjerë të vëllezërve pishtarë. Fotografia e tij qëndron gjithashtu në muzeun e dëshmorëve të tjerë të Luftës për Pavarësi Kombëtare.

Në kuadrin e 100 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të themeluar në Prizren Hysen Shehu (Kuqi) u dekorua me medaljen " Për veprimtari patriotike "

ABDURAHIM ASHIKU
Marrë nga gazeta "Ushtima e maleve"
3 shkurt 1979

Rruga e Arbërit nr. 89

jetë

Përtej vlerave të kampionëve në sport: *Dy ndeshje për një jetë...*



Dy vëllezër luftojnë në ring me vdekjen e një vajze

Ismail Keta, kampioni i njohur i botës në Kik dhe Taiboks dhe vëllai i tij Gjetan Keta, kampion europe në këtë sport dhe një nga boksierët më të njohur profesionist në Gjermani, kërkojnë të ndihmojnë 17-vjeçaren shqiptare Ambra Meda, gjimnazisten që po lufton me sëmundjen në një spital të Mynihut, duke dashur të fitojnë një ndeshje dhe të gjitha të ardhurat t'ia dedikojnë vajzës nga Tirana.

Ismailin të gjithë e njohim si kampion bote, madje jo një, por dy herë, në një sport të vështirë, si Kik Boks dhe në një vend po kaq të fortë, si Gjermania. I tillë është edhe vëllai Gjetani, që nuk i ngjan vëllait të madh vetëm me pamje dhe forcë, por edhe me shpirtin dhe fisnikërinë e tij. Pakkush mund t'i njohë ata si njerëz kampionë, si humanistë dhe figura kaq popullore, që bëjnë gjithçka për jetë njerëzish. Se sa e duan vendin e tyre, Bulqizën dhe Shqipërinë, këtë e dimë të gjithë, sepse ata pas çdo ndeshje të fituar, deklarojnë se këtë sukses ia dedikojnë pikërisht ngjyrave kuq e zi, familjes dhe të gjithë shqiptarëve. Por motivi i këtij shkrimi, është një deklaratë e tyre e fundit, ku të dy këta djem kampionë, kërkojnë të zhvillojnë dy ndeshje, për të shpëtuar jetën e një vajze, jetën e Ambrës.

Gjetani e ka caktuar datën e ndeshjes më 12 tetor në Mynih, ndërsa për Ismailin situata është pak me ndryshe, sepse ai është dëmtuar dhe ka bërë një operacion në gju para dhjetë ditësh. Por, ai e ka vendosur për të dalë në ring për të fituar për Ambrën dhe federata ndërkombëtare do të vendosë për datën e ndeshjes gjatë muajit nëntor. Të dy vëllezërit kampionë, po i zhvillojnë këto dy ndeshje të paplanifikuara për të mbledhur të ardhurat për të ndihmuar Ambra Medën, një vajze dibrane, e cila është në gjendje e shtruar në gjendje të vështirë në një spital nga më të mirët në Mynih, qytetin ku banon prej vitesh familja Keta.

Në fakt, ata kanë ditë që ndihmojnë dhe bëjnë përpjekjet e tyre të mëdha, që jeta e saj të shpëtojë, por kostoja që kërkohet kalon shifrën e 180 mijë eurove.

Një shumë e tillë për një familje shqiptare, kuptohet që është më shumë se e madhe, ndaj ata tashmë bashkë me vëllain tjetër Ajetin dhe bashkëshorten e Ismailit, Brunën, janë bërë pjesë e kësaj ndihme. Përveç shtëpisë që kanë lënë në dispozicion të prindërve të Ambrës, ushqimit, fjetjes, ndihmojnë me makinën e tyre, por edhe përkushtimin e përditshëm dhe ecejaket në dyert e spitalit.

Gjithsesi, kjo është njëra anë e medaljes. Pjesa më e rëndësishme, është mbështetja që kërkojnë të jenë edhe financiarisht promotor në këtë situatë të veçantë dhe të vështirë për Ambrën. Ajo është 17-vjeç dhe vuan nga një sëmundje tejet e vështirë. Doktorët atje dhe rregullat në fuqi, kërkojnë këtë shumë që për prindërit dhe të afërmit e Ambrës është e papërballueshme. Edhe pse ka nxjerrë shtëpinë në shitje, babai i Ambrës, Skënderi e ka të pamundur të shkoj në ato nivele financiare. Megjithë thirrjen dhe mbështetjen përmes rrjeteve sociale, unë dhe miqtë e mi kemi arritur të bëjmë vetëm një pjesë të vogël të asaj shume monetare që duhen për jetën e saj. Ndërkaq, Ismaili dhe Gjetani, zgjodhën një tjetër rrugë, atë të betejës përmes rezultatit sportiv dhe forcës e aftësive të tyre. Ata kanë deklaruar se do t'i zhvillojnë këto ndeshje, jo vetëm për titullin kampion bote, por dy ndeshje për një jetë njeriu, për vajzën si engjëll, Ambra. Madje, Ismaili udhëtoi vetë në Tiranë për disa ditë radhazi, duke udhëhequr një fushatë sensibilizimi në mediat kryesore në Tiranë, duke ftuar shqiptarët që të bëhen pjesë e ndihmës për bashkëkombësen e tyre që po lufton me vdekjen.

Gjesti i tyre ka bërë jehonë edhe në mediat gjermane, madje njëra nga gazetat kryesore sportive shkruante: "Dy vëllezër luftojnë në ring me vdekjen e një vajze"... Një shembull, jo vetëm për t'u admiruar, por për t'u përkulur me shumë respekt ndaj vlerave qytetare dhe humane të dy djemve shqiptar, që jetën e një njeriu e kanë më të shtrenjtë se paraja, apo lavdia e tyre...

Këta janë kampionët e vlerave njerëzore, njerëz që jo vetëm në këtë rast kanë treguar se sa vlejnë. Ismail Keta dhe vëllai i tij, Gjetani, duhet të shërbejnë si frymëzim për shoqërinë shqiptare, pse jo edhe atë europiane apo botërore. Që të ndihmosh një jetë është gjëja më e çmuar. Natyrisht që, ata këtë veprim e shkruajnë në rërë dhe e harrojnë që nesër, por të gjithë ne duhet ta shkruajmë në gur dhe ta gdhendim në piedestalin e kohës që jetojmë.

Të tilla veprime duhet të bien edhe në veshin e strukturave të larta shtetërore, Presidentit të Republikës apo kryeministrit të vendit. Me shembullin e tyre, ata kontribuojnë në një imazh të mirë të shqiptarëve në botë, ashtu siç ne dëshirojmë. Dhe një vlerësim për ta nga shteti shqiptar, do të ishte një vlerësim i madh.

Dy ndeshje dhe një titull për një jetë, për një jetë të një vajze që vlen më shumë se milionat apo miliardat, për një engjëll që kërkon të jetojë si gjithë të tjerët, por edhe një titull, për një njeri që kërkon të mbajë në jetë me çdo kusht, jo një fëmijë të tij, por një vajzë shqiptare, që sheh në sy çdo ditë, shkëndijën e shpresës të një kampioni dhe humanisti të madh.

Dhe këta janë Ismail dhe Gjetan Keta!



Ndihmoni Ambrën!

Vajza që shihni në foto është Ambra Meda, 17-vjeçarja që në vend që të ulej në bankat e gjimnazit "Sami Frashëri" në Tiranë, është e detyruar të qëndrojë e shtrirë në këtë shtrat të spitalit Schawbing në Mynih në Gjermanisë, ku po vendoset fati i saj me jetën!
Sëmundja e rëndë na ka mbledhur të gjithëve së bashku për tu bërë pjesë e kurimit të saj. Prej më shumë se një muaji ajo vuan nga një diagnozë e vështirë duke shënuar rastin e 130 në të gjithë botën! Sipas mjekëve, ky është rasti i parë që ka mundësi shpëtimi, por kostoja është shumë e lartë!
Do t'ju lutesha të shënoni emrin tuaj në jetën e Ambrës, duke u bërë pjesë me një kontribut sado modest.

Në Shqipëri:
Numri i llogarisë në BKT është:
NERILDA MEDA, në lek:
AL86205116507082 53CLIDCLALLF
në euro:
AL91205116507082 53CLIDCFEURA.

Në Gjermani:
Deutsche Bank, PGK AG
Kontonummer:
6159339 Bankleitzahl: 70070024
Për ata që jetojnë jashtë Gjermanisë:
IBAN DE16 70070240615933900 BIC (SWIFT): DEUTDEDBMUC

Për të gjithë dashamirësit që duan të kontribuojnë nga jashtë shtetit, po ju japim llogaritë bankare në 3 forma, mos harroni SWIFT kodin sepse është shumë i rëndësishëm.

Banka Kombëtare Tregtare

IBAN në dollar:
AL54205116507082253CLIDCFUSDD
IBAN në EURO:
AL91205116507082 53CLIDCFEURA
IBAN në lekë:
AL86205116507082 53CLIDCLALLF
SWIFT: NCBAALTX

Ju keni në dorë që kjo buzëqeshje e saj të mos jetë e fundit!
Ndonëse po kalon një provë tejet të vështirë, Ambra me buzëqeshjen e saj të dlirë ju fton të gjithëve që të kontribuoni për shërimin e saj.

Për kontakt:
Në Shqipëri: Cel: 069 81 51 070
Në Gjermani: 004915145918491

cyan magenta yellow black

solidaritet

Redaksia ju fton të kontribuoni në shërimin e Ambrës. Shënoni emrin tuaj në jetën e saj, duke u bërë pjesë e solidaritetit mbarëshqiptar!

Solidaritet dhe fisnikëri nga shqiptarët anembanë

Nga **Dëfrim METHASANI**

Çdo ditë takoj njerëz në rrugë që më ndalojnë dhe më japin diçka... ka edhe prej atyre që thonë mos e shkruaj emrin, rëndësi ka të shpëtojë ai engjëll (mbesa). Një grua pensioniste, Fedra Rama apo gazetarja Tefta Radi, më kërkonin ndjesë për shumën... Ju thashë që jeni në krye të listës shpirtërore. Ka patur mjaft njerëz që janë bërë pjesë pa na njohur fare. Tri nëna nga Kanadaja, njëra quhet Terezina Marku nga Shkodra, bashkë me dy shoqet e saj, njëra nga Lazarati tjetra nga Kosova, dërguan diçka simbolike duke u bërë pjesë e dhimbjes. Dhe më thoshin që "Ambra tani është edhe e jona". Disa fëmijë, Klovis dhe Dea Karoshi, dy motrat, Sara dhe Viola Makishti, por edhe një djalë i vogël, Enea Nako, iu thonë prindërve të tyre që kursimet tona i kaloni tek Ambra, se jeta e saj është më e rëndësishme se dhuratat për ne.

Po kështu një zonjë e nderuar që punonte te Kuvendi i Shqipërisë nga Shkodra, që m'u lut të mos ia përmendja emrin, por i takonte Kastratëve të Shkodrës, më vjen me lot në sy e më takon, duke sjellë edhe një shumë të konsiderueshme. Ajo kishte patur një ngjarje të tillë dy vjet më parë me bashkëshortin e saj... Dua të veçoj edhe spitalin e Peshkopisë, që dhanë shpirtin e tyre, por edhe shkollën "Shyqyri Peza" në Tiranë me drejtoreshë Shigjeta Tafani Canaj, e cila u bë pioniere e kësaj mbështetjeje. Por edhe shkolla "Sami Frashëri" ku është nxënëse Ambra; kanë ditë që mbledhin ndihma me nismën e vetë nxënësve dhe shokëve e shoqeve të Ambrës. Po kështu, një ministadium futbolli në Sohodoll të Peshkopisë, me emrin "Liridon Methasani", ka vendosur një kuti pranë fushës së sportit dhe janë mbledhur ndihma. Një bashkëqytetar në Amerikë, Luan Cibaku në mes të qytetit ku jeton ka vendosur kutinë e ndihmave; në Zvicër, Skënder Krasniqi nga Prishtina; në Kosovë, Milaim Krasniqi dhe Sabush Selmani; në Mynih, Valon Marke një djalë nga Dibra e Madhe, po bën gjithçka me gjithë familjen e tij; në Bruksel, Beshir dhe Leme Shira, brenda një spitali ku punon vetë kjo grua shqiptare kanë mbledhur ndihma... Në Tiranë janë edhe shkollat "Fan Noli" dhe shkolla jopublike "Sarina", në Pogradec dhe Fier, por edhe fakulteti Ekonomik ku studion motra e Ambrës, Nerilda Meda në vitin e dytë. Në RTSH, shumë miq dhe kolegë të mi, komshi, gjaku ynë, shoqëria etj..

Mbresëlënëse ishte mbështetja e ish-pronarit të prindit të Ambrës në Korfuz. Quhen Sokrat dhe Marie, të cilët kanë depozituar kontributin e tyre. Deri dje ishin bërë afro 50 milionë lekë të vjetra edhe pse shuma është shumë e madhe: kalon 180 mijë euro vetëm terapia. Klubi Sportiv Kosova në Mynih duhet përgëzuar, por edhe ekipi i volejbollit "UMB Volej", që të gjitha vajzat dhe trajneri Hasan Gurabardhi iu përgjigjën ftesës së kapitenes Klejda Shkurti duke dhënë një kontribut. Disa miq biznesmenë, si Përparim Golli, Musa Rricku, Flamur Hoxha, Latif Miha, pronari i "Gega Oil", pronari i hotel Tiranës Ramë Geci, por edhe shumë të njohur e të panjohur. Ish- mësuesit



e mi të shkollës dhe trajnerët e sportit, Rexhep Zebi në Kanada, Nexh Lazimi në USA, por edhe mjaft miq e shokë, shqiptarë kudo në botë janë bashkuar me Ambrën. Fadil Begu nga Peshkopia më thoshte që sot e nisa ditën jo nga zyra e punës, por nga banka duke derdhur një shumë të familjes sime për jetën e asaj vajze aq të bukur. Buzëqeshja e saj të fton ta duash dhe të mos e lejosh të vdesë...

Së fundmi, është gjesti i dy vëllezërve kampionë, Ismail dhe Gjetan Keta që do bëjnë dy ndeshje për të fituar jetën e Ambrës... Po ashtu, dua të falënderoj kryebashkiakun e Sarandës që na ka qëndruar afër. Më ka prekur shumë Ndrekë Ismaili, invalid, që më dha një shumë dhe më tha "më ofendon nëse ma kthen". Po kështu edhe kolegu im, Mejdan Zhivani, gazetar sportiv, që akoma është pa u shëruar pasi ka kaluar tri ndërhyrje kirurgjikale, me gjithë familjen e tij u bënë pjesë e ndihmës... Nga Dibra e Madhe, Bajram Kllobçishta po bën nisma me gjithë shqiptarët atje, ndërsa në Kumanovë, Reshat Ibrahimi e në Tetovë Shaban Sinani, gazetarë të dy...

* * *

Që nga dita që mora lajmin e sëmundjes së mbesës sime, lotët nuk më janë tharë. Ajo po vazhdon të luftoj për jetën, tashmë më e fortë se kurrë, sepse në krah nuk ka vetëm familjen e saj, mua si dajë, vëllezërit Keta, që kalojnë çdo parashikim, apo gjakun dhe miqtë tanë, por ka edhe mijëra njerëz të mirë anembanë vendit dhe në katër anët e klobit.

E kam nisur dhe vazhduar ditën sot me lot, pas mesazheve dhe telefonatave...

Si të mos derdhesh lot, kur më shkruan Suela Veliu nga Gjirokastra dhe më thotë që "kam lënë pas vdekjen e dajës Atdhe Muhos", një njeri brilant që sot kishte të 40-tat, për të menduar të ndihmonte Ambrën... Si të mos qash, kur dëgjon që te koka e Ambrës ndodhet në spital një grua nga Shkupi, Lume Ismaili, bashke me dy vajzat e saj, Albina dhe Altina, të cilat kanë dërguar aty përveç të tjerave edhe tufat me lule. Si të mos derdhësh lot, kur të ndalon në rrugë një ish-punonjëse e TVSh, formuluesja e muzikës Zana Muça, dhe derdh lot bashkë me mua për Ambrën dhe kërkon të japë diçka nga ajo kuletë modeste e një pensionisteje. Si të mos emocionohesh kur në Pogradec, Fier, Peshkopi, Sarandë, Rubik etj. mblidhen ndihma për Ambrën, kur në Dibër të

Me besimin në Zot, dashurinë që njerëzit po na përcjellin cdo ditë dhe nën kujdesin e mjekëve në spitalin "Schawbing" në Mynih që po bëjnë të pamundurën, ne besojmë se Ambra do të shërohet, duke u kthyer në mesin tonë, në mesin e një familje që çdo ditë e më shumë po bëhet gjithnjë e më e madhe, si vetë zemra e saj!

Madhe këngëtari Evzi Kaja bashke me Bajram Kllobçishten, organizojnë një koncert për të ndihmuar këtë vajze, ndërkaq që redaksia e aktualitetit në TVSH bëhen të gjithë bashkë dhe solidarizohen edhe ata me një shumë simbolike... Si të mos derdhësh lot, kur Jona, një vajzë 15-vjeçare, ju thotë prindërve të saj, Moza dhe Erlin, që deri sa të shërohet Ambra s'dua asnjë dhuratë, vetëm jepjani asaj që të shërohet... Si të ndjehesh ndryshe, kur në ditën e humbjes së babait të tij, gazetari dhe miku nga Prishtina Milaim Krasniqi, më shumë se për varrimin e të jatit, interesohet për operacionin dhe vuajtjet e Ambrës. Si të mos ndjehesh i emocionuar dhe të shpërthesh në lot, kur një çift nga Tepelena vjen në shtëpinë e motrës dhe sjellin një shumë, madje duke kërkuar as të përmendeshin me emra, por thonë që "kur të bëhet nuse Ambra, do vijmë të paftuar në dasmën e saj"...

Raste të panumërta si këto kemi çdo ditë, çdo orë. Më shumë se dhimbje pas këtyre mesazheve po shohim shpresë, sepse besimin tek Zoti dhe mjekët na e shtoni Ju, miq të njohur dhe të panjohur, që jeni bërë pjesë e shpirtit tonë.

Mirënjohje të pafund të gjithëve, sepse nëse vazhdoj të përmend emra, gaboj më shumë me ata që skam thënë, të cilët janë të shumtë.

Me besimin në Zot, dashurinë që njerëzit po na përcjellin cdo ditë dhe nën kujdesin e mjekëve në spitalin "Schawbing" në Mynih që po bëjnë të pamundurën, ne besojmë se Ambra do të shërohet, duke u kthyer në mesin tonë, në mesin e një familje që çdo ditë e më shumë po bëhet gjithnjë e më e madhe, si vetë zemra e saj!







"Një këngë për një jetë!"

Koncert Bamirësie në Dibër të Madhe në mbështetje të Ambrës

Ditën e shtunë, ora 19:00, Pallati i Kulturës
Me pjesëmarrjen e artistëve dibranë në ndihmë të Ambrës!

cyan magenta yellow black

Rruga e Arbërit nr. 89

kujtime

Kujtime që m'i trazojnë **Çeliasit**



(Vijon nga numri i kaluar)

NË VEND TË MBYLLJES

Kur i kaluam Çeliasit dhe po po futeshim në Përruan e Kukajve, ju afruam **fshatit Kastriot**. Një emër i vetëm dhe i famshëm në Dibër, **në Shqipëri** dhe ndoshta dhe në botë, pa harruar dhe emrin e komshiut të tij, po aq kuptimplotë e të rëndësishëm, fshatin **Kuke**. Çdo kujt që ka njohuri sadopak, qofshin ato dhe elementare për historinë tonë kombëtare, i bien ndërmend emrat e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut dhe Pal Kukajt... Eh historia, historia..sa e bukur, çplodhëse dhe madhështore është kur shkruhet ashtu siç ka ndodhur, ashtu siç është e vërteta, jo ashtu siç e duan ato që venë e vinë nëpër poste partiake e shtetërore. Pikërisht kur po kalonim këtu, në këtë fshat me emër të ndritur e të veçantë në të gjithë Shqipërinë, më erdhi vetvetiu në mendje një copëz nga artikulli i historianit shkencëtar nga Dangëllia e Frashërllinjëve të mëdhenj të Përmetit me titull: "**Nga ishin Kastriotët, ku lindi Skënderbeu**". E kisha lexuar e rilexuar që në vitin 1974 në Gazetën Mësuesi të asaj kohe në dy numrat e saj vijues. Profesori që e shkruante, i mirënjohuri Kristo Frashëri, është tamam nga dera e atyre Frashërllinjëve që bënë histori, histori që nuk do të vdesë kurrë sa të ketë shqiptarë mbi dhe. Në këtë copëz thuhet: **Skënderbeu ka lindur në Sinë dhe është rritur në Çelias.** Kjo më ka ngelur në mendje. Njerëzit e mëdhenj thonë fjalë të mëdha. Ndaj duhen mbajtur mend, sidomos kur ato lidhen me trojet e të parëve të tu, me rrënjët. Njeriu që nuk njeh **rrënjët**, **nuk kupton dhe nuk e ndjenë as krenarinë**, në jetën e tij të shkurtër në këtë botë.

INTERMEXO ME GËSHTENJA

Po sjellë disa kujtime që më lidhin me të ashtuquajturat **Gështenjat e Kastriotit**, tek ai pyll i vërtet që për fat nuk është më, falë disa rrënjëve tek-tuk sa për të thënë e për tu betuar se këtu dikur ka patur një pyll të tillë. Si disa fosile në shkëmbinj që takojnë gjeologët për të vendosur moshën e tyre. Një pyll shumë shekullor do thoja, ku si unë dhe shokët e mi të fëmijërisë, e kemi patur zili dhe "objekt sulmi" në periudhën e pjekjes së gështenjave. Kishin një prodhim të paparë, jo vetëm për fshatin që e kishte në pronësi, por edhe për fshatrat komshinj dhe kalimtarët. Një cilësi e pashoqe e lidhur kjo dhe me përbërjen kimiko-mineralogjike të formacioneve gjeologjike ku ato marrin ushqimin, kryesisht të përfaqësuara nga formime rreshpore të Silurian-Devonianit që përmenda më sipër. Sot e kësaj dite habitem si nuk u ruajt ai pyll i mrekullueshëm nga vetë banorët e fshatit Kastriot, e këtij fshati me emër të madh. Pylli i gështenjave kishte vlera të pallogaritshme ushqimore, ishte me leverdi të madhe ekonomike jo vetëm për banorët, plus ishte edhe një pastrues i ajrit, hijeshues i natyrës dhe mbrojtës ndaj erozionit. Kush ka kaluar kohët e fundit aty, tek "Gështenjat e Kastriotit", tek "Kodra e Gështenjave", në aksin e rrugës së re të asfaltur Koben-Kastriot-Kala e Dodës, ka vrojtuar me dhimbje rrëshqitjet e tokës, jo një herë por për të disatën herë dhe, nuk dihet fundi i rrëshqitjeve në atë zonë, pasi ndërtimi i rrugës është bërë pa studime gjeologo-inxhinierike. Kjo ndodh në shekullin e XXI, dhe është për të ardhur keq. Thuhet se e ka bërë projektin një firmë angleze, në se është e vërtet kjo, akoma më keq! Personalisht, kurdoherë kur kam kaluar, kam ndaluar dhe jam konsultuar me ndërtuesit, jam mundur të komunikoj me to me fjalë të thjeshta profesionale dhe me orientime konkrete në terren, por ..asgjë..asgjë nuk është zbatuar nga këshillat e mia, edhe pse shteti ka ligjet e rregullat e projektimit. Kësisoj rrëshqitja vazhdon dhe do të vazhdojë deri sa të bëhet ashtu siç thotë shkenca që citova më lartë. Këto gjera më kanë shqetësuar gjatë gjithë jetës time, në shumë vepra që kam parë të ndërtohen edhe pse nuk e kisha për detyrë, por ndjeja dhimbje, aq më shumë kur lidheshin me vendlindjen. Ajo më shqetësuese është se askush nuk jep llogari për shpenzimet e tepërta që bëhen më vonë për riparimin e pasojave të budallallëkut. Lexoni ju lutem shqetësimet njerëzore mbushamendëse të bazuara në shkencë, që përcjellë me urtësi në shkrimin e tij **profesori i nderuar i gjeologjisë, dibrani Bashkim Lleshi** në numrin e kaluar të gazetës Rruga e Arbrit. Argumenton, mbi bazën e studimeve që vetë i ka kryer, realitetin ku ndodhet Rruga e Arbrit duke tërhequr vëmendjen e të gjithëve, vëmendjen e atyre që ju dhimbset sadopak Dibra dhe Shqipëria, për të ndërhyrë secili në mënyrën dhe mundësinë e vet, sa nuk është vonë, për tu bërë ato përmirësime që rekomandon Ai, rekomandime jetike për standardin, që kërkohet për tu realizuar **në rrugën e dytë të Kombit.** Rruga ndërtohet njëherë e mirë kur thonë, ndaj me rrugët nuk duhet lënë që askush të bëjë shaka me to. Profesor Lleshi thotë: Standardi i rrugës së Arbrit është në rrezik. Ky është sinjal alarmi!

INTERMEXO ME QYMYR GURI

Sapo isha kthyer nga një ekip gjeologjik në ambientet e Ekspeditës Gjeologjike Peshkopi dhe isha takuar me normistin Muharrem Sturçe (ndjesë pastë). Pa u pyetur mirë akoma më thotë: Ju ka kërkuar në telefon shoku Bujar Pata. Më shpjegoi ne detaje arsyet e kërkesës duke shtuar se, mirë është ta takoni vetë. Ashtu bëra. Vajta për tu takuar me të në Bulqizë. Aso kohe ai ishte Sekretar i parë i Rajonit, nga të pakët njerëz në Bulqizë për të cilin ruaj një respekt të jashtëzakonshëm. Jo për pamjen, por për sjelljen dhe punën që bënte e zotëronte. Deri sa doli ne pension ai njeri ja kushtoj jetën minierës së Bulqizes me dëshirë e vetëmohim të paparë.

Esenca e takimit: Kishte marrë porosi nga Sekretari i parë në mbledhjen e Byrosë së Partisë të Rrethit, për të parë një shfaqje (dalje) qymyri ne afërsi të Sllovës (Sipas shokut Bujar, sekretari i parë kishte takuar disa plaka në një përroskë në anë të rrugës që të çon në Sllovë, të cilat i kishin thënë atij se e shfrytëzonin atë për ta djegur për nevoja vetiake), ku ai edhe kishte turfulluar në mbledhje duke lënë të nënkuptohej se si ka mundësi që këto gjëra nuk njihen nga gjeologët!? Gjurmuesit popullor në atë kohë vlerësoheshin shumë dhe për këtë nuk jam kundër edhe sot e kësaj dite, kam vlerësuar e vlerësoj ndihmesën që ato japin në çdo kohë e në çdo rrethanë. Vendi nuk mund të mbulohet pëllëmbë për pëllëmbë në kuptimin praktikë të kësaj fjale.

Por le të kthehemi tek biseda jonë. Nuk jam ndonjë specialist qymyresh – iu drejtova shokut Bujar -por nuk besoj të ketë qymyre në atë zonë, do jetë ndonjë keqkuptim. Jo, jo më tha, Ai fliste me siguri e përgjegjësi dhe merre seriozisht këtë punë, verifikoje dhe më dërgo një informacion të detajuar sa më parë të jetë e mundur. Në përfundim të bisedës shoku Bujar mu drejtua duke nënqeshur -të lutem dhe si shok e mik që të kam, vlerësoje se, ti nganjëherë mi ngatërron stacionet. Mirë- mirë i them, mos kij merak. Mund ta takoni vetë -vazhdoj shoku Bujar -pasi ai mu duk sikur nuk orientohej mirë me terrenin. Kësisoj në bisedë me të mund ta saktësosh mirë vend-ndodhjen. Ashtu bëra. Me pak vështirësi por e takova. Nuk ishte e lehtë në atë kohë ta takoje Sekretarin e parë. Pas shumë debatesh e kuptova se nuk bëhej fjalë për Sllovën por për Përruan e Miravecit, ngjitur me fshatin Kastriot. Hajde-hajde thash me vete, paskemi qenë duke lënë nam në ato kodra rrotull Sllovës!!! Ane Sham, ane Bagdat! Ku Sllova e ku Kastrioti. Më vonë do sqaroja se plakat që kishte takuar aty Sekretar i Parë, për ironi të fatit të gjitha ishin nga fshati im, nga Blliçja. Këtë do ta mësoja më vonë. Me disa koleg vajtëm në Kastiot. I ramë kryq e tërthor zonës dhe Përroit. Për fatin tonë, ditën e fundit të punës, plakat kishin ardhur përsëri në Përruan e Kukajve (Miravecit) në vendin ku merrnin një llojë bote (argjile e formuar në zonat tektonike midis rreshpeve të zeza palozoike) siç i thonë ato në gjuhën popullore për të bërë **Çerep**, për ta përdorur për të pjekë bukën. Me që unë i njihja, vajta e i takova një e për një. Për fatin tim njëra nga ato plakat më drejtohet mua: Pse paskeni ardhur këtu edhe Ju, pasi një ditë edhe Sekretari i Parë u ndalua e na pyeti se çfarë po bëni aty. Mos keni ndonjë dyshim për këtë zonë. Menjëherë u çlirova pak por akoma jo plotësisht. Ç'farë Ju tha Sekretari i Parë –iu drejtova unë plakës që po aktivizohej më shumë në bisedë. Përse po i shfrytëzoni ato gurët atje –na u drejtua neve plakave duke kujtuar se ne po nxirrnim gurë e jo botë të zezë për **Çerep**. Për të bërë Çerep, nga pjekja e botës, për ti përdorur pastaj për të pjekur bukën në to –iu përgjigjem ne. Kaq ishte biseda dhe ai hypi në makinë dhe iku. Ah thashë me vete. Tani e kuptoj ku qenka ngarruar filozofi i direktivës së partisë. Ka kujtuar se po merrnin qymyr në një dalje sipërfaqësore duke menduar se e përdorkan fshatarët për ta djeg. Pak gjuha dialektore si e vështirë në të kuptuar, pak distanca nga makina tek Përroi ku nxirrnin botën plakat, pak afërsia e fjalëve të shqipes ku fjala për ta pjek i ka vajtur në veshin e tij për ta djeg, kësisoj bota e zezë e Çerepit u ngatërrua me qymyrin, pasi për fat kishte dhe ngjyrën të përafërt me të. I kishte ngjarë mëzipelës kur thonë fshatarët. Kur ju tregova plakave se ne, për këtë punë kishim ardhur disa ditë këtu pasi, është kuptuar se Ju i keni thënë Sekretarit të Pare se, e merrnit materialin (botën) për ta djeg, ato kanë qeshur me të madhe**. Or bir, or bir mu drejtuan ato, aman mos na ngatërro me ato të partisë**. Kishin të drejtë plakat e shkreta se ishin nga ai fshat ku sigurimi i shtetit e bënte mizën-buall, ku **"sigurimi i shtetit aty i kishte zyrat".**

E takoj shokun Bujar pas disa ditësh dhe, ja them të gjitha! Qeshi me të madhe dhe, si për të më kërkuar ndjesë, pasi pimë një kafe në Kinoklubin e Bulqizës, bëri si bëri më përcolli për në Peshkopi me makinën e tij, duke u justifikuar sikur kishte punë në Komitetin e Partisë së Rrethit. Orari i autobusit kishte kaluar me kohë. Rruga na u duk e shkurtër nga që humbëm në biseda pune nga më të ndryshmet. Bujar Pata është njeri i ditur dhe shumë praktikë, komunikues e i dashur me njerëzit, por mbi të gjitha ai nuk është mendjemadh, gjë që e ka lartësuar tërë jetën, dhe, vazhdon ta lartësoj edhe tani në pension. Kurdoherë kur bie biseda rreth personalitetit te Z. Bujar Pata, mendja më vete tek miniera e Bulqizës, edhe pse ajo kishte marrë një emër tjetër, atë të Todo Manços.

***

Ndërsa makina kineze me ngjyrë jeshile ecte duke na përkundur sa andej këtej në rrugën brenda fshatit Kastriot, unë filozofoja duke biseduar me vete.....**Në Çelias janë rritur të parët tanë, janë rritur të gjithë bashkëfshatarët e mi, është rritur edhe profesori im i klasës së parë,** është rritur edhe Sakipi, është rritur edhe Iliri, jam rritur edhe unë**, është rritur edhe... edhe.... edhe...edhe.....,** por me një ndryshim**. Ne nuk kemi lindur në Sinë si Skënderbeu i Madh,** kemi lindur në **Blliçen e Vogël, por të Madhe** në zemrat tona, në Blliçen që edhe nën diktaturën më të egër të Europës, e tregoi qendrestarinë, për të ngelur për jetë lapidare në **Historinë e Re** të Shqipërisë moderne, në historinë e Shqipërisë demokratike e pluraliste. Kur vazhdoja studimet në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave në vitet **1970-1975 në Tiranë,** kisha mësuar në këtë shkollë**, të vetmen e këtij lloji në vendin tonë** edhe sot e kësaj dite (kur Universitetet po shtohen shumë në raport me popullsinë që kemi dhe cilësinë e kuadrove mësimdhënëse), se gurët më të rëndë në planetin tokë janë disa lloje shkëmbinjësh magmatikë..., disa lloje mineralesh.....apo disa metale të vetëlindur siç thirren në gjuhën e profesionit tim, si Ari etj..etj, por **isha gabuar!**

Ngado që të shkoj njeriu, për të jetuar, për punë të zakonshme, për punë shkencore apo për gjëra e nevoja të tjera nga më të ndryshmet gjatë jetës së tij të shkurtër në këtë botë, gjithmonë do ta ketë të varur në qafë **"gurin më të rëndë të tokës",** gurin më të rëndë të planetit tonë magjik**, mallin për vendlindjen** dhe **për njerëzit e saj**, për truallin ku u rrit e ku mësoi gjuhën e mëmëdheut!

Desha ta mbyll shkrimin me dy fjalë të urta që mendoj se lidhen me shkrimin tim dhe e plotësojnë sadopak atë: **"E djeshmja është kujtesë e të sotmes, dhe e nesërmja është ëndërr e të sotmes - Khalil Gibran. "Njeriu është aty ku ka zemrën, jo ku ka trupin - Mohandas Gandhi**"

Nga **Vesel Hoxha**
Universiteti Politeknik i Tiranës, Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit.

Të rinjtë vizitojnë Francën

Krenare OLLOGU*

Në muajin gusht të këtij viti një grup prej 14 të rinjsh nga Dibra e Madhe nisën udhëtimin e tyre drejt Francës. Ky udhëtim u realizua si pjesë e projekteve që Bashkimi Europian realizon për rininë përmes programit "Të rinjtë në aksion", shkëmbime rinore në mes të rinjve të shteteve te Bashkimit Europian dhe shteteve fqinje. Projekti u zhvillua në partneritet mes shoqatës dibrane "Qendra për zhvillim të qëndrueshëm të komunitetit" (CSCD) dhe komunës së Cean-it nga Normandia, në Francë. Pjesëmarrësit e këtij shkëmbimi i shin 12 të rinj dibranë të moshës nga 17 deri 21 vjet si dhe dy liderët e këtij grupi. Arritja në aeroportin e Parisit, Charles De Gaulle ishte më datën 24 gusht. Prej aty grupi u shoqërua deri në mjediset e kampit ku do zhvillohej projekti, pranë bregdetit të Normandisë, në qytezën Merville.

Për dallim nga shkëmbimi i të rinjve një vit me parë, ku mikpritësit i shin grupi dibran, këtë vit projekti u zhvillua në mes tre shteteve Franca, Maqedonia dhe Bullgaria. Pas akomodimit në kamp, 38 të rinjtë pjesëmarrës patën kohë për t'u njohur dhe për të prezantuar atë çka përfaqësojnë dhe vendin nga vijnë. Përgjatë kohëzgjatjes së projektit u zhvilluan aktivitete nga më të ndryshmet, duke filluar nga aktivitete në lidhje me Europën, çdo të thotë të jesh pjesë e Bashkimit Europian, aktivitete ekologjike e deri tek aktivitetet e ndryshme zbavitëse, gatime e valle tradicionale. Vizitat në vende të bukura nuk munguan aspak. Grupet përgjatë qëndrimit shpesh vizituan edhe qytete të tjera të rajonit, të cilat kishin mjaft histori për të treguar. Shpesh ndodhte që të ndalonin kalimtarët e rastit, të ndalonin e të flisnin me pjesëtar të grupit tonë. Tregonin i interes për atë se nga jemi, pse kemi shkuar në vendin e tyre, a e pëlqejmë vendin dhe çfarë aktivitete do bënim në vazhdim të qëndrimit tonë atje.

Mes tjerash, i interesant ishte fakti që ky projekt i tëri po filmohej, e më pas në bazë të tij do përpunohet një film dokumentar, i cili mendohet të jetë gati në muajin prill të vitit të ardhshëm. Me këtë rast të rinjtë dibranë, si dhe ata të vendeve tjera u intervistuan dhe u filmua puna e tyre përgjatë gjithë qëndrimit në Francë. Në këtë film do të mund të ndiqet një intervistë që dhanë të rinjtë dibranë, përpunimi i disa kartolinave që po bënin me i lustrime për Europën, shkathtësia që tregonin gjatë leksioneve të ndryshme të kampit e të tjera.



Në muajin gusht të këtij viti një grup prej 14 të rinjsh nga Dibra e Madhe nisën udhëtimin e tyre drejt Francës. Ky udhëtim u realizua si pjesë e projekteve që Bashkimi Europian realizon për rininë përmes programit "Të rinjtë në aksion", shkëmbime rinore në mes të rinjve të shteteve te Bashkimit Europian dhe shteteve fqinje.

Një tjetër aktivitet i projektit ishte edhe vizita që u bë në fabrikën e riciklimit dhe selektimit të mbeturinave të qytetit të Caen-it. Këtu i u prezantua të rinjve rrjedha e punës se fabrikës, si bëhet ndarja e mbeturinave, cilat janë makineritë ndihmëse të procesit, çfarë roli kanë qytetarët në atë mes dhe si ndihmojnë, për çka përdoreshin materialet më pas, kush i përdorte dhe gjithçka në lidhje me riciklimin. Interesimi i grupit dibran për këtë çështje u vu më shumë në dukje edhe nga bisedat interaktive dhe pyetjet drejtuar udhërrëfyesit që i shoqëroi grupet. Pjesë e aktivitetit ekologjik ishte edhe pastrimi i plazhit të qytetit të Merville-es, i cili zuri vend edhe në gazetën lokale ditën e ardhshme, i ngjashëm ky me aktivitetin e një viti më parë ku rinia franceze ndihmoi në pastrimin e plazhit të liqenit të Dibrës. Madje në këtë aktivitet, grupet vizitore bashkëpunuan edhe me qytetarë të rastit që i shin mbledhur për të ndihmuar me pastrimin.

Mikpritja e miqve francezë ishte e madhe ndaj rinisë dibrane, mbase edhe për faktin sepse ata tanimë njiheshin me njeri-tjetrin që më herët. Në nder të vizitorëve, Komuna e qytetit të Cean-it organizoi një koktej dhe një mini ekspozitë me fotografi nga projekti që po zhvillohej si dhe dhuratat e shkëmbyera mes dy qyteteve. Po në të njëjtën mbrëmje familjet e të rinjve francezë mikpritës në shtëpitë e tyre te rinjtë dibranë dhe bullgarë për një darkë tradicionale, me ushqime dhe pije vendase. Të gjithë i shin mjaft miqësor dhe treguan qytetari të vërtetë. Grupi dibran mbeti vërtetë i kënaqur nga gjithçka që përjetuan dhe nga mënyra se si u pritën atje.

Ditën e fundit të qëndrimit në Francë, grupi dibran e kaloi në kryeqytetin e vendit, në Paris, kjo si pjesë e aktiviteteve kulturore të projektit. Në qytetin e kulturës, arkitekturës mahnitëse dhe një prej destinacioneve më të dëshiruara turistike, ku me ndihmën e miqve francez, ata vizituan vendet kryesore që janë i kona të këtij qyteti. Kështu Grupi i të rinjve pati fatin të shikojnë vende si kulla Eiffel, sheshi Champs Elysée, portën Triumfale si dhe katedralen Notre Dame të Parisit. Në fakt kjo kishte qenë ëndrra e shumicës së të rinjve, ta vizitojnë ketë vend dhe të ndjehen pjesë e tij qoftë edhe për një kohë të shkurtër. Në mbrëmjen e po të njëjtës ditë ishte edhe fluturimi kthyes për në Maqedoni. Ishte vështirë të largohesh nga një vend që ka të tregojë aq shumë gjëra, mirëpo ishte edhe mirë kur e di se po kthehesh në shtëpi për të treguar një ngjarje aq të bukur, me njerëz aq të aftë, për të treguar edhe për miqësitë e reja dhe kohët e bukura të kaluara bashkë për plot dhjetë ditë.


Gjithçka, sa i përket këtij projekti, ishte e organizuar me përpikmëri dhe aktivitetet e zgjedhura i shin mjaft interesante dhe edukative.

Por ajo çka e bënte edhe më të mirë ketë udhëtim ishte interesimi në nivel të lartë i 12 të rinjve dibranë të cilët përfaqësuan denjësisht vendin e tyre në sy të shteteve europiane dhe bënë me dije se edhe ky grup i të rinjve nga një vend i vogël kanë shumëçka për t'i dhënë Europës.

Shkathtësitë artistike të Fatlindit dhe Krenares me fotografi e ilustrime, zgjuan kërshërinë e pjesëmarrësve për qytetin tonë, kulturën e traditat tona, njohuria për Europën e Artës, Besarit e Meritonit bënë me dije se të rinjtë tanë janë para për shume gjëra në krahasim me moshatarët e tyre europian, njohuria e gjuhëve të jashtme dhe shprehja e Floralbës, Emës e Vlorës, Endriti në anglisht, frengjisht e bullgarisht, njohuria mbi mbrojtjen e mjedisit dhe shkathtësitë sportive të Edonit, Danielit e Dushkos treguan që vlen të dëgjohet edhe zëri i të rinjve të këtij vendi të vogël.

Puna e tyre dhe e liderëve të tyre i çoi ata drejt një eksperience aq me vlerë për ta, e ashtu siç u shprehën, ata shpresojnë që ky udhëtim i tyre të jetë inspirim për të gjithë të rinjtë e tjerë të Dibrës që të punojnë për të fituar përvoja të tilla në jetë, për të ndërtuar vizionin e tyre europian për Dibrën, ndoshta kur pikërisht ata do të udhëheqin këtë qytet edhe Dibra do të jetë pjesë e familjes së madhe Europiane.

** Pjesëmarrëse –Studente e arkitekturës*



Rruga e Arbërit nr. 89

portret

Kontributi i dr. Ali Isa Sulës në zhvillimin e bakteriologjisë është kombëtar dhe më tej, pasi ai ka qenë pararendësi i identifikimit dhe tipizimit të salmonelës “Dibra”.

Dr. Ali Isa Sula, themeluesi i laboratorit bakteriologjik

Nga Prof.dr. **Ahmet KAMBERI**

Doktor Ali Sula nga Zerqani ishte një bakteriolog i talentuar, të cilin koha e vet sa nisi ta zbulonte, kurse koha e sotme ngurron ta kujtojë. Njerëzit e shquar, të çfardo fushe qofshin ata, janë pasuri e popullit ose kombit që i përkasin dhe, kur vlera e tyre i kapërcen kufijtë e vendit të vet, bëhen pasuri e përbotshme. Vendi i tyre krenohet që i ka lindur dhe pasur, njerëzimi frymëzohet dhe krenohet që i kanë dhënë mundësi të ecë përpara ose - kur është fjala për shkrimtarët e artistët - që vazhdon të ndjejë kënaqësi estetike prej punëve të tyre. Një krahinë bën mirë të ndjekë shëmbullin e botës së qytetëruar: t’i fiksojë emrat dhe veprat e njrëzve të vet që mund të ngjallin frymëzim e me të cilët mund të krenohet në çdo kohë. Një vepër e thjeshtë në një kohë që as ta kërkon kush ta mendosh e as ta kërkon kush ta kryesh dhe vetëm nxitja e brendshme për progress të shtyn ta bësh, është po aq e rendësishme sa një vepër madhore e kryer në një kohë pjellorie të bollshme me nxitje të shumanshme. Eshtë, si të thuash, themeli i padukshëm nuk është më pak i rendësishëm se një ngrehinë madhështore që ngrihet mbi të.

Dr. Ali Sula ishte një bakteriolog i shquar dhe njeri nga personalitetet të cilin Dibra ka arsye ta fiksojë në kujtesën e vet dhe të krenohet me të.



Foto e majit 1963 në oborrin e spitalit. Nga e djathta në të majtë: dr. Lahim Puca, dr. Ali Sula, dr. Mark Mirashi, dr. Mehdi Cani dhe dr. Ahmet Kamberi. Përpara, dr Luiza Sula

> Dr. Ali Sula ishte një bakteriolog i shquar dhe njëri nga personalitetet të cilin Dibra ka arsye ta fiksojë në kujtesën e vet dhe të krenohet me të.
> Në laboratorin e dr. Aliut punohej me një rreptësi të admirueshme shkencore.
> Ne ndiheshim të sigurt si kur ai konfirmonte diagnozat tona klinike, ashtu edhe kur ai i përjashtonte ato me anë të analizave bakteriologjike.
> Dr. Aliu i kushtoi 10 vjet të jetës së tij studimit të epidemiologjisë, diagnozës bakteriologjike dhe profilaksisë së tifos abdominale dhe partifos B.

TRUALLI NË TË CILIN E NISI VEPRIMTARINË E TIJ DR. ALI SULA

Peshkopia ka pasur që më 1936-n një spital me 8 deri 12 shtretër i vendosur në disa banesa private deri në vitin 1953 kur u ndërtua një i ri me një korpus qëndror ku gjindeshin reparti i patologjisë, ai i krurgjisë, i pediatrisë dhe administrata. Në 3 godina të veçanta njëkatshe, brenda të njejtit teritor, ishin vendosur Dispanseria antituberkulare, Reparti i sëmundjeve infektive dhe në godinën tjetër ku gjindej farmacia, kuzhina, lavanteria dhe punkti bakteriologjik, sipas renditjes nga lindja në perëndim. Historia e mjekësisë klinike në rrethin e Dibrës fillon me ngritjen e këtij spitali në vitin 1953 me një kapacitet fillestar prej 120 shtrtërish, numëri i të cilëve u rrit çdo 5-vjeçar deri në 174 shtretër në vitin 1968. Në vitin 1973 përfundoi ndërtimi i spitalit të ri. Ndërtimi i këtij të fundit u bë i domosdoshëm nga zhvillimi i vrullshëm i kujdesit shëndetësor parësor në të gjithë rrethin, nga zhvillimi cilësor i kujdesit spitalor, rritja e numrit të specialiteteve dhe nevoja për zgjerimin e mëtejshëm të këtij kujdesi.

Gjatë viteve 1950 Shqipëria, me një popullsi kryesisht fshatare, rropatej për t’u shkëputur nga stili mesjetar i jetesës dhe për të zhvilluar infrastukturën e kujdesit shëndetësor. Rrethi i Dibrës ishte një nga zonat e prapambetura të vendit. Gjendja shëndetësore e popullsisë së Dibrës ndikohej nga përhapja e madhe e tuberkulozit, sëmundjeve diarreike, kequshqyerjes, dermatomykozave, infeksioneve streptokoksike me ndërlikimet e tyre të rënda në zemër e veshka si dhe të sëmundjeve bronkopulmonare. Vdekshmëria e përgjithshme ishte e lartë, vdekshmëria foshnjore dhe ajo nën 5 vjeç ishte shumë e lartë. Përveç spitalit të rrethit në Peshkopi, ishin ndërtuar edhe 2 spitale rurale në Bulqizë e Shupenzë. Më pas spitale të tilla u ngritën edhe në Lurë, Klenjë, Sllovë e Zerqan. Në Peshkopi kishte 4 mjekë, kurse në spitalin e Bulqizës dhe Shupenzës kishte nga një ndihmësmjek.

Që nga ngritja e këtij spitali në 1953 e deri në vitin 1957 në këtë spital punuan mjekë të dëgjuar, si Lluka Dhimitri, Hysni Rusi, Koço Poro dhe si kirurge e gjinekologe - Lona Toptani.

Në vitin 1957 erdhi në Peshkopi i pari mjek dibran i diplomuar në Fakultetin e Mjekësisë, Tiranë, dr. Ahmet Alliu; në vitin 1958 erdhën dr. Mehdi Cani në spitalin e Bulqizës dhe dr Simon Çapeli, kirurg në Peshkopi; më 1960 erdhi dr. Pirro Velo, që zëvendësoi dr. S. Çapelin; më 1960 dr. Fehmi Agolli zëvendësoi dr. M. Canin në spitalin e Bulqizës dhe në vitin 1961 dr. Tonin Franja do të zëvendësonte dr. F. Agollin në Bulqizë, i cili emërohej drejtor i QSE (Qendra Sanitare e Epidemiologjike); dr. Ahmet Kamberi, do të zëvendësonte dr. Ahmet Alliun, i cili do të specializohej në radiologji; dr. Ali Sula do të specializohej në bakteriologji, dr. Luiza Sula do të specializohej në pediatri e do të zëvendësonte në shtator dr. Lame Koçin, i cili ishte transferuar në Tiranë; dr. Lahim Puca do të zëvendësonte dr. Xhavit Konçin, i cili ishte transferuar në Tiranë . Kështu, në fillim të vitit 1962 spitali i Peshkopisë kishte 5 mjekë: Dr. Mehdi Cani, drejtor dhe infeksionist, dr. Pirro Velo, kirurg dhe obstetër-gjinekolog, dr. Lame Koçi, pediatër, dr. Ahmet Kamberi, patolog (internist), dr. Lahim Puca, ftiziatër, përgjegjës i dispanserisë antituberkulare. Të gjithë këta, përfshirë edhe drejtorin e QSE, dr. F. Agolli, kishin mbaruar Fakultetin e Mjekësisë, Tiranë. Përgjegjës i Seksionit të Shëndetësisë në Komitetin Ekzekutiv të KP të rrethit ishte Haxhi Rama, ndihmësmjek.

Dr Ali Sula erdhi në Peshkopi në shtator të vitit 1962 si bakteriolog. Ai kishte realizuar një ëndërr të tij të hershme, qëkur punonte si ndihmësmjek epidemiolog në QSE në Shkodër. Ai pati mbaruar politeknikumin mjekësor, Tiranë, në degën e epidemiologjisë në vitin 1954 dhe kishte punuar në Shkodër deri në shtator 1956, kur filloi studimet në Fakultetin e Mjekësisë.

Në vitet 1960, mënyra primitive e jetesës ende nuk ishte çrrënjosur në Shqipëri e po ashtu edhe në Dibër. Vazhdonte përpjekja për të veçuar kafshët nga banesat, për ndërtimin e banesave me tualet brenda, për ndërtimin e gropave të “zeza” ose “septike”, siç quheshin në atë kohë, pasi edhe kur tualetet gjendeshin brenda në banesë, fekalet derdheshin jashtë, të pambuluara dhe shpeshherë, në anë të rrugëve. Bëheshin, gjithashtu përpjekje për mbrojtjen e puseve dhe burimeve të ujit të pijshëm nga ndotjet, për ngrënien në pjata të veçanta dhe ndryshimin e mënyrave të tjera të stilit primitiv të jetesës. Shëndetësisë i ishte dhënë një rol i veçantë në këtë përpjekje të gjatë e të mundimshme, por kishte dhe mbështetjen e shumë organizatave të masave dhe të atyre të Partisë.

Në këto rrethana, vatrat e tifos abdominale të paratifos dhe dizenterisë ishin ende të pranishme në të gjithë rrethin. Por hera herës kishte edhe shpërthime endemike.

DR. ALI SULA E SHNDËRROI PUNKTIN NË LABORATOR TË MIRËFILLTË BAKTERIOLOGJIK

Dr. Aliu gjeti një punkt të vogël bakteriologjik, ku punonte Sabri Haliti, një laborant bakteriolog, shumë i mirë si specialist dhe si njeri. Ky punkt ishte në një dhomë përdhese, me pajisje minimale dhe, siç mund të kuptohet, kryente një numër fare të kufizuar analizash të thjeshta bakteriologjike. Aliu kishte aty një hapësirë fare të ngushtë veprimi dhe natyrshëm ngriti zërin për shndërrimin e këtij punkti në një laborator të vërtetë bakteriologjik. Kjo nuk u mirëprit nga autoritetet lokale. Ato e morën këtë si një mëtim të pajustifikueshëm dhe nuk e panë me sy të mirë. Mungesës së pajisjeve dhe hapësirës së nevojshme i shtohej edhe energjia elektrike me ndërprerje të shumta. Në atë kohë, Peshkopia përdorte energji nga një stacion elektrik, që punonte me naftë. Kjo nuk furnizohej kurdoherë në rregull.

Megjithatë, dr. Aliu e filloi punën me ndezulli. Shumë probleme ai i zgjidhi vetë me ndihmën e drejtuesve të Laboratorit bakteriologjik të Tiranës dhe të Institutit të Higjienës e të Epidemiologjisë, të cilët e kishin vlerësuar atë gjatë kohës së specializimit dhe më pas. Aliu bashkonte në veten e tij vetëdijen e lartë profesionale, disiplinën e rreptë shkencore dhe pasionin e studiuesit. Ai vendosi rregulla e një disiplinë të rreptë profesionale e shkencore. Punoi shumë me personelin e laboratorit, me qëllim ngritjen e tyre profesionale, pa të cilin ai nuk mund të realizonte zgjerimin e gamës së analizave bakteriologjike që synonte. Ai mbante regjistra të përpiktë, ku shënonte çdo hollësi të rastit që analizonte. Mbante dhe fletore vetjake ku shënonte dhe klasifikonte çdo vrojtim që i dukej me interes për ndjekje të mëtejshme. Regjistra do të kishin qenë shumë të çmuar për dokumentimin e punës së tij, por mjerisht, më kanë thenë se janë zhdukur. Ashtu siç ishte i rregullt, i disiplinuar e i përpiktë në punë, ashtu ai ishte edhe në paraqitje, në veshje, në sjellje e në marrëdhënie me kolegët dhe eprorët e tij. Kjo e bënte të dukej pak i ngrysur, i vetëpërmbajtur dhe krenar e megjithatë, shumë i afërt e i butë me bashkëpunëtorët e vartësit e tij dhe njëherësh shumë bujar.

Në marrëdhënie me eprorët e tij dhe me autoritetet lokale ishte disi i rezervuar dhe nuk pëlqehej. Kjo, së bashku me faktin se puna e tij ishte e mbyllur në laborator, jasht kontaktit të gjerë, që ne të tjerëve na e mundësonte puna drejtpërdrejt me njerëzit, si edhe mosnjohja siç duhej e rolit të laboratorit bakteriologjik, mund të kenë qenë faktorët kryesorë që puna e tij të mos vlerësohej. Pavarësisht nga kjo, ai bënte përpara me këmbëngulje, me ngritjen e vazhdueshme të cilësisë së punës së laboratorit të tij dhe me kërkimin shkencor.


Në gjysmën e dytë të viteve 1960 dr. Aliu e kishte transformuar, tashmë punktin në laborator të mirëfilltë bakteriologjik dhe e kishte zgjeruar shumë gamën e analizave. Ai nuk merrej më vetëm me shigellat e salmonelat, por edhe me tuberkulozin, kokët (stafilokok, streptokok, pneumokok e meningokok), myket e funget, difterinë dhe sidomos, me zbulimin e portatorëve (bartësve të shëndoshë të mikrobeve), si edhe me vlerësimin e gjendjes së imunitetit në popullsinë e vaksinuar. Ai kishte botuar disa artikuj në revistat mjekësore të kohës, me të cilët ishte bërë i njohur. Por punimi i tij mbi zbulimin e portatorëve, në një simpozium të Institutit të Higjienës dhe i Epidemiologjisë (IHE), qe vlerësuar në mënyrë të veçantë.


Duke e çmuar lart për personalitetin e tij shkencor, të krijuar nga ai vetë, pa ndihmën dhe mbikëqyrjen e kurrkuj, si IHE, ashtu dhe Fakulteti i Mjekësisë e kishin kërkuar zyrtarisht atë për ta përfshirë në stafin e vet; por kjo nuk u realizua kurrë, pasi autoritetet lokale, do ta refuzonin me arsyetimin se nuk kishin me kë ta zëvendësonin.

Në laboratorin e dr. Aliut punohej me një rreptësi të admirueshme shkencore. Ne ndiheshim të sigurt si kur ai konfirmonte diagnozat tona klinike, ashtu edhe kur ai i përjashtonte ato me anë të analizave bakteriologjike. Në pranverën e vitit 1970 do të vinte pandemia e madhe e gripit A.


→

Historia e lavdishme e spitalit të Peshkopisë dhe e një periudhe të veçantë të luftës me tifon dhe sëmundjet diareike, difterinë, infeksionet streptokoksike e stafilokoksike, tuberkulozin dhe dermatomykozat, në rrethin e Dibrës do të ishte me të vërtetë e gjymtuar pa figurën e dr. Ali Sulës.









Ne ishim të mirinformuar nga literatura mjekësore perëndimore e kohës se epidemitë e këtij gripi shoqëroheshin me rritjen e shpeshtisë së infeksioneve mushkërore stafilokoksike. Prandaj, sapo u duk që gripi po hynte në Shqipëri, ne tërhoqëm me lehtësi nga depoja e barnave në Tiranë një sasi të mire oksacilline dhe meticilline (barna shumë të fryttshme kundër infeksioneve stafilokoksike). Dr.Aliu e kishte vënë, gjithashtu laboratorin në gatishmëri. Ajo që ndodhi, është e paharrueshme. Epidemia preku më shumë se gjysmën e popullsisë së rrethit. Ndërlikimet e gripit qenë aq të shumta, sa reparti i patologjisë me 60 shtretër, që unë drejtoja, nuk kishte kapacitet t'i përballonte. Kështu që na u vu në dispozicion edhe gjysma e shtretërve të kirurgjisë dhe e atyre të stacionit termal të Peshkopisë. E kishim organizuar punën në mënyrë të tillë që të sëmurët më të lehtë t'i shtronim në kirurgji dh ata në përmirësim e sipër t'i çonim në stacionin termal derisa të vinin në gjendje për të dalë nga spitali. Patëm 35 të sëmurë të ndërlikuar me pneumoni stafiloksike, të diagnozuar klinikisht dhe radiologjikisht, 27 prej të cilëve u konfirmuan edhe bakteriologjikisht.

Një numër fëmijësh të ndërlikuar me pneumoni stafilokoksike, nuk e di se sa, pati edhe në repartin e pediatrisë, që drejtohej nga dr. Luiza Sula. Ne i kishim të gjitha mjekimet e duhura dhe mrekullisht, nuk humbëm asnjë nga ata të sëmurë. Kontributi i laboratorit bakteriologjik qe me të vërtetë i shkëlqyer.

Ishte koha kur në Shqipëri dhe në rrethin e Dibrës rastet sporadike, por edhe endemitë e tifos së zorrëve dhe të paratifove shpërthenin herë pas here, nga zona në zonë. Kishte dhe vatra ku ato përsëriteshin më shpesh. Ky ishte një problem për shëndetësinë e Dibrës, por ishte edhe një preokupacion serioz për dr. Ali Sulën. Ndërgjegjja profesionale dhe prej kërkuesi shkencor e kishin shtyrë atë të merrej seriozisht me shkaqet epidemiologjike të këtij problemi.

MONOGRAFIA "EPIDEMIOLOGJIA, DIAGNOZA LABORATORIKE DHE PROFILAKSIA E TIFOS ABDOMINAL E PARATIFOS B"

Dr. Aliu i kushtoi 10 vjet të jetës së tij studimit të epidemiologjisë, diagnozës bakteriologjike dhe profilaksisë së tifos abdominale dhe partifos B. Kjo punë u pasqyrua në monografinë e tij "Epidemiologjia, diagnoza laboratorike dhe profilaksia e tifos abdominal dhe paratifos B", të përfunduar aty nga mesi i viteve 1970. Monografia ishte një pasqyrim unik i gjendjes epidemiologjike të infeksioneve tifoike në rrethin e Dibrës në vitet 1961-1973. Mjerisht, ai nuk e pa të botuar monografinë e tij të cunguar, pasi ajo e pa dritën e botimit në vitin 1978, dy vjet pasi ai ishte ndarë nga të tijtë, pa mbushur ende 40 vjeç, në lule të moshës dhe të prodhimtarisë, pikërisht atëherë, kur ai, me punën e tij këmbëngulëse kishte krijuar kushtet e nevojshme për treguar se çfarë ishte i zoti të bënte. Kjo monografi doli me titullin "Diagnoza laboratorike dhe profilaksia e tifos abdominal dhe paratifos B". Për arsye të pakuptueshme, atëherë edhe sot, Drejtoria e arsimit shëndetësor, i hoqi monografisë së tij pjesën e ***epidemiologjisë***, e cila paraqiste shumë qartë burimet dhe rrugët e përhapjes së tifos abdominale e të paratifos B në rrethin e Dibrës. Ky cungim i monografisë nga drejtuesit burokratë të Drejtorisë së arsimit shëndetësor ka mundësi të jetë bërë nga që ata mund të jenë trembur prej paraqitjes reale të gjendjes epidemiologjike, nga dyshimi se ajo mund të kishte domethënie politike negative. Por kjo duket krejt e pajustifikueshme pasi, qeveria e asaj kohe e vlerësonte argumentimin shkencor si mjet kryesor për planifikimin e veprimeve të nevojshme për zgjidhjen e problemeve të caktuara.

Megjithatë, monografia me 65 faqe, me shkronja të imëta e të ngjeshura (2100 shenja për faqe), që me formatin e librave të sotëm mund të kishte rreth 120 faqe, është një pasqyrim i qartë i personalitetit të autorit si një shkencëtar i vërtetë. Kjo monografi e cunguar është mëgjithatë një referencë autoritare, jo vetëm për studimet në fushën e shëndetit publik për rrethin e Dibrës, por dhe për çdo studim të kësaj natyre në Shqipëri. Po të mos mungonin grafikët dhe tabelat që kanë humbur në Drejtorinë e arsimit shëndetësor, ajo do të mund të botohej e plotë, jo thjesht për të nderuar autorin, por për të pasur një referencë të dorës së parë edhe për gjendjen epidemiologjike të Dibrës për periudhën 1961-1973.

DR. ALI SULA ËSHTË IDEATORI I NGRITJES DHE JETËSUESI I LABORATORIT BAKTERIOLOGJIK MODERN EKZISTUES NË PESHKOPI

Sado që në fund të viteve 1960 dhe në fillim të viteve 1970 ai kishte arritur ta zgjeronte shumë veprimtarinë e laboratorit bakteriologjik dhe të rriste numrin e laborantëve, dr. Aliu ishte shumë i pakënaqur sepse mjedisi i laboratorit e kufizonte shumë. Me një mijë mundime arriti të merrte miratimin për ngritjen e një laboratori të ri modern bakteriologjik, të ideuar prej tij ku kishte projktuar edhe një sektor të tuberkulozit e të virologjisë. Me një mijë e një mundime të tjera mundi ta ngrinte e ta pajiste këtë laborator, por pa sektorin e tuberkulozit e të virologjisë. Këto dy sektorë nuk ia lejuan ngaqë i quajtën të tepërt dhe ia morën për një tjetër përdorim: për zyra e për klinikë dentare. Laboratori i ri filloi të funksiononte në vitin 1974. Mjerisht, ai nuk do ta gëzonte atë sepse në shtator të vitit 1976, kanceri i mëlçisë ia mbylli sytë dhe e heshti përgjithmonë mendjen e tij kërkuese e krijuese, por ai u la pasardhësve një trashëgim të shkëlqyer dhe lehtësitë për t'i çuar punët më përpara

DR. ALI SULA ËSHTË ZBULUESI I SALMONELËS "DIBRA DHE" DHE PARARENDËS I IDENTIFIKIMIT E I TIPIZIMIT TË SAJ

Në vitin 1972, në bashkëpunim me të shoqen, dr. Luia Sula, që ishte përgjegjëse e repartit të pediatrisë, ai nisi një studim për shkaktarët e diareve te fëmijët. Në studim ishin përfshirë jo vetëm fëmijët që shtroheshin në pediatri, por edhe të gjithë fëmijët me diare që vizitoheshin në poliklinikë. Të gjithëve u merrej materiali nga vetë dr. Luiza dhe dërgohej menjëherë në laborator. Gjatë studimit, dr. Aliu ai u gjet para një dukurie të papritur. Kishte ndeshur një salmonelë që nuk e klasifikonte dot në asnjë nga tipet e njohura të salmonelave, ngaqë ajo nuk zotëronte të gjitha vetitë fermentuese të salmonelve të tjera. Me mundësitë që ai kishte në laboratorin e Peshkopisë, nuk ishte në gjendje ta tipizonte atë. Iu drejtua për konsultim shokut të tij të klasës në politeknikumin mjekësor, që tashmë drejtonte sektorin e salmonelozave në IHE, dr. Azmi Dibrës. Ata punuan së bashku derisa dr.Aliu qe gjallë, por problemi mbeti i pazgjidhur. Azmiut iu deshën edhe 10-12 vjet punë derisa mundi ta ***identifikonte*** dhe ta ***tipizonte*** këtë salmonelë. Ai mundi ta izolonte atë në disa breshka të mbledhura, jo më kot, në zonën e Dibrës - breshkat njihen si bartëse të salmonelave - dhe arriti ta tipizonte atë. Sot ajo njihet ndërkombëtarisht si salmonela "Dibra". E ka përmendur, apo jo këtë fakt Azmiu në shkrimet e tij, nuk e di. Por unë e mësova këtë nga dr. Luiza, ndërkohë që po përgatitesha për këtë shkrim. Aliu ka pasur shënime të përpikëta, por për fat të keq, ato nuk janë më, ashtu si dhe sende të tjera të tij, së bashku me bibliotekën personale. Pavarësisht nga kjo, ai është pararendësi i identifikimit dhe i tipizimit të salmonelës "Dibra" Kjo meritë i duhet njohur atij, pasi ai ishte i pari që e ndeshi këtë salmonelë dhe i pari që nisi kërkimin për identifikimin e saj.

Kur u pranua ndërkombëtarisht ***tipizimi*** i salmonelës "Dibra", unë isha minister i Shëndetësisë dhe pata kënaqësinë të miratoja propozimin për dekorimin e Azmiut me dekoratën "Punonjës i shquar i shkencës dhe i teknikës", njëkohësisht me disa personalitet tjera të shquara të shëndetësisë shqiptare, midis të cilëve edhe të klinicistit infeksionist të shkëlqyer dibran, dr. Mehdi Canit, që në atë kohë ishte drejtor i spitalit klinik Nr. 4 (spitali infektiv) në Tiranë dhe pedagog në Fakultetin e Mjekësisë.

NË PËRMBYLLJE

Emri i dr. Ali Sulës nuk mund të mbetet i mbuluar nga dheu i zi i varrit, me trup e me vepër. As nuk mund të përmendet shkarazi me një gjysmë rreshti në një libër historie të mjekësisë së Dibrës *(*F. Daci, *Historia e mjekësisë dibrane.)*. Laboratori bakteriologjik modern që ai ngriti dhe e jetësoi është aty i gjallë, funksional. Artikujt e tij shkencorë mund të gjenden në revistat mjekësore të kohës, monografia e tij e rëndësishme, gjithashtu mund të gjindet. Historia e lavdishme e spitalit të Peshkopisë dhe e një periudhe të veçantë të luftës me tifon dhe sëmundjet diareike, difterinë, infeksionet streptokoksike e stafilokoksike, tuberkulozin dhe dermatomykozat, në rrethin e Dibrës do të ishte me të vërtetë e gjymtuar pa figurën e dr. Ali Sulës. Kontributi i tij në zhvillimin e bakteriologjisë është kombëtar dhe më tej, pasi ai ka qenë **pararendësi** i ***identifikimit dhe tipizimit*** të salmonelës "Dibra".

Unë ndihem i nderuar të kem bashkëpunuar me dr. Ali Sulën, shokun tim e kolegun me personalitet shkencor, të cilit u përpoqa t'i lehtësoj peshën e dheut që e mbulon dhe t'i heq me këto pak rreshta të shkruar për të, mbulesën e harresës së dëmshme. Ndoshta, dikush do të duhej ta kuptonte rëndësinë e gëdhenjes së emrit të tij në laboratorin bakteriologjik të Peshkopisë që ai ideoi dhe e jetësoi. Një emër që ngrihet mbi kala rëre mbetet që mbetet anonim, por një emër që lidhet me një veprimtari të shënuar del patjetër në dritë, sepse është veprimtaria që i jep jetë emrit dhe jo emri veprimtarisë. Historia e zhvillimit nuk fillon në pikën e vijimësisë së kohës ku dikush çel sytë për herë të parë dhe as nuk mbaron me atë, por mosshikimi dhe mosvlerësimi i ecurisë së zhvillimit deri në atë pikë i bëhet gur i rëndë i lidhur në këmbë zhvillimit e përparimit të mëtejshëm.

Rruga e Arbërit nr. 89

Francezja Evelin Noyges në mesin
e dibranëve të Dibrës së Madhe.

studim

Jashar Erebara, publicist dhe patriot mbarëshqiptar



Evelin Noyges: Ndjehem tepër e kënaqur që jam në Dibër dhe në mesin e dibranëve, sepse dibranët fillova t'i njoh më mirë që kur merem me studimin për Jashar Erebarën, dhe ja që erdha në Dibër për të parë vendlindjen e tij dhe familjen e tij.

Dr. Shefqet Zekolli: Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë që sot para jush të prezantoj një zonjë të veçantë, një mikeshë të shqiptarëve dhe mbi të gjitha një studiuese, Evelin Noyges. Zonja Evelin Noyges, dashurinë dhe interesimin e saj për shqptarët e ka shprehur shumë herët, aty nga fundi i viteve 80-ta, atëherë kur sistemi monist në Shqipëri ishte akoma në fuqi, ndërsa të gjithë ata të cilët vinin nga jashtë dhe tregonin interesim për Shqipërinë dhe shqiptarët shikoheshin me dyshim.

Në organizim të komunës së Dibrës së Madhe, me mbështetje të Institutit të trashigimisë shpirtërore e kulturore të shqiptarëve në Shkup dhe të Shoqatës "Votra Dibrane" e shqiptarëve që jetojnë në Shkup, të mërkurën pasdite më 18 shtator, zonja Evelin Noyges studiuese në Qendrën për studime Evropiane në Institutin e Orientalistikës në Paris para dashamirëve të kulturës shqiptare paraqiti temën për jetën dhe veprimtarinë e patriotit, publicistit dhe gazetarit të shquar dibran Jashar Erebara.

Mr.Ruzhdi Lata, kryetar i komunës së Dibrës, theksoi se "Ky është takim i veçantë se kemi të bëjmë me një angazhim e veprim shkencor të një studiuese nga Franca për Jashar Erebarën të lindur në Dibër i lindur në vitin 1873. Për mua është kënaqësi kur na njohin të tjerët, kur perëndimi vë në pah vlerat punën dhe përkushtimin tonë 100 vjeçar për ardhmërinë e shqiptarëve në Evropë. Qytetet ku ka vepruar Jashar Erebara janë Dibra, Shkupi,Kumanova,Vjena,Tirana,Bukureshtin etj. Na sinjalizon se kemi të bëjmë me njeriun i cili lëvisi nëpër tërë Evropën për një të ardhme më të mirë të të gjithë neve. Prezentoi vlerat të shqiptarëve iniciativat dhe qëllimet që kanë shqiptarët Jashari u lind në ato vite të vrullit më të madh të vëllezërve Frashër në Stamboll. Në ato vite Samiu dhe Naimi bënë botimin e veprave më të mëdha. Rinia e Jashar Erebarës përkon me aktivitetet e vëllezërve Frashëri. Shumë heret Jashar Erebara në Shkup themelon e boton gazetën "Albania" dhe gazetën "Shkupi", me çka përmes shtypit dëshiron ti informojë të tjerët. Jashar Erebarën e gjejmë në aktvitetet më të mëdha të kombit. Ai u interesua edhe për Kumanovën ku depërtoi abetarja e gjuhës shqipe. Jasharin e gjejmë në Kongresin e Manastirit, me shpalljen e pavarësisë në Vlorë, në çdo vend ku është të prezentohet çështja shqiptare. Të flasish për patriotizmin dibran njërin grup të patriotëve që janë të pushkës, të armëve dhe të luftës,të guximit, të trimërisë, të përballjes me cilin do. Është edhe një grup tjetër që jenë marë edhe me shkrime si Jashar Erebara, Ismail Strazimiri etj, që Dibrën e bëjnë të jetë bastion i interesit të kombit. Edhe ky aktivitet i sotëm bëhet për interes të kombit, ku prezentohet ku prezentohet personaliteti i Jashar Erebarës nga një studiuese nga Franca. Angazhimi i saj na bind për vlerat e Jasharit", tha Mr.Ruzhdi Lata.

Dr. Shefqet Zekolli, drejtor i Institutit të trashigimisë shpirtërore e kulturore të shqiptarëve në Shkup shtoi se, "Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë që sot para jush të prezantoj një zonjë të veçantë, një mikesh të shqiptarëve dhe mbi të gjitha një studiuese, e cila me studimet e saj ka bërë emër dhe është dëshmuar me përkushtimin e saj për zbardhjen dhe afirmimin e njërit prej publicistëve, politikanëve dhe patriot të shquar shqiptar të shekullit të kaluar. Është kjo zonja Evelin Noyges, studiuese në qendrën për studime evropiane në Institutin e Orientalistikës në Paris.

Zonja Evelin Noyges, dashurinë dhe interesimin e saj për shqptarët e ka shprehur shumë herët, aty nga fundi i viteve 80-ta, atëherë kur sistemi monist në Shqipëri ishte akoma në fuqi, ndërsa të gjithë ata të cilët vinin nga jashtë dhe tregonin interesim për Shqipërinë dhe shqiptarët shikoheshin me dyshim. Megjithatë, në vazhdim e sipër, kjo zonjë arriti gjatë tri viteve të që qëndrojë në Tiranë me shërbim dhe ta përmrësojë gjuhën shqipe në nivel profesional. Më vonë ajo do të mer pjesë nëpër kurse e seminare të ndryshme të albanologëve të organizuara në Paris, Tiranë, Prishtinë e gjetiu. Duke qenë në koherencë të vazhdueshme me zhvillime kulturore dhe politike të shqiptarëve nga vitet e fundit të shekullit të kaluar, zonja Evelin nuk u kënaq vetëm me mësimn e gjuhës shqipe dhe shijimin e kënaqësive,që e pasuron nëpërmjet veprave artistike por fllio të tregojë nteresim edhe për figura të shquara të kombt shqiptar. Kësisoj ajo fillimisht u impresionua prej veprmtarisë publicistike e patriotike të Jashar Sadik Erebarës, prandaj filloi të tregojë interesim të veçantë për të, duke hulumtuar dhe publikuar të dhëna nga jeta dhe veprimtaria e tij të cilat deri atëherë ishin pak të njohura për opinioni më të gjërë.

Gjatë vitit 2006 zonja Evelin, në revistën shkencore "Ylli i Dritës" që del në Shkodër boton studimin e parë për Jashar Erebarën me titul " Një jetë e kushtuar për zgjimin e ndërgjegjes kombëtare shqiptare". Në vitin 2007 poashtu në të njejtën revistë do të botojë studimin me titull " Etude de la revue Albania. Shkipnija e Shqiptarëvet (L'Albanie aux Albanias):1902-1906". Më 2009, në buletinin shkencor të Universitetit "Aleksandër Xhuvani" të Elbasanit, boton artkullin tjetër kushtuar Jashar Erebarës me titull "Të dhëna për gazetën " Albania". Shkipnija e Shqiptarëvet" 1902-1906".

Interesimi i zonjës Evelin për krijimtarinë publicistike dhe veprimtarinë patriotike të Jashar Erebarës vazhdon në forma të ndryshme, kryesisht nëpërmjet publikimit të të dhënave të ndryshme për veprimtarinë e tij, si dhe me studimin e veprës së njërit prej personalteteve të këtyre anëve në gjysmën e parë të shekullit të kaluar.

Publikimet e zonjës Evelin janë të shumta jo vetëm për Jashar Erebarën të cilat vazhdojnë edhe më tutje, por edhe për çështje tjera me interes për shqiptarët. Gjatë punës së saj ajo ka përkthyer një numër të madh të publikimeve nga gjuha shqipe në atë frenge dhe nga ajo frenge në gjuhën shqipe. Këto punime në vazhdimësi janë publikuar në revista të ndryshme shkencore.

Duke çmuar lartë punën e profesoreshës Evelin, uroj që prej kësaj studiuese të vyer të marim edhe më shumë kontribute tjera, ndërsa bashëpunimin mes USHT-së dhe Institutit tonë ta avansojë edhe më tutje".

Evelin Noyges, studiuese nga Franca, para të pranishmëve tha se, "Ndjehem tepër e kënaqur që jam në Dibër dhe në mesin e dibranëve, sepse dibranët fillova t'i njoh më mirë që kur merem me studimin për Jashar Erebarën, dhe ja që erdha në Dibër për të parë vendlindjen e tij dhe familjen e tij. Unë do të prezantoj disa të dhëna që i kam gjetur në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë dhe në Arkivin e Shtetit Shqiptar. Viti 1912 është viti i aspiratave për themelimin e shtetit Shqiptar dhe për emamcipimin e tërë shqiptarëve, viti kur shpërthejnë luftërat ballkanike nën nxitjen e nacionalistëve të popujve fqinj në Ballkan. Krijimi i shtetit shqiptar është i lidhur ngushtë me antagonizmat e fuqive të mëdha me Perandorinë Osmane. Lëvizja kombëtare shqiptare shoqërohet me Perandorinë Osmane në vitet e fundit të shekullit 19-të. Në fillim intelektualët shqiptarë kërkojnë më shumë autonomi dhe vetëvendosje në gjirin e Perandorisë Osmane. Në fund shekullit të 19-të shqiptarët nuk dëshirojnë të konsiderohen as si Turq, as si Sllavë, as si Grekë dhe AustroHungarezë. Viti 1912 është i lidhur me një ngjarje të madhe për popullin shqiptar, i cili do të bëhet pjesë e faktorit ndërkombëtar edhe pse u kundërshtua nga fqinjët dhe fuqitë e mëdha. Pavarësia e Shqipërisë pas shumë diskutimesh u njoh në nivel ndërkombëtar në konferencën e Ambasadorëve në Londër nga dhjetori 1912 deri në korrik të vitit 1913.

Viti 1912 i vuri fundin luftërave shekullore që populli shqiptar i bëri për të ruajtur integritetin territorial nga të huaj kjo shënoi një etapë të re për shtetin shqiptar. Komunteti shqiptar në shtetet e huaja luajti një rol cilësor në mbështetje e lëvizjes kombëtare. Intelektualët të shpërndarë në shtetet e tjera jashtë Perandorisë Osmane do ti përqendrojnë forcat në ndërtimin e indetitetit kombëtar. Zhvillimi i instituconeve dhe mësimi i gjuhës amtare do të nxisin krijimin e gazetarisë dhe të revistave të cilat mbështesin zgjimin e shtresave popullore aktiviteti i patriotit Jashar Faik Erebarës do të bëhet në një pjesë të jetës së tij në diasporë, që do të thotë jashtë trojeve shqiptare që ishin në Perandorinë Osmane. Zgjimi i vetëdijes kombëtare te intelektualët shqiptarë do të zhvillohet gjatë krijmit të shtetit shqiptar në një situatë të pa favorshme në Ballkan. Kohëve të fundit janë publikuar shumë pak të dhëna historike për Jashar Erebarën. Jashar Erebara lufton për një legjitimitet të ri popullor që i jep jetë procesit të indetitetit shqiptar. Familja e Jashar Erebarës u largua nga lufta turke-ruse në vitin 1878 larohen nga Mostari dhe vinë në Dibër të Madhe ku vendosen në xhaminë Bajram Begu e mandej në familjen Erebara. Fuat Ali Erebara, nipi i Jasharit që jeton në Tiranë. Thuhet se Jashar Erebara ka lindur në vitin 1873 ose 1875 si është regjistruar në Komunë. Në Tiranë ka jetuar që nga viti 1911 deri në vitin 1953. Më vonë kaloi në Beograd ku drejtoi revistën "Albania" dhe pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë punoi në administratën e kryeqytetit. Nga viti 1924-1939 ishte deputet i Rethit të Dibrës në Shqipëri. Shkollën fillore e kreu në Dibër, ndërsa ciklin e lartë e kreu në Manastir. Pas kësaj filloi të punojë si gazetar dhe publicist duke u dhënë në shërbim të Shtetit Shqiptar. Jashari fliste gjuhën shqipe,serbe dhe turke që e kishte mësuar në shtëpi dhe nga patrioti Said Najdeni nëpërmjet librave shkollor në gjuhën shqipe të botuara në Bukuresht ai u familiarizua me idetë e lëvizjes kombëtare. Kërkesa kryesore e asaj kohe ishte që në shkolla shtetërore të mësohet gjuha shqipe. Në Manastir Jashar Erebara takohet me motrat Qiriazi, ndërsa në Stamboll takohet me Sami Frashëri. Në Dibër takon patriotin Dervish Hima i cili zgjon edhe më shumë ndjenjën patriotike të Jasharit. Më tej Jashari njoftohet me shumë patriotë të tjerë shqiptarë dhe mer pjesë në studimet në institutin e Bukureshtit. Jashar Erebara më vonë kthehet në Shkup dhe në Dibër ku bashkëpunon me Josif Bageri, Dervish Himën, Said Najdeni etj", tha në fund Evelin Noyges.

Rexhep Torte

Një botim me vlera të veçanta i Xhelal Ndreut

"S'ka qetësi në Lisivalle"



Libri "S'ka qetësi në Lisivalle" mund t'i shërbejë fare mirë çdo etnografi e folkloristi për të njohur veshjen e burrave dhe të grave të asaj treve, fjalët e urta, këngët e vajet, siç është karakteristike vaji i Qamiles.
Por në radhë të parë libri ka vlera të veçanta letrare. Ajo është një prozë poetike, megjithë karakterin tregimtar që ka...

Libri "S'ka qetësi në Lisivalle" mund t'i shërbejë fare mirë çdo etnografi e folkloristi për të njohur veshjen e burrave dhe të grave të asaj treve, fjalët e urta, këngët e vajet, siç është karakteristike vaji i Qamiles. Por në radhë të parë libri ka vlera të veçanta letrare. Ajo është një prozë poetike, megjithë karakterin tregimtar që ka. Përshkrimet zënë një vend të veçantë. Aty-këtu shkrimtari shpërthen për të pasqyruar dashurinë që ndjen për çdo gjë që është dibrane, siç është rasti kur jepet bukuria fizike dhe morale e vajzës luriane.

Me mjeshtëri janë përdorë kontrastet, pasazhet, simbolet, i ronia dhe sarkazma dibrane në gojën e personazheve, metaforat e pasura dhe krahasimet e këndshme, si dhe mjaft figura të tjera letrare që e bëjnë librin tërheqës nga faqja në faqe. Të gjitha këto janë merita të autorit, por mendoj se do të kishte vend për një redaktim më profesional që mund të bëhet në një ribotim në të ardhmen dhe në një paraqitje më të mirë grafike. Këto janë përgjithësisht disa vlerësime tonat, por vlerësimin më të mirë i a ka dhënë vetë lexuesi ku e kërkon me këmbëngulje në të gjitha librarit e vendit tonë librin "S'ka qetësi në Lisivalle" të autorit Xhelal Ndreu.


Nga **Naim PLAKU**

Ndoshta sot nuk do të kishim marrë mundimin t'i shkruanim këto radhë por shkak janë bërë kërkesat e shumta të lexuesve të ndryshëm që kanë për librin "S'ka qetësi në Lisivalle" me autor Xhelal Ndreun. Kohë më parë, me kontributin e familjes së tij u bë i mundur botimi i një pjese të vogël nga krijimtaria e madhe e poetit, shkrimtarit dhe përkthyesit të talentuar Xhelal Ndreu. Them një pjesë e vogël, sepse shumë prej shkrimeve të tij, romane, poezi, skica, monografi e përmbledhje të folklorit dibran si dhe përkthime mjaft dinjitoze nga letërsia botërore u zhdukën ose u asgjësuan qëllimisht nga regjimi komunist. Pjesën më të madhe të jetës e kaloi në burgjet e skëterrës ose i persekutuar nëpër kampet e përqendrimit, gjithmonë i përndjekur, sepse i përkiste trungut të familjes së patriotit Elez Isufi dhe ishte djali i nacionalistit Cen Elezi. Krijimtaria e tij ishte po aq tragjike sa dhe vetë jeta e tij. Duke qenë erudit i përmasave të mëdha dhe poliglot(njohës i tetë gjuhëve të huaja) krijimtaria e tij e mirëfilltë qëndron në nivelet e personaliteteve nga më të shquarat të letrave shqipe. Por për fat të keq ajo nuk u njoh fare. E vetmja njohje për lexuesin shqiptar është libri "S'ka qetësi në Lisivalle", që me shumë mundim e sakrifica këto materiale të përmbledhura arritën t'i ruajnë, t'i mbrojnë e së fundi t'i botojnë djemtë e tij e nipërit. Xhelal Ndreu i shte një shkrimtar tipik dibran. Po thuaj tërë tematika e veprave të tij është nga historia dhe jeta e Dibrës. Gjuha, zakonet, traditat dhe karakteret dibrane. Këtë mund ta shohim edhe në këtë pjesë të vogël të kësaj krijimtarie të mbetur. Libri përmban 17 poezi origjinale, disa përkthime nga poetët më të mëdhenj botëror, shënime historike për Dibrën, prozën "S'ka qetësi në Lisivalle" si dhe 118 fjalë të urta. Të gjitha poezitë mendoj se kanë karakter tepër origjinal, sikur janë frymëzuar e shkruar aty ku zë fill historia, mes bëmave e ngjarjeve historike, mes asaj natyre aq të bukur e të ashpër ku kaloi fëmijërinë poeti. Mjaftojmë të kujtojmë poezinë "Dibra" ku përmes një toponimie aq të pasur njihemi dhe me veçantitë e secilës krahinë. Autori mbetet gjithnjë bir e mik i Dibrës. Aty mes maleve të saj,aty ku gurgullojnë ujëvarat, aty ku çelin lulet e bjeshkëve të Dibrës,aty; aty rreh zemra e tij, i cili është dhe një mesazh për brezat që do të vijnë: "Pena i me nuk do të qëndisje rruaza e ojna, as bejte, por kujtime e ndodhi origjinale, pa shpresën e muzave e pa fantazina, do t'I rendit pa leqe nëpër përgjelin e gjurmëve, ku ta çojnë mendimet dhe përgjërohem: për ujnat e ftohtë të bjeshkëve, për ernat e ftohta të përhodës së Korabit, për valët e turbullta të Drinit, për ujin e kulluar të Setës, për liqejtë e kristaltë të Lurës, për aromën e luleshtrydheve të Moravës e granabutit, për lupardhat që ndezin fëmijët natën e Shëngjergjit" Dhe ky motiv mendoj se i qëndron vepra e Xhelal Ndreut. Në këtë paraqitje të thjeshtë për lexuesin shqiptar nuk do të bëjmë një analizë por mendoj të jap disa mendime për veçoritë dhe disa karakteristika themelore.

Në kapitullin e parë, që i kushtohet historisë më të mirëfilltë e më të njohur të Dibrës, mendoj se na jepen gjëra origjinale, heronj të njohur e të veçantë, ngjarje që kanë emër, por janë bërë pak të njohura për brezin tonë. Përshkrimet për Nëntë Malet e Dibrës,Katër Oxhaqet, Shtatë Teqet, për krahinën e Çidhnës dhe ngjarje të tjera me rëndësi historike, janë përshkruar me aq vërtetësi, sa duhen pasur në konsideratë nga historianë të mirëfilltë. Autori me qëllim nuk ka vënë data as burime bibliografike, sepse burimi më i mirë është njohja origjinale e fakteve dhe ngjarjeve historike. Autori duke qenë një njohës e tepër kërkues i historisë së Dibrës, jep të dhëna me shumë vlerë, veç historisë edhe për etnografinë, toponiminë dhe veçanërisht në përshkrimin e zakoneve dibrane që sot, në përgjithësi janë harruar. Të bën përshtypje një gjë:Kur jepet jeta dhe karakteret e figurave më të shquara të Dibrës duket sikur fytyra e tyre zbehet në disa rrethana zakonore, por dalëngadalë ajo vjen duke u rritur deri në madhështi e duke mbetur simbol i burrërisë e trimërisë dibrane. Le të kujtojmë këtu Llan Kaloshin, Sal Demirin, Demir Lushën, Hoxhollët, Karasanët e gjer tek Bar Skura, Doda, Troci, Xhika, Marku, Koltraka, Bitri, Gjoni, Çerja, etj, etj.

Autori ka qenë një njohës i shkëlqyer i zakoneve të Dibrës. Këtë e vëmë re në çdo faqe të librit të tij. Padyshim pjesa themelore e këtij botimi është proza "S'ka qetësi në Lisivalle". Këtu na jepet jeta tipike e një familje patriarkale, jeta e një kulle ku lindi, u rrit dhe u burrërua Elez i sufi. Një kullë e veçuar mbi një kodër veshur me dushkajë. Aty vlonte një jetë me gëzimet dhe hidhërimet e saj, ajo priste e përcillte miq të nderuar, aty këndoheshin këngë trimërie, bëheshin kuvende e lidhej besë malesh, aty bëheshin dasma e hidheshin valle, por edhe morta me lot e vaje.Duke na paraqitur jetën e kësaj kulle autori na ka dhënë me mjeshtëri jo vetëm ngjarjet për luftërat që u bënë nën udhëheqjen e Elez Isufit kundra shovinistëve serbë në ato vite, por edhe portretet e luftëtarëve të shquar.Le të kujtojmë këtu luftën e Kaushit dhe portretin e Sait Prishtinës. Një vend të rëndësishëm dhe me vlera të veçanta zënë përshkrimet e zakoneve të malësorëve duke na krijuar vizione të qarta për gjithçka ndodhte në atë familje, për dasmat që bëheshin siç jepet për shembull dasma e Mersimit, apo mortave kur vriteshin djem e burra për shkaqe hasmërie. Libri është shkruar me një gjuhë të pasur. Duke përdorë dialektin dibran autori ka patur mundësi të na japë bukur alegorinë e odës së Dibrës, frazeologjinë e pasur, një leksik karakteristik që mund t'iu shërbejë mjaft mirë gjuhëtarëve për ta njohur atë që t'i shërbejë pasurimit të gjuhës shqipe me fjalë të burimit autokton. Të sjellim këtu vetëm disa prej tyre që mund të hasen në dy-tre faqe: palare, lupardhe, fang, kohr, mrul, perhoda, paflloj, rraplloj etj.

Tre poetë dibranë në "Arti i fjalës shkodrane"



Botimi i antologjisë poetike "Arti i fjalës shkodrane" shkruar në gegërisht, vëllimi i dytë, 2013, përgatitur nga Vasil Marku është një risi në botimet letrare.

Krahas emrave të njohur të poezisë shqipe si Primo Shllaku, Mujo Buçpapaj, Gjok Beci, Vasil Tabaku, Ledia Dushi, Avni Mulaj, Lindita Prenga, Gjek Marinaj, Merita Berisha e të tjerë. Në këtë antologji poetike janë përfshirë dhe tre poetë dibranë si Agron Tufa, Ramiz Gjini dhe Ilmi Dervishi.

Rruga e Arbërit nr. 89

botime

"Për mësuesen" pasqyron thjeshtë e bukur një larmi temash, ku na jep mesazhe jete dukuri konkrete të kohës së demokracisë si dhe tradita të shquara dibrane e kombëtare.

"Për mësuesen", një libër plot dritë nga errësira

Nga **Mevlud BUCI**

Kur rilexova librin poetik "Për mësuesen" të mësuesit, të poetit dibran, Hysniu Shaban Bushi të Kishavecit të Dibrës mu kujtua prometeu i lidhur.

Vërtet jeta e njeriut është sa e bukur aq edhe e vështirë, sa e ndritshme edhe e errësuar, sa e lirë aq edhe e prangosur.

Ky libër i shkruar në qeli nga një mësues, mund të quhet pa mëdyshje testament dashurie, testament i dhimbjes e i krenarisë për mësuesen, vendlindjen, figurat e shquara, njerëzit edhe gjithë kombin, nënën, të dashurën, bukuritë e natyrës familjen. Autori gëdhend me dufin e çiltërsitë shpirtërore, urrejtjen kundër divorcit.

Mësuesi Hysni Bushi ka shkruar me vërtetësi e realizëm, ka pasqyruar dukuritë e epokës edhe të shoqërisë, ka përdorur me mprehtësi gjuhën, filozofike të Dibrës, ka mbajtur, si i thonë metrin, gërshërët, kandarin dhe pasqyrën.

Poeti Hysni Bushi në vargjet e thjeshta e herë-herë prozaike ka lartësuar mësuesen, vendin e tij, ka përshkruar poetikisht e realisht librin, këngën e qyqes, fëmijët, jetimin, jetën, demokracinë, Dibrën, Shqipërinë mburoje të Europës, Kishavecin, kujtimet e nënës, poezinë rininë, shëndetin interesin, fjalët, bukurinë frikën, totalitarin Durrësin, lojën, kohën, dashurinë për jetën.

Dy vëllezërit, këngët, motrën, faljen rrezet e dritës, amanetin, nënë Trezën, llampën, mësuesen, botën, fukaranë heroin e gjallë (Hasan Kutën), shkruan për Gani Tuçepin (Koçi), Heroin e ujërave Beqir Kalinë, ortekun, dashurinë dhe kohën, fustanin, bjeshkën, se si flasin malet, mos harroni nënën e babanë, qëndresën fatin mësuesin hero.

Avzi Nela, punën, gënjeshtrën, lulen, guximin, një puthje, gjyshja, mbrëmja e fundit, prindërit, koha e mirë, gjuhën, fantazinë tezen, kandilin, heroi nga Dardha, Xhelal Hysa, nënave, Sheh Ismailit, Burgun, Skënderbeun. Në Krujë, lufta në Koplik, ç'është koha, hekurat, heroina, lotët, aktorët, fjalën sheqer, syzezën, barazi, ardhmëria, rininë, shpresën e durimin, dhe mësuesin e popullit (Selim Aliu,) që mbyll librin poetik prej 172 faqesh.

Një dëshmi e shport-atdhetisë, një zë kushtrimash, një zemër e frymëzuar dhe e lënduar një mësues i përkushtimit arsimor edhe poetik, një rrezatim i mirësisë njerzore. Kur ma dhuroi librin miku im Zabit Cuku nga Rrajca e valleve dhe e kulturës së përbashkët Dibrane, e lexova, e rilexova dhe u ndjeva sikur jam përpara prometeut të lidhur.

Mësuesi dhe poeti Hysni Shaban Bushi shkruante nga qelitë e Vaqarrit: "Jeta nuk është fushë më lule, nuk ka vetëm ëmbëlsirë, por edhe kripë".

Hysni Bushi është vërtet një shpirt i prangosur, një promete i kohës re, por nga jeta, vuajtjet e tij nga shpirti e krijimtaria e tij duhet të mësojnë brezat. Vargjet e thjeshta e plot frymëzim, vargjet që do luajnë nga një shpirt në qeli një shpirt që deshi, mbijetoi e luftoi për demokracinë e vërtetë dergjet në pranga. Pra koha dhe vuajtjet e mira dhe të këqija, mirësia, dhe plagët lumturia, dhe dhimbja, parajsa apo ferri janë për njeriun, ndaj duhet durim, ta pranosh ashtu si kur të të vijë. Janë testament jete, testament për breznitë ajo që ka shkruar poeti Hysni Bushi.

Njeriu i mire, e i vërtetë nuk kërkon, as s'bën ngatërresë, pa shkak të tjerët si fajëson, as të marrë hak s'i kërkon.

Vargjet e poetit e mësuesit Hysni Bushi



Ky libër i shkruar në qeli nga Hysni Bushi, një mësues, mund të quhet pa mëdyshje testament dashurie, testament i dhimbjes e i krenarisë për mësuesen, vendlindjen, figurat e shquara, njerëzit edhe gjithë kombin, nënën, të dashurën, bukuritë e natyrës familjen. Nëpërmjet librit poetik "Për mësuesen" pasqyron thjesht e bukur një larmi temash, ku na jep mesazhe jete dukuri konkrete të kohës së demokracisë si dhe tradita të shquara dibrane e kombëtare.

sikur mbjellin pranverë, drejtësi, durim falje, mërziti.

Një filozof i lashtë thotë: Zoti dhe prindërit të zbresin nga qielli, në tokë, kurse mësuesi apo mësuesja ti ngrejë nga toka në qiell.

Poeti Bushi shkruan, me zemër e frymëzim për mësuesen e mësuesit.

… Ty mësuese të dua shumë
Për ty të gjithë kanë respekt
Diturinë si gjënë më shtrenjtë
Ti mësuese, me urtësi ta jep…(faqe 3)

Hysni Bushi krenohet me vendin me traditat, me historinë ndaj tek poezia, "Vendi im" shkruan:

…Një kështjellë e fortë,
Një vend plot lule
Qëndron i pa mposhtur
Kurre s'u përkule…(faqe 5)

Poeti ka koncepte të qarta për lirinë në demokraci, sidoqoftë që duhet të kuptojë filozofinë se dje ishim në monizëm e në diktaturë por nuk folëm, sot në demokraci ka liri pa fre e katrakurë.

Poeti Bushi mallkon zborin, aksionet ku me të drejtë ishin bërë gangrenë e brezit të ri, gangrenë e lirisë dhe shkruan:

…Spiun e as servile,
Askush s'mund të thotë,
Shkruaj i lirë
I lirë je sot…
Brezat që vijnë
Për të kaluarën, s'ja dijnë,
Të lirë shkruajn
Gëzuar lirinë !

Sigurisht që vargjet e poetit Bushi ngjajnë si himn, por ama duhet të pranojmë që shtetarët, politikanët, deputetët, të votëbesuar ta njohin e vlerësojnë lirinë, fjalën, vlerat njerëzore e mbi të gjitha korrektësinë e drejtësinë ligjore sepse për ndryshe gjithçka përfundon në hiç.

Poeti Bushi këndon a loton për vetminë, ku nëpërmjet simbolit të qyqes u thotë, emigrantëve kthehuni në vendin tuaj, por të mos harrojmë se ne që jemi këtu (partitë shtet) janë kundërshtarët e lirisë kundërshtarë të vlerave e të kryevlerave të cilat janë në emigrim. Ku këtu u mungon drejtësia vlerësimi, punësimi, legalizimi, nderimi sipas meritës e drejtësisë që u përket.

Poeti Bushi shkruan.

…Po jetojmë me shpresë
Qeveria të bëjë kthesë
Të ktheht këtu të banojë
Qyqja më të mos këndojë…

Në vargjet mjeshtërore të poetit krahas vargjeve për fëmijët, jetimët, jetën, demokracinë, nënën, mësuesen gjen edhe vargje për dijetarin, pra dijenia mos vdesë ajo ndriçon njerëzinë kohërat, brezat:

… Dietari kurrë nuk vdes
Portretziu është në shkrim
I pa harruar di të mbes
Në t'ëmblën kujtim…(faqe 9)

Poezia e Hysni Bushit paraqet kohën, demokracinë, ëndrrat për dashurinë që vërtetë lartëson edhe godet, pasqyron e vlerëson, por edhe bën sitën e duhur për mangësitë e kohës se kaluar dhe kësaj që po kalojmë.

Shpirti demokratik e atdhetar, shpirti lirik dhe realist kumbëzin në vargjet e çdo poezie.

…Të ndanë më dysh Dibër
Të nënvlerësuan me përçmim
Një ditë do bashkohesh
Drita e kombit tim. (faqe 13)

Poezitë përcjellin plot mesazhe dashurinë, nacionalizmi i fisnikërisë, mall për vendlindjen, mesazhe për demokracinë e vërtetë, luftën ndaj gënjeshtrës e veseve të shoqërisë. Autori krenohet me filozofët popullorë të vendlindjes së tij, Kishavecit të cilët janë jo vetëm dritë e Kishavecit por edhe e Dibrës dhe e kombit, dritë e breznive.

…Kishavec-vend-dritë. Dietarë t'i ke rritë Haxhi Kaca, Sadik Bushi, Dine Pira, Sulë Çiku e Iljaz Zira…(faqe 17)

Poeti Hysni Bushi shpreh në vargje edhe gëzim popullor e shpirt lirinë për demokracinë, por edhe revoltën ndaj formalistëve, të veshur me qyrk demokrati.

…Luftën e klasave
Bashkë me ca të tjera.
I flakën në rrugë
I mori era…
Menduam se fituam
Por s'ishte e vërtetë
Spiunë e shpifsa
Po na e nxijnë këtë jetë…(faqe12)

Në librin me poezi Hysniu paqyron tema me vlera, aktuale si edukimi, thjeshtësia, krenaria legjitime, dashuria e sinqertë njerëzore.

…Kur të bëhesh prind
Athere do e besosh
Sa të do prindi sot
Ti do e kuptosh… (faqe 108)

Pra autori jeton me problemet sociale të shoqërisë tonë demokratike, pasqyron artistikisht ato ç'ka përshkojnë vërtet shqetësime për shoqërinë, për të ecur përpara. Vargje që pasqyrojnë jetën, dashurinë, fantazinë, ndjenjat.

Ky mësues poet shkruan për heroin Xhelal Hysa, poeteshën Rajmonda Moisiu, Sheh Ismajlin, e shenjtëruar, të Limjanit, për vuajtjet në burg, për dhimbjet e shpirtit të prangosur.

Është kuptimplotë, e dhimbshme dhe tepër njerëzore mini poema "Burgu". Aty shpërfaqët njeriu, drama jetësore, poeti mediton, realisht si dhe sikur u bën thirrje të tjerëve, veçanërisht rinisë që si çdo kush t'i shmanget burgut:

…Burgu të mundon
Mërzitesh shumë
Kush s'të kupton
Natën je pa gjumë…(faqe 118-121)

Poeti Bushi shkruan me krenari legjitime për Skënderbeun, për përkrenaren për Krujën, për kombin tjetër, për Dibrën, për trimin legjendar të Kodërshkekës, prijësin popullor Osman Paci që u martirizua në mejdan të trimërisë. Thjesht dhe bukur, poeti bën paralelizmin historik dhe jep mesazhet që kurrë të mos i harrojmë heronjtë tanë traditat tona kombëtare:

…Osman Paci në Fushë-Alie
N'at ditë të luftës rëndë
Nuk u frik topit as mitrolozit
Po u nis për istikam…

Heronj si Osmani, Çerçizi e Selami, si Shota, Azemi e Ademi, Jo të mos i harroni!...

Autori përshkruan me plot ndjenja krenarie luftën e Koplikut (Ata janë lavdi),

Ç'është koha "Hekurat" tek poezia Hekurat shprehen mesazhe urtësie, dhimbje, fisnikërie, durimi dhe shpirt lirie e mbi të gjitha durimi i padrejtësive, durimi i vuajtjeve që i bien njeriut në jetë:

…Mes juve linda
Me ju jam rrit
Ashtu si ju vuajta
Gjithnjë të bëjmë dritë…(faqe 142,143,145)

Libri mbyllet me poezitë "Shpresë durimi" dhe Mësuesi i Popullit" kushtuar korifeut të pedagogjisë, të paharruarit Selim Alliu (Mësues i Popullit" Në të 172 faqet e këtij libri, pasqyrohen dukuri jetësore, tradita, dhimbje njerëzore, krenaria legjitime, dashuria përmallimi, fisnikëria, durimi, qëndresa, përballë dallgëve të jetës. Është pa mëdyshje një libër i pasqyrimit të dashurisë dhe vuajtjeve njerëzore, një testament për lirinë e demokracinë e vërtetë. Poeti dhe mësuesi Hysni Bushi është vërtet legjenda e penës që rrezaton nga qelitë, shpirti i mallit dhe i dashurisë njerëzore, mendja e urtësisë dibrane njeriu i dhimbjes, vuajtjeve dhe i qëndresës ku nëpërmjet librit poetik "Për mësuesen" pasqyron thjeshtë e bukur një larmi temash, ku na jep mesazhe jete dukuri konkrete të kohës së demokracisë si dhe tradita të shquara dibrane e kombëtare. Pra është një libër modest, i shkruar me dritën e shpirtit libër që rrezaton madhështinë e jetës vuajtjet kronikën e vërtetë të prometeut të lidhur.

Urime dhe penda dritë Hysni Shaban Bushi i Kishavecit të ***Dibrës martire…!***

libra

Prezantohen 4 libra të rinj
të shkrimtarit Naim Berisha

Botime të reja të shkrimtarit Naim Berisha

Shkrimtari Naim Berisha prezantoi më 16 shtator në sallën e Akademisë së Shkencave në Tiranë, katë botimet e tij të reja: "Haiku - Gjindja kishte ngërë egjër", "Lulecelur në degë të mollës - Muhurri dhe Shqipëria në 100 këngët e mia", "Vdekja e Deles" - tregime dhe "Shpirti i heshur" - poezi lirike.

Në një ceremoni të thjeshtë dhe mbreslënëse, mes krijuesve më të njohur dibranë ndodheshin dhe poeti i shquar Xhevahir Spahiu si dhe Prof. Bardhyl Xhama, njëherësh edhe redaktor i librave të tij.

Krijimtaria dinjitoze e Naim Berishës në poezi e fabula, por dhe libri me tregime të shkurtra, si dhe përmbledhja e tij me këngë të orkestruara nga vetë ai, u vlerësuan maksimalisht nga referuesit Bardhyl Xhama, Halil Rama, Qazim Shehu, Sakip Cami, Jaho Margjeka, Xhelal Luca etj.


Ky promovim si dhe botimi me mjaft cilësi i këtyre librave janë, pikësëpari meritë e shtëpisë botuese M&B, me një kontribut të vyer në fushën e botimeve dhe sidomos për mbështetjen që iu kanë dhënë dhe ju japin krijuesve dibranë.

Në librin me haike " Gjindja kishte ngërë egjër" shpaloset profili poetik i një krijuesi me një ndjeshmëri të lartë, me teknika vjershërimi mes tradicionales, modernes e postmodernes, me një pasuri të begatë mjetesh dhe teknikash poetike, me









struktura vargjesh e strofash të zhdërvjellëta, që e kthejnë formën në një procedim të mesazhit poetik.

Ndërsa në vëllimin poetik "Shpirti i heshtur" ai sjell poezia lirike, të cilat janë në karakterin e autorit, plot befasi dhe shkruar bukur. Poezia e Berishës është e thjeshtë dhe e kuptueshme me plot muzikalitet. Katër ciklet e vëllimit: "Zëri i kripur i një vrage loti", "Aromë nënë", "Puthja" dhe "Drerët e dashurisë" i bashkojnë mesazhet e ngrohta të dashurisë.

Ndërsa në vëllimin me tregime "Vdekja e deles", dallohet mjeshtëria e të shkruarit si një vëzhgues i hollë, me zbërthimin e detajeve të jetës së përditshme nëpërmjet prozës poetike. Tregimet e tij janë të shkurtra, që të ngacmojnë dhe mbeten në kujtesë me fabulën e shkruar mjeshtërisht.

Ajo që u prit me shumë interes ishte edhe vëllimi "Luleçelur në degë të mollës - Muhurri dhe Shqipëria në njëqind këngët e mia". Ky është një libër me një vështrim të gjerë panoramik mbi vendlindjen e autorit, Muhurrin dhe gjithë atdheun e tij të dashur, Shqipërinë, përmes këngëve epiko-lirike, që i bëjnë jehonë historisë dhe të sotmes së tij. Njëqind këngë, të zgjedhura nga tre qind të tilla, të cilat i ka krijuar kohë pas kohe, përgjatë gjithë krijimtarisë së derisotme. Një pasuri për kompozitoret për këngë të reja.

Prezantimi i librave ishte një manifestim i shkëlqyer letrar, ku u evidentua sërish një zë i spikatur i letrave tona shqipe, Naim Berisha, që në 20 vite me më shumë se 20 libra të botuar (romane, poezi e tregime), ka hyrë me dinjitet në historinë e letërsisë shqipe. Një zë që premton shumë edhe në të ardhmen.


Shumë miq dhe dashamirës të autorit, të cilët nuk patën mundësi të merrnin pjesë në këtë prezantim, do ta kenë kënaqësinë të takohen dhe të shkëmbejnë me autorin vlerësimet e tyre mbi poezinë, fabulën dhe letërsinë në përgjithësi, gjatë ditëve të panairit të librit në Tiranë, që mbahet më 13-17 nëntor, pranë stenës së botimeve "M&B". Naim Berisha do udhëtojë posaçërisht për këtë panair, duke qenë më shumë se kurrë afër lexuesve dhe miqve të tij.

Korresp. "Rr.A"

Ajnshtajni i përcëlluem – jo alegori

Nga **Fejzulla GJABRI**

Titulli i tregimeve, skicave, reportazheve e meditimeve të Dr.Selman Mëziut, nuk ka të bëjë më teorinë e famshme të Relativitetit, por më thjeshtë, me realen. Me atë që ndodh përditë, me të zakonshmen, me të dëshiruarën e të padëshiruarën, me të pavetëdishmen dhe të vetëdishmen, me pëlqimin dhe mospëlqimin. Disa janë shkrime të thjeshta me problem të mëdha. Ndoshta ngjajnë me disa skica migjeniane, të sjella në kohët tona, shumica me panoramën e trishtimit. Në fakt, kjo nuk është ndonjë meritë e autorit, por e jona, e shqiptarëve në përgjithësi, që vazhdojnë të notojnë në të njëjtin llum e ndyrësi, të cilën e përshkruante dikur Migjeni. Pra, autori sheh e shkruan ato që janë para syve tanë. Nga ana tjetër, pse nuk është meritë, kjo nuk do të thotë se mungon vlera e autorit, pasi të shkruash atë që sheh, nuk është e lehtë. Kjo se, së pari duhet ta ndjesh që ta përjetosh dhe së dyti, të dish të përzgjedhësh në morinë e atyre që të kap syri. Selman Mëziu duket se ndjen dhe di të përzgjedh.



PËRCËLLIMI

Nuk është vetëm titulli që flet për përcëllimin. Padrejtësitë, punët shkeleshko e të lëna përgjysmë, mashtimi etj, plagë të shoqërisë në tranzicion, duket se 'e përcëllojnë' edhe vetë autorin. Po sigurisht që kryesorja është kryeskica "Ajnshtajni i përcëlluem", me të cilën pagëzohet vëllimi. Këtu përdoret vepra në vend të emrit të Ajnshtajnit, që studiuesit e teorisë së letërsisë e quajnë sinekdokë. Pra një sinekdokë e padëshirueme, që dikush i djeg librat e dikush përcëllon dorët për të shpëtuar " … një libër jetëshkrimor … (Ajnshtajnin), që flokët i ishin përcëlluar bashkë me cepin e djathtë të librit …". Vëzhguesi, në këtë rast shkruesi i kësaj skice, bën një pyetje dhe jep një përgjigje po me pyetje": "Pse duhet të ndodhë kështu? Dhe e quan djegien e librave 'Hallakatje e njerëzisë', pasi dikush që pa libra duke u djegur "… iu afrua zjarrit, filloi të qajë si fëmija, ndërkohë nxirrte librat nga gjuhët e flakëve..".

Lënda e parë e skicave, reportazheve dhe tregimeve janë njerëzit e thjeshtë, panorama pezmatie, e kaluara – me aktualitetin shpesh në antitezë, njerëzit e ditur me injorantët, por që di të bëjë dallimin mes të pakultivuarës që jeta dhe hallet nuk u ofruan luksin e diturisë, me 'elitën' që u shkollua e u përkëdhel nga fati, por që mbeti po aq injorante dhe e pazonja të lartohet moralisht. Duke 'gjykuar'autorin, përgjithësisht ia ka dalë të rreshtohet në anën e të dobëtëve, duke iu rikthyer vokacionit të kohëve të mëparshëmparshme. Por jo vëtëm. Socialen e sheh në çdo kënd, saqë një grup tregimesh i ka titulluar " Shikimi i hallakatur". Aty është 'Kulla e kuqe', në 'Natyrën e qëndisur'; 'Peizazhe historie' në 'Fshatra të fjetur'; 'Shtegtarë' me 'xixëllonja', ku ironia largohet për t'i lënë vend të drejtpërdrejtës, shkrimit shkoqur..

REALJA

Gjithçka në vëllim shikohet përmes syve të një vëzhguesi të hollë. Mjafton të 'shetisim' nëpër shkrimet e vëllimit "Ajnshtajni i përcëlluem" dhe galeria e personazheve është me emër e mbiemër të vërtetë. Aty janë shokët e miq të autorit, të njohur e të panjohur, që kërkoi e ua mësoi emrat, emra historikë e njerëz të thjeshtë, artistë e shkencëtarë, të ditur e injorantë, njerëz që përpiqen të bëjnë diçka ndryshe e dembelë, njerëz të drejtë e mashtrues etj. Në një reportazh ngre shqetësimin e pyjeve. Gëzohet kur sheh kope delesh, por pëzmatohet kur sheh cungje drunjsh të freskët të prerë dhe mungesë uji, kur ujë ka me bollëk jo shumë larg. Dhe jep një projekt për ndryshueshmërinë ekologjike, për vende turistike etj. Shpresë e dyshime në shumë skica, reportazhe e tregime.

TOPONIME MIKROTOPONIME

"Përballë e buzë përroit të Kastriotit ndodhet Bregu i Mullirit … më thotë shtatëdhjetëvjeçari Selman Lleshi se thirret Zabeli i Toçit, tokë me pulla dheu të kuqe … më tej Lugu i Gështenjave, Kodra e Gështenjave …Përroi i Dhelpnës, Rreskat e Kasmit arat e …" e tjera toponime e mikrotoponime që flasin vetëm shqip.

Të gjitha si këto e me dhjetra të tjera, i shënon në një reportazh të emërtuar "Të gjallët grishin gërmadhat". Ciceronët janë njerëz të atyre vendeve, shpjegojnë edhe ndonje toponim që ka ngelë për ngjarje historike, siç është Guri i Luftës apo Gryka e njohur në histori "Gryka e Radikës".

Në disa tregime e reportazhe autori ngul këmbë në toponimet historike, veçanërisht në ato që kanë të bëjnë me kohën e Skënderbeut. "Eh, i dashur lexues, këtu jemi në Kopështin e Gjonit e afër tij është Pusi i Gjonit, Kulla e Gjonit, … Mazreka e Epërme, trojet e Kuke, trojet e Kastriotëve …" e të tilla toponime me teh historik. i përmend këto vise e diku i vjen keq që janë shpërdoruar nga koha. Bile diku shënon 'sqarimin': … në vitin 1980 i futa plugun dhe mbulova e përmbysa gjithçka. E ai (trguesi i këtij veprimi) uli kokën e dy pika lot i rrodhën nga sytë e rrëshqitën faqeve të rreshkura …".

PLAGËT

"Ra një murtajë që Nana e quante kurbet. Është e tillë, thoshte ajo, që as të vdes e as të mban gjallë". Ky përkufizim jepet ne tregimin "Djali i dy nënave". Pas një subjekti me lodhje e mundime, Nana thyhet. Fundin e jetës së saj autori e jep mjeshtërisht të dhimbshëm. Asaj i mungonin fëmijët nga kurbeti. "Ajo filloi të tretet fizikisht, … edhe nga malli që e digjte për fëmijët. E, një natë ajo e zgjoi vajzën që i rrinte te koka, ndërkohë hodhi sytë përreth, sikur diçka kishte humbur. …Oda iu duk e ftohtë, e trishtuar, e pa shpirt, e hidhur. Rrotulloi dy-tri herë sytë, shfryu lehtë, ishin prurjet e fundit të ajrit… zemra nuk i hapi e mbylli dhomëzat për të ruajtur pemën e jetës". Me ketë temë janë disa trgime, pasi vetë autori e ka provuar, megjithëse në biseda e takime nuk e thotë. Më së shumti jeton në Itali, por duket se nuk është i qetë, pavarësisht se goja nuk ia thotë.

Përfundimisht, autori pyetjes së sinqertë të personazhit kryesor, vetes së tij, arrin ta sigurojë se e ardhmja do të jetë shumë e mirë. Mjafton dëshira dhe puna. Duke kritikuar, ai jep këto mesazhe shpresëdhënëse. E mban shpresa tek e kundërta e atyre që i sheh syri. Autori është i gjezdisur. Ai ka soditur së pari vendlindjen, me të mirat që i dha Zoti, por që nuk po di t'I administrojë. Ka soditur e vëzhguar qytete e kryeqytetin e vet, ka pa fqinjët tanë e së fundi ka vëzhguar edhe Italinë, me trashëgiminë e saj kulturore. E mban shpresa në ndryshimin e gjendjes, në mbrujtjen e mjedisit, në rininë që sheh në botë, në …

Përgjithësisht nga ky vëllim marrim atë që duhet e jo atë që shohim zakonisht. Marrim këshilla si: Mëso të heqësh dorë nga e liga, nga e keqja, bëje punën pa ulëritur (ndoshta për drejtuesit politikanë), në qetësinë tënde, pa e marrë vesh njeri, pa u rënë daulleve. Mësojmë edhe se: Hiq dorë nga te gjitha ato që të tjerët nuk do që të t'i bëjnë ty! Por edhe: Hiq dorë nga ata që të premtuan qiellin e të falën vec breshër! Hiq dorë nga çdokush që tu betua se do ishte gjithnjë me ty, shiko rreth vetes! Sigurisht kjo e fundit është tamam për politikanët tanë gënjeshtarë…

portret

Fol një fjalë, o Sheh Dalia!

Nga **Namik SELMANI**

Në atë qëmtim të shkronjave me aromë historie për Çamërinë përherë më kanë befasuar klerikët e saj. Më ka befasuar ai shqiptarizëm që ka qenë pjesa më qënësore e karakterit dhe më e bukura e jetës së tyre. E ditëve të tyre . E sakrificave të tyre deri në madhështi, deri në të atë persekutim që i ka ndjekur shumë më tepër se njerëzit e thjeshtë të kësaj zone.

Ashtu, të urtë deri në madhështi, ata kishin kryer disa misione atdhetare në jetën e tyre. Përballë tyre kujtesa popullore bënte me bujari enciklopedinë e saj herë me shkronja të mermerta e herë me magji tingujsh. Objektet e kultit ktheheshin në shkolla ku bashkë me besimin merrej edhe dashuria për tokën e të parëve. Më kanë befasuar këngët që ngrinin këngëtarët për ta. Kurora të ndritshme tingujsh, ngjyrash të shpirtërave njerëzorë bënin detyrën e gdhendies së portreteve të tilla që pak nga pak po bëheshin modele shqiptarizmni.

Edhe kur nisa të qëmtoj pak nga pak historinë, këngën e letërsinë e një krahine ku mbretërit e princërit përcillnin testamente të trimërisë, të kulturës, bashkimit, të luftës për liri e mëvetësi, nisa të kuptoj se atje, në Burgajet e Macukull, në Rremull e në Zenisht kishte po kaq klerikë të nderuar e tërë forcë në fjalën e tyre të mençur. Duke biseduar me Esatin, Avniun, Artanin e shumë shumë të tjerë gërmues dhe "minatorë" të papërtuar e të palodhur të këtij thesari shpirtëror, e kuptova se në shumë pika historitë e klerikëve ngjanin me njëra –tjetrën.

Natyrisht aty ka ata ishin edhe personazhe kryesorë. Mati i armëtarëve të shumtë në dingat e barotit dhe i rapsodëve të zot që i gjeje në çdo fshat për të mos thënë në çdo kullë, ma shtonte bukur mirë këtë Sofër ngjarjesh njerëzish këtë Ligj të pashkruar të shoqërisë njerëzore e sidomos të shqiptarëve që, kur nuk kishin dot libra e monumente ngrinin KËNGËN se dëshmi të mirënjohjes së tyre Mes shumë njerëzve të nderuar të kësaj krahine sidomos të klerikëve të saj më vjen në kujtesë portreti i të paharruarit Sheh Dalia ose i Dali Shehut nga Rremulli i Matit. i vendosur në lloj udhëkryqimes udhëve që të dërgonin në Mirditë e në Mat. Rremulli kishte bërë historinë e vet të pabujë. Në fshat kishte disa fise që kishin edhe një lloj lidhje miqësie apo krushqie mes njëri-tjetrit dhe përpiqeshin të kishin gjithmonë unitet. Jeta e Dali Shehut është e nbushur me shumë e shumë ngjarje që vijnë edhe në ditët tona me madhështinë, por edhe me njëlloj misteri. … Ngjarje të tilla me të besueshmet e të pabesueshmet e jetës së patriotit Sheh Daliu ose Dali Shehu si këmbehet edhe sot e kësaj dite emri i tij, e ndoqën shumë herë në jetën e vet. Sa mistike aq dhe të dukshme. E biografët në shkrimet e pakta të botuara për këtë patriot klerik shumë të njohur për të paktën 50 vjet në Mat e në Dibër nxjerrin vetëm një pjesë të karakterit e të personalitetit të tij njerëzor. Ai mbeti së pari si nismëtar i ndërtimeve më të nevojshme që i duheshin malësorëve matjanë e mirditorë. Në një kohë kur në këto zona të thella mungonin arkitektët e paratë. Në fshatin Bruç duhej një urë. Fshtrat Laç, Bruç e Urakë duheshin lidhur me Rremullin e tij të lindjes , me Derjanin pikërisht aty ku bëhej pazari që bashkonte jo vetëm shitësit e blerësit, e prodhimeve bujqësore e blektorale, por edhe doket, këngët, bëmat, mblesëritë e dasmave të ardhshme, çiftelitë. Mbase edhe librat e paktë që po vinin nga troje të largëta në këtë Pazar. Ishte një Pazar që kishte të paktën 100 vjet që bëhej me aq vështirësi. Dhe Ura e ndreqi shumë këtë qarkullim deri atëherë të vështirë. Edhe sot e kësaj dite ajo qëndron e fortë. Të forta janë gurët e kolonat e saj. Rrjedha e viteve s'e ka prishur dot. Pikërisht rruga që të çonte te Pazari i Derjanit që do të bëhej më e lehtë nga kjo urë kërkonte që të përmirësohej edhe rruga këmbësore që të çonte atje. E Sheh Daliu me autoritetin e padiskutueshëm, me ndershmërinë që kishte para të gjitha fshatarëve që ua kërkonte ndihmën e secilit, e bëri për një kohë të shkurtër… Në çerekun e fundit të shekullit XIX nis e ndërton brenda një kohe të shkurtër xhaminë e Rremullit. Asnjë xhami nuk kishte qënë më e madhja deri atëherë në Mat. Fshatarët e tij nuk mund të ishin të qetë duke u falur në postiqet e deleve të thara në muret e kullave. . Kur mendoje se vetëm 150 metra larg ishte një nga kishat më të mëdha të Matit, ajo e Shën Pjetrit , pa droje mund të thoje se ai ishte shumë tolerant ndaj fesë. Mund të merreshin edhe ndonjë gur nga ajo kishë e vjetër. Por, jo, asnjë gur nuk u mor nga themelet e muret e saj. Asnjë. Ndërsa xhamia edhe sot pas 130 vitesh vazhdon të presë e përcjellë besimtarë në atë godinë të ruajtur mirë. Më tej për rremullakët e tij ndërtoi Kroin e Madh. Edhe sot pas 100 vjetësh të ndërtimit të Kroit e po kaq të vdekjes së tij , brezat e nënave urojnë për shpirtin e tij: "Rahmet shpirti për Sheh Daliun e kurrë mos u harroftë emri i tij!" Urojnë nënat, udhëtarët, bujqit, barinjtë e atyre anëve. Të gjithë. Kësaj radhe e kishin detyrën e bukur ndaj historisë e ndaj brezave të tjerë malësorët që t'i ngrinin Monumentin e Kujtesës popullore si mund ta quajmë Teqen e Sheh Daliut që është në kufinjtë mes Matit e Dibrës. …Edhe me kaq bamirësi Sheh Daliu mund të qëndronte pa droje në kujtesën e malësorëve. Bamirësitë në të gjithë kohërat e ngrejnë në këtë kujtesë bëmat njerëzore. . Por gati në moshën 30-vjeçare ai do të vraponte në malet e Prizrenit, në rrugicat e tij me një flamur kombëtar në duar për të përfaqësuar jo vetëm krahinën e Matit, por edhe të Dibrës. Që i ri kishte shkelur më këmbë pragjet e shtëpive të shumë fshatrave kufitarë dibrane me Matin si ishin ato të Qafë Murrës, të Lukanit E të gjithë e nderonin këtë sheh të ri që e kishte ndërruar tashmë mbiemrin nga Mara në Shehu. " Pa atdhe nuk ka fe"-thoshte shpesh Dali Shehu. Kur bisedon me intelektualë të këtij rreth na e përmendin me shumë entuziazëm këtë fakt që rethin e Matit e përfaqëson në këtë ngjarje të rëndësishme atdhetare pikërisht një klerik. Jemi në një kohë që Mati luante një rro të rnëdësishme në ngjarjet e shekullit XIX. Jehona e ngjrjeve që lidhen më Skënderbeun, ato të përpjekjeve për arsimin shqip kishiun ndikimin e tyre të madh në historinë kombëtare. Në vitet e para të Pavarësisë në Luftën e Deshëve tashmë Sheh Daliu ishte vetë udhëheqës shpirtëror i luftës. Udhëheqës e luftëtar i paepur. Shumë kohë më vonë biri matjan Aqif Klosi në këngën epike kushtuar kësaj beteje shumë të rëndësishme e të kënduar nga këngëtari–emblemë i këngëve epiko-lirike matjane Esat Ruka, thotë për të në këngë: "Sheh Daliu thërret ezanë / ka lypë forcë e zoti ia ka dhanë. Ka 80 vjet që është zhvilluar kjo betejë. E kënga e popullit e mori që në ditët e para në supet e tij lavdinë e Sheh Dalisë me vargjet e saj: "Sheh Daliu thërret ezanë/ S'më lë serbi me fal akshamë." Në betejë u vranë dhe dy bashkëfshatarë të tij Met Lleshi dhe Isuf Lleshi. Aty në sinorët e afërt të betejës kundër serbit ai ua këndoi namazin e xhenazesë miqve të tij Brenda

> Biografët në shkrimet e pakta të botuara për këtë patriot klerik shumë të njohur për të paktën 50 vjet në Mat e në Dibër nxjerrin vetëm një pjesë të karakterit e të personalitetit të tij njerëzor. Ai mbeti së pari si nismëtar i ndërtimeve më të nevojshme që i duheshin malësorëve matjanë e mirditorë, në një kohë kur në këto zona të thella mungonin arkitektët e paratë.

këtyre fakteve historikë njëri më i saktë se tjetri, gëlon ajo më e bukura, më mistikja në jetën e tij. Që, për çudi, qëndron më e gjallë në kujtesën popullore më shumë se ngjarjet historike. Jo vetëm tek brezat e familjes së tij , por edhe te të tjerët. Në Betejën e Deshëve thonë se ai arriti që me një manovër të fuste në një betejë luftarake vetë serbët me njëri-tjetrin. Kur më 1920 serbët ndalën te Teqja e Sheh Daliut që matjanët e dibranët kishin ngritur në kufirin midis tyre për të përjetësuar këtë klerik patriot, një oficer serb me disa ushtarë vendosën ta digjnin vendvarrimin e Sheh Daliut në atë teqe. Me njërën dorë ai dha urdhërin e caktuar : "ZJARR!" Po ç'ndodhi? Dora e tij nisi të thahet, t'i shtanget. . Kaq ishte e mjaftueshmeqë ai ta lërë teqen në lavdinë e varrhapurt të tij. . .

Pas plot 50 vitesh hordhitë komuniste kërkuan të bënin atë që s'e bënë dot serbët. Të prishnin teqen e t'i nxirrnin që andej kockat këtij të paharruari. Po kush do ta bënte një gjë të tillë ? U gjet njëri. Më saktë, ai doli " vullnetar". - E prish unë, - tha me mburrje "vullnetari". Nga varri 50-vjeçar i Sheh Daliut dolën tespihet, shpata, bastuni, një shkop i vogël . Po ç'ndodhi më tej? Porsa shkoi në shtëpi i thonë se vajza 9-vjeçare që e kishte lënë normale, ishte bërë shurdh memece. Kjo shurdhmemecëri për të ishte e përjetshme dhe e pashërueshme në të gjitha vendet ku e dërguan. Me një Kod të pashkruar edhe sot e kësaj dite (dikur fshehurazi) teqja e Sheh Daliut është bërë një vend peligrenazhi nderimi për shumë udhëtarë e breza të ndryshëm të krahinave të Dibrës e Matit. Por edhe për nevojtarë nga e gjithë Shqipëria. Duke hedhur pas kryet e duke gërmuar në kujtesën popullore po e bëjmë një pyetje të thjeshtë: "Cili është Çelësi i Kujtesës për këtë njeri? Bamirësia? Emri i luftëtarit dhe i udhëheqësit popullor? Apo emri i klerikut të ndershëm e të përkushtuar që i bën krenarë jo vetëm rremullitët matjanë, por edhe e qindra e mijëra njerëz që e kanë njohur nga afër atë?" Të gjitha janë në këtë portret. Aq të plota e aq të paharruara sa që në një moment, kur dikush na flet për atë, ose edhe ne vetë, flasim për të në oda e muzera, në mënyrën më të sinqertë do të thonim në gjalljen e tij: "Po fol një fjalë, o Dali Shehu!"

Muharrem Zogu,

Nga **Destan RAMA**

Në pjesën jugperëndimore të luginës së bukur dhe me emër të Grykës së Madhe ndodhet fshati Valikardhë. Ai shtrihet në shpatin verior të malit me të njëjtin emër dhe më në thellësi të tij ndodhet Kazjaku. Relievi i fshatit vjen me kodra e rrafshe të bukura me lugina piktoreske. E gjithë sipërfaqja e fshatit, në drejtimin jugveri, përshkohet nga dy përrenj të mëdhenj që në pranverë e vjeshtë kur tërbohen rrezikojnë edhe jetë njerëzish e kafshësh. Është dashur kujdesi i vazhdueshëm në vite i banorëve e fshatit që të disiplinojnë dalldisjet e përroit të Halilamjet dhe atij të Xhemes. Kodrat zbutëse që vijnë njëra pas tjetrës nga bregu i zallit të Bulqizës e deri në Pleqere të veshur me drunjë të llojeve të ndryshme e pemë frutore i japin një hijeshi fshatit që nuk ngopesh duke e parë. Ndër pemët frutore spikat molla e varieteteve të ndryshme, kumbulla, gështenja, qershia, rrushi etj. Në rrafshe e lugina dallon parcela të mbjella me grurë, misër, fasule të cilat çdo vit mbushin hambarët e familjeve e ndrisin jetën.

Duke u mbështetur në dokumente burimore mendohet se ky fshat është një vendbanim i hershëm. Mendohet se ky fshat është banuar qysh në kohën parahistorike. Dëshmi për këtë janë gjetjet e dy ekspeditave që arkeologët shqiptarë Hasan Ceka dhe Jovan Adami kryen në trevën dibrane në vitet 1950-1951, bënë edhe hulumtime në katër kisha. Në relacionin e pare ata shkruajnë: afër Urës së Qytetit dhe në bregun e majtë të lumit të Bulqizës duken mbeturina të një godine, ku ishte gjetur një kryq ne reliev. Shtylla mbi të cilën qëndronte ky kapitel ka pasur formë eliptike. Të tilla kapitele janë karakteristike për kisha të epokës parahistorike. Në relacionin e dytë shkruhet po ky tekst dhe përmendet fshati Valikardhë. Në regjistrin e hartuar nga instituti gjeografik i Sofies, viti 1903, fshati Valikardhë na del me emrin Valikazta me gjithsej 69 shtëpi. (Kristo Frashëri "Historia ë Dibrës" fq.164,165,566).

Këtij fshati asnjëherë nuk i kanë munguar njerëzit e mirë të mençur e të zgjuar. Ka pasur disa prej tyre që kanë gjezdisur botën, kanë fituar përvoja, janë shkolluar dhe modelet më të mira i kanë sjellë në fshatin e tyre. Ka pasur edhe nga ata që me mendjen e tyre të mprehtë, me intelektin e tyre, me bëmat e tyre janë dukur mbi të tjerët. I tillë ka qenë edhe mjeku popullor i njohur nga gjithë krahina e Zerqanit e më gjerë Muharrem Zogu (Duararti).

Muharrem Zogu lindi në Valikardhë, komuna Zerqan, rrethi Bulqizë rreth vitit 1857. Fëmijërinë e kaloi në fshatin ë tij të lindjes, Valikardhë. Edhe ai kishte dëshirë të madhe të shkollohej bashkë moshatarët e tij në fshat, por kjo qe një gjë e pamundur, pasi këtu nuk kishte shkollë shqipe. Ajo ndalohej me ligj nga regjimi osman.

Në fëmijëri edhe në rininë e hershme të tij tek po kulloste bagëtitë në kodrat, arat apo shpatet e maleve atij i tërhiqte vëmendjen shumëllojshmëria dhe bukuria e bimëve, e luleve të cilat dukeshin sikur një dorë e kujdesshme e njeriut i kishte mbjellë. Filloi nga dita në ditë të studionte tiparet a vetitë e tyre. Vuri re se tek ata kishte ndryshime esenciale në pamje, në erë, në ngjyrë dhe së fundmi edhe në vlerat kuruese.

homazh

Muharem Turkeshi, njeriu që skaliti historinë kombëtare me sqepar

Muharem Turkeshi njeriu qe sfidoi kohën duke shkruar emrin e tij nëpër vepra monumentale vepra historike te cilat ngrenë lartë krenarinë e dibranëve në veçanti dhe të të gjithë shqiptarëve në përgjithësi.

Lajmi për vdekjen e Muharem Turkeshit bëni sot të gjithë dibranët që edhe njëherë të rikujtohet historia e tij gjatë ndërtimit të shtatores së Skënderbeut në sheshin me të njëjtin emër në Dibër të Madhe, me këtë rast edhe këshilli komunal i Dibrës familjes së Muharem Turkeshit i dërgon Telegram Ngushëllimi, ku mes tjerash thuhet: "Shumë e nderuara familja Turkeshi në Tiranë, Me keqardhje e pranuam lajmin për ndarjen nga jeta të skulptorit dhe dibranit tonë Muharem Turkeshi. Me lejoni që, në emër të Këshillit Komunal të Dibrës, unë Kryetari i këtij këshilli Bashkim Mashkulli dhe në emër të Kryetarit të Komunës së Dibrës Ruzhdi Lata të Ju shpreh ngushëllimet më të sinqerta për ndarjen nga jeta të Muharem Turkeshit. Muharem Turkeshi në mesin e Dibranëve të Dibrës së Madhe do të kujtohet për gjithmonë për kontributin e tij së bashku me Agim Selën në ndërtimin e shtatores së Skënderbeut, si një njeri i urtë, punëtor, patriot e familjar i shkëlqyeshëm. Edhe një herë pranoni ngushëllimet tona më të sinqerta. Dibër 17 shtator 2013 Këshilli Komunal i Dibrës Kryetari Bashkim Mashkulli".

Muharem Turkeshi pas mbarimit të studimeve të larta në Akademinë e Arteve



në Degën e Skulpturës në vitin 1968 ka punuar në Uzinën e Skulpturës në Tiranë ku për një kohë të shpejt merr emër dhe njihet si punuesi më i mirë i qeramikës në Shqipëri. Përmes qeramikës Xha Muharemi (siç e thirnin dibranët) ka trajtuar shumë tema jetësore, figura të shquara kombëtare si Skënderbeu e Ismail Qemali.

Muharem Turkeshi përmes qeramkës Fabullat shqiptare i ka kthyer në qeramikë si "Ra Faja prej fiku", "Lufta e Gjelave", "mundja e duarve", ai përmes materialeve të tija ka marrë pjesë në të gjitha ekspozitat kombëtare, ku është edhe i nderuar dhe vlerësuar lartë me çmime puna e tij.

Muharemi vazhdimisht merrte pjesë aktive me diskutime në ekspozita të ndryshme me vepra të artit. Në skulpturë monumentale ka realizuar disa vepra Shtatorja e Skënderbeut në Dibër (së bashku me Agim Selën), Partizanët në varrezat e dëshmorëve në Librazhd, ndërkaq në Galerinë e Arteve kombëtare në Tiranë përveç veprave të tjera spikat edhe portreti "Vajza Ime". Ndërkohë në qytetin e Peshkopisë në Fasadën e Prefekturës së Bashkisë të Peshkopisë është vepra e tij terakotë "Aksionisti".

Tek veprat e Muharemit spikat thjeshtësia në kompozicion, ndërkaq në trajtimin e formës ngrohtësia duke shpreh gjithmonë pasionin me afinitet të lartë si për skulpturën e vogël poashtu edhe për atë monumentale.

Dibranasi në Tiranë dhe Tiranasi në Dibër të Madhe, skulptori Muharem Turkeshi sëbashku me modelistin Agim Sela gjatë vitit 2002 kryen punimet e shtatores monumentale të Gjergj Kastrioti Skënderbeu shtatore kjo me një dimension 3 metra e 40 centimetra e veshur me një origjinalitet të kulluar dekorativ kombëtar shqiptar është unikate në botë, të cilën aktualisht do të kenë nderin që për jetë të jetëve ta ketë vetëm Dibra dhe dibranët.

Fisnikëria që s'vdes kurrë

Elegji për Rufat Spatën

Nga Xhafer Martini

Lumi i njerëzve ngadalë
Drejt kodrinës larë me lot.
Po cilin sot përcjellin vallë
Supekrusur e s'e mbajnë dot?

Por s'është pesha përmbi supe,
Përmbi krah nuk është ajo.
Zemrat janë bërë ulluqe,
Dhimbje të madhe kanë ato.

Bashkë me to lotojnë malet,
Loton në zall Drini i mjerë.
"Kush na erdhi"? pyesin
Kaq dhimbje ne s'kemi ndjerë.

Ah sot vjen një tjetër burrë
Rufat Spata me shpirt drite,
Fisnikëria që s'vdes kurrë,
Nuk vdes sot e as ndër vite.

Peng i madh më ka mbetur
Që s'ta hodha një grusht dhe,
Po me dhimbje e mall tretur
Isha rreth teje e gjer në re.

Kam qenë zogu n'atë breg prroi
Që cicërinte plot trishtim.
Nuk qe shi ai që rigoi*)
Qenë lotët e shpirtit tim.

Ditën e varrimit të Rufat Spatës,
më 16 shtator 2013 ra një vesë shi.

mjeku popullor që shëronte çdo sëmundje

Muharrem Zogu përveç se mjek popullor i përmasave të mëdha për kohën,mbi të gjitha ishte edhe njeri human. Ndjenjën e humanizmit ia jepte shpirti njerëzor i tij, por edhe profesioni i mjekut që e ka në thelb humanizmin. Ai ishte i papërtueshëm në çdo kohë. Shtëpinë e tij e kthehu thuajse në spital.
Vitet e fundit, pasi edhe mosha filloi ta gërryente pak e nga pak, vinin dhe e merrnin nga ana anës me kalë. Në fjalorin e tij ishte zhdukur tashme fjala "Jo". Por ja që ligjet e natyrës për fat të keq nuk mjekohen. Ata bëjnë të tyren. Më 22 mars të vitit 1947 në një moshë të thyer, ndërroi jetë.
Muharremi vdiq, por la veprën prapa. Për njeriun që lë veprën prapa s'ka vdekje kurrë se vepra nuk vdes.

Kishte dëgjuar dikur, që kur ishte fëmijë, në odat e burrave, se edhe "bima shëron". Kjo thënie kishte mbetur vetëm një slogan tek ai të cilin nuk donte ta shqiste nga mendja kurrë. Kureshtja për ta vënë këtë në jetë, si edhe pasioni i vazhdueshëm i tij për të studiuar çudibërjen e bimëve nuk po e linte të qetë. Filloi të mblidhte lloje të ndryshme bimësh e lulesh, të bënte eksperimente dhe prova për kurimin në fillim të plagëve të lehta e deri në shërimin e puçrrave kanceroze që shfaqeshin në lëkurën e njerëzve. Folësi popullor, bashkëfshatari i tij Ibrahim Kika kujton: Kam dëgjuar nga më të moshuarit se një herë, në filllimet e tij, Muharremit iu plagos rastësisht kali. Me mjekimet që i bëri plagës, me ilaçet mjekësore të përgatituara nga vetë ai me bimë mjekësore, arriti që brenda një kohe fare të shkurtër plaga u shërua plotësisht. Kjo i dha krahë atij të vazhdonte më me zell punën si mjek popullor, të zbulonte të fshehtat e bimëve. Stërnipi i tij Mexhit Zogu, ndonëse në moshë të re, kujton thëniet e babait, të gjyshit të tij dhe tregon: Gjatë tre muajve të verës Muharrem Zogu qëndronte në male për të mbledhur lule e bimë mjekësore që rriteshin në zonën e Zerqanit. Si për fat natyra ia kishte dhuruar këtë shumëllojshmëri bimësh pafund, ndaj edhe sot me të drejtë përdoret në të folurën e njerëzve : "Zerqani mrekullia e natyrës". Shtëpinë e tij Muharremi e kishte kthyer në një laborator të vërtetë për përgatitjen e ilaçeve për shërimin e sëmundjeve. Me ilaçet që përgatiste arriti të shërojë edhe shenja kanceroze që shfaqeshin në fytyrat e njerëzve apo pjesë të tjera të trupit, kryesisht në hundë, veshë etj.

Ai shfrytëzonte stanet e bagëtive që ngriheshin nga fshatarët në mal gjatë stinës së verës, për shërimin e sëmundjes së mushkërive duke i trajtuar ata me ushqime bio dhe duke i vendosur ata për të fjetur mbi vathën e deleve. Bënte më së miri profesionin e ortopedit; lidhte dhe shëronte kockat e thyera në pjesë të ndryshme të trupit, si edhe deformime të ndryshme. Më e veçanta e tij ishte shërimi i sëmundjes së reumatizmit, nervit shiatik dhe paraliza të ndryshme. Shërimin e këtyre sëmundjeve e kryente ndryshe nga kurimet që bënte mjekësia e kohës. Këtë e tregonin vetë pacientët e tij në opinionet që jepnin për ecurinë e sëmundjes. Muharrem Zogu ishte edhe një stomatolog i mire i kohës. Ishte mjaft i njohur për heqjen e dhëmbëve të sëmurë. Këshillat e tij për kujdesin ndaj dhëmbëve dhe higjienën e gojës ishin mjaft domethënëse dhe të dobishme për atë kohë. Vetëm me ata ilaçe që përgatiste duke përpunuar bimë mjekësore arriti të shëronte puçrra dhe dregëza, qerozat që shfaqeshin në kokë, biles arriti të kufizojë edhe rënien e flokëve.

Ai kryente me pasion të veçantë e profesionalizëm nxjerrjen e plumbit nga trupi i njeriut, shërimin e plagës që krijonte ai. Në kohën kur punonte, dhe këta raste ishin të shpeshta, pasi fenomeni i gjakmarrjes ishte i përhapur, por edhe konfliktet e ndryshme, ishin bashkëudhëtar të jetës së njeriut. Kontributi i tij gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare është i jashtëzakonshëm. Ai mjekonte vazhdimisht plagët e luftëtarëve që plagoseshin në luftën për çlirimin e vendit pa dallim bindjesh politike të kohës.

Mjekët italianë që ishin atëherë në Prefekturën e Dibrës takoheshin shpesh herë me Muharrem Zogun. Ata shkëmbenin eksperiencë dhe e përgëzonin atë për mrekullitë që kishte shpalosur ai në shërimin e gjithë atyre sëmundjeve të vështira me vlerat çudibërëse të bimëve mjekësore.

Bëmat për mrekullitë e bëra nga mjeku popullor Muharrem Zogu për shërimin e disa sëmundjeve janë pafund, por këtë radhë po kujtojmë vetëm një. Njëherë, - kujton Ibrahim Kika, sipas atit të tij, - sollën në spitalin partizan të Zerqanit një partizan të plagosur rëndë. Mendimi i mjekëve ishte t'ia prisnin këmbën. Por ata nuk vepruan pa u konsultuar me Muharrem Zogun. I dërguan fjalë Nezir Kikës nga Valikardha, në atë kohë kryeplak, që ta sillte Muharremin në spital. Babai, - thotë Muharremi pasi bëri gati kalin, vajti e mori dhe e dërgoi në Zerqan tek spitali. Muharremi pasi e vizitoi të plagosurin ashtu si dinte ai, tha: Këtë do ta mjekoj unë me ilaçet e mia. S'është nevoja për t'ia prerë këmëben.

Dhe kështu bëri. E mjekonte çdo ditë me kujdesin më të madh. Arriti që këmba t'i shërohet plotësisht. Që nga ajo kohë e deri sa vdiq Muharremi, partizani që ishte nga një fshat i jugut mbetën miq e shkuar mikut.

Muharrem Zogu përveç se mjek popullor i përmasave të mëdha për kohën,mbi të gjitha ishte edhe njeri human. Ndjenjën e humanizmit ia jepte shpirti njerëzor i tij, por edhe profesioni i mjekut që e ka në thelb humanizmin. Ai ishte i papërtueshëm në çdo kohë. Shtëpinë e tij e kthehu thuajse në spital.

Vitet e fundit, pasi edhe mosha filloi ta gërryente pak e nga pak, vinin dhe e merrnin nga ana anës me kalë. Në fjalorin e tij ishte zhdukur tashme fjala "Jo". Por ja që ligjet e natyrës për fat të keq nuk mjekohen. Ata bëjnë të tyren. Më 22 mars të vitit 1947 në një moshë të thyer, ndërroi jetë.


Muharremi vdiq, por la veprën prapa. Për njeriun që lë veprën prapa s'ka vdekje kurrë se vepra nuk vdes.


M&B BOTIME JU FTON TË NA VIZITONI NË

Panairin e Librit "Tirana 2013"

Botime të reja nga akademik Kristo Frashëri







Botime të tjera të suksesshme nga autorë dibranë



Në ditët e panairit **Botimet M&B** do t'i gjeni me zbritje të çmimeve nga **20-50%.**
Na gjeni në **katin e parë të Pallatit të Kongreseve** nga data **13 deri 17 nëntor 2013**
00355 4 22 33 283 / 069 20 68 603 / mbbotime@gmail.com / www.mbbotime.com
Na ndiqni në Facebook: MB Botime & Studio Grafike

cyan magenta yellow black